



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 28 TETOR 2019, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 17.10.2019 *(neni 44, pika 2, i Rregullores)*
2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*
3. Diskutimi i çështjeve të evidentuara nga zgjedhësit *(neni 40/1 i Rregullores së Kuvendit)*
Diskutime – jo më shumë se 4 orë
(Koha e diskutimeve ndahet në mënyrë të barabartë mes shumicës dhe pakicës, duke marrë parasysh edhe deputetin e pavarur ose deputetin jashtë grupeve parlamentare. Koha e diskutimit brenda shumicës ose pakicës ndahet, për sa është e mundur, në proporcion me madhësinë e grupeve dhe me numrin e deputetëve të pavarur ose deputetëve jashtë grupeve parlamentare).

Gramoz Ruçi – Uluni, kolegë deputetë!

Ftohen mediet të futen në sallë.

Seancën e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Ka vërejtje lidhur me procesverbalin?

Kujtim Gjuzi – Zoti Kryetar, në seancën e kaluar keni shkelur Rregulloren, pasi në pika të ndryshme keni penalizuar deputetët Kostaq Papën dhe Kujtim Gjuzin që kishin diskutim. Deri në këto momente keni shkelur nenet 48, 50, 51 dhe 54...

Gramoz Ruçi – Zotëri, keni vërejtje për procesverbalin?

Kujtim Gjuzi – Patjetër, pra, vërejtje për procesverbalin kam, se nuk na keni lënë të flasim...

Gramoz Ruçi – Pyes: për procesverbalin keni vërejtje?

Kujtim Gjuzi – Ky është procesverbal.

Gjatë diskutimit tim herën e kaluar më thatë se kisha shkelur Kodin e Etikës. Këtu i kam edhe Kodin e Etikës, edhe Rregulloren. Çfarë kodi kam shkelur?

Gramoz Ruçi – A keni vërejtje lidhur me procesverbalin?

Kujtim Gjuzi – Ç’është më kryesorja, në orën 14:39 më ka ardhur sms konfirmuese pikërisht për veshjen dhe nuk ka zot nëne të më kërcënojë. Nuk të kam frikë as ty, as...

Gramoz Ruçi – Nuk të kërcënoj për veshjen, përkundrazi...

Kujtim Gjuzi – Kaq për sot. Herë tjetër...

Gramoz Ruçi – ...të kërkoj të zbatosh etikën, i dashur, dhe të mos vish...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mos ndalosh nga autoshkolla te dera e parlamentit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulu, ulu!

Ka vërejtje për procesverbalin? Nuk ka. Miratohet.

Njoftim

Nga Këshilli i Ministrave është depozituar projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor në Detin Mesdhe”. Ky projektligj është kërkuar me procedurë të përshpejtuar shqyrtimi.

Projektvendimin e keni të gjithë përpara. Votimi do të bëhet në fund të seancës.

Nga deputetët është depozituar një projektligj, si dhe është kërkuar një interpelancë urgjente nga një grup deputetësh opozitarë.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në mbështetje të pikës 1 të nenit 125, të nenit 149/d, pika 1, të Kushtetutës dhe të nenit 7/c, pikat 4, 5 dhe 6 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, si dhe të neneve 217 dhe 229, pika 5, të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ka depozituar në Kuvend listat përfundimtare të renditjes së kandidatëve të lejuar për kandidim, si dhe raportet e arsyeuara të renditjes së tyre për plotësimin e dy vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese (vakanca të plota këto, të shpallura nga Kuvendi në datën 12.02.2018 dhe në datën 04.03.2019). Listën dhe titujt e projekteve të depozituara i keni të gjithë në tavolinat tuaja. Materialet do t’i gjeni, si gjithnjë, të publikuara në faqen zyrtare në internet.

Lidhur me çështjen që kemi sot në rendin e ditës, është hera e dytë, kushdo deputet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, a ka mundësi të më lini të mbaroj unë?

Pra, është seanca e dytë plenare, ku do të sillen problematikat e konstatuara nga deputetët gjatë javës së kaluar dedikuar zgjedhësve.

Seanca plenare, sipas pikës 4 të nenit 41 të Rregullores, do të jetë jo më shumë se katër orë. Koha e diskutimeve do të ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet shumicës dhe pakicës, duke marrë parasysh edhe deputetët e pavarur ose deputetët jashtë grupeve parlamentare. Koha e diskutimit brenda shumicës ose pakicës do të ndahet sipas propozimeve të grupeve dhe numrit të deputetëve (qoftë të grupeve parlamentare, qoftë deputetëve jashtë grupeve parlamentare).

Lista e diskutantëve është si më poshtë: nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste janë regjistruar deputetët Ermonela Felaj, Taulant Balla, Senida Mesi, Ismet Beqiraj, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Ilir Beqaj, Tatiana Nurçe (Belba), Vilma Bello, Elisa Spiropali, Xhemal Qefalia, Adriana Jaku, Elona Hoxha, Vullnet Sinaj, Klotilda Bushka, Eljo Hysko, Jurgis Çyrbja, Andrea Marto, Fadil Nasufi, Florenc Spaho, Edlira Bode, Bujar Çela, Antoneta Dhima, Ardit Konomi dhe Klodiana Spahiu; nga Grupi Parlamentar Demokrat janë regjistruar deputetët Rudina Hajdari, Myslim Murri, Halil Jakimi, Halit Valteri dhe Korab Lita; nga Grupi Parlamentar i Pavarur janë regjistruar deputetët Nimet Musaj, Ralf Gjoni, Enver Roshi dhe Edlira Hyseni; nga Grupi Parlamentar Partitë e Djathta janë regjistruar deputetët Kostaq Papa, Zef Shtjefni, Koçi Tahiri dhe Kujtim Gjuzi; nga deputetët jashtë grupeve parlamentare janë regjistruar deputetët Besnik Troplini, Elda Hoti, Lefter Maliqi, Ligoraq Karamelo, Artur Roshi, Vasil Sterjovski dhe Reme Lala.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë kishit, zoti Lita?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Korab Lita – I nderuar zoti Kryetar,

Në seancën e kaluar Grupi Parlamentar Demokrat ka bërë një njoftim lidhur me ndryshimet e ndodhura në atë grup.

Ju, faktikisht, e shkelët Rregulloren, pasi ju kompetencë keni vetëm lajmërimin e seancës në lidhje me ndryshimet dhe jo interpretimin lidhur

me kërkesat e bëra për anëtarësime të reja apo shkresa të tjera të drejtuara.

Në këtë këndvështrim, Grupi Parlamentar Demokrat, edhe pas asaj që thatë ju, ka marrë në konsideratë kërkesat për anëtarësime të reja në grupin tonë parlamentar, pasi kjo është e vetmja kompetencë dhe i vetmi institucion ku duhet të kalojnë anëtarësimet (pra në grupin parlamentar).

Grupi Parlamentar Demokrat, i mbledhur në datën 24.10.2019, pasi diskutoi kërkesën e pesë deputetëve për t'u bërë anëtarë të këtij grupi parlamentar, bazuar në Rregulloren e Kuvendit dhe në vendimin e grupit parlamentar për funksionimin e brendshëm të tij të datës 11.06.2019, vendosi të mos e pranojë kërkesën e deputetëve për anëtarësim. Grupi Parlamentar Demokrat do të vazhdojë të ketë nëntë anëtarë. Bashkëngjitur këtij vendimi, keni kopjen e protokolluar të mbledhjes, e cila parashtrohet dhe jep një rezimë shumë të qartë të të gjithë mbledhjes dhe të të gjitha diskutimeve të anëtarëve të grupit. Në përfundim, me pesë vota pro dhe tri vota kundër (shkresën e keni përpara), është vendosur të mos pranohet asnjë anëtar i ri në Grupin Parlamentar Demokrat. Pra, Grupi Parlamentar Demokrat do të vazhdojë të ketë nëntë anëtarë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Zoti Murrizi, kërkuat fjalën?

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Në fakt, nuk kam të bëj me çfarë foli zoti Lita. Unë do të doja që në seancën e ditës së hënë, kur diskutojmë problemet e ardhura nga zona, duhej të kishte një shpërndarje tjetër të kohës. Ne kemi një kohë të barabartë: dy orë ju të maxhorancës dhe dy orë ne të opozitës. Unë besoj se maxhoranca i ka të gjitha mundësitë në mbledhjen e grupit parlamentar, në qoftë se ministrat ju binden dhe ju vijnë në grupin tuaj parlamentar, për t'i adresuar në grup problemet e zgjedhësve. Ju jeni në qeveri dhe nuk keni pse të bëni *show* në foltoren e Kuvendit për të ngritur hallet e qytetarëve. Keni marrë përsipër t'i zgjidhni ato halle qysh kur keni ardhur si maxhorancë në këtë sallë me votat e marra në vitin 2017 apo edhe para katër vjetësh, në vitin 2013.

Ndaj, ndarjen e barabartë të kohës e shoh të pavend.

Ajo që duhet të gumëzhijë në këtë sallë dhe që duhet t'i ngrejë realisht problemet e qytetarëve është pjesa e opozitës.

Unë nuk e di se çfarë problemesh do të ngrini ju. Nëse keni probleme me mbarëvajtjen dhe funksionimin grup parlamentar – qeveri, sepse nuk ju pyesin këta, ngrijini në mbledhjen e grupit. Këtu duhet të përcillen shqetësimet dhe hallet e atyre qytetarëve që nuk e gjejnë veten të përfaqësuar nga qeveria.

Ju keni marrë përsipër të bëni investime. Jeni atje dhe keni pushtetin lokal sot.

Unë nuk di çfarë hallesh do të ngrini këtu, përveçse të bëni *show*.

Në rastin e parë të gjithë folët për suksesin e menaxhimit të tërmetit. Nuk di se çfarë do të dëgjojmë sot apo cili është sukcesi i radhës që do të trumbetohet në këtë foltore. Ndaj, do të doja që të shihet më mirë edhe nga Byroja, ose nga Konferenca e Kryetarëve ndarja e kohës. Duhet t'i jepet më shumë kohë në këtë seancë, kur diskutohen problemet e zonave, pjesës së opozitës sesa maxhorancës.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – E doni fjalën për procedurë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Ligoraq Karamelo – Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot është një ditë e shënuar, është festa kombëtare e Greqisë, festa e JO-së; është festa e një vendi që bashkë me Shqipërinë u angazhuan në koalicionin antifashist dhe, në kuadrin e 75-vjetorit të Çlirimit të vendit, merr një kuptim të veçantë. Sot është një gëzim tjetër i veçantë, sepse, krahas qindra, mijëra nxënësve të shkollave në Greqi, do të parakalojnë edhe dhjetëra e mijëra fëmijë shqiptarë. Duke respektuar historinë, tregojmë se si do të jetë e ardhmja e fëmijëve tanë.

Gramoz Ruçi – Ku është procedura këtu, zoti Karamelo?!

Ligoraq Karamelo – Për procedurë, po kaloj konkretisht.

Zoti Kryetar, propozimet e mia konkrete për procedurë janë këto.

Kjo seancë është e nevojshme, dhe shumë mirë që zhvillohet, por unë gjykoj se këto seanca janë tepër formale; nuk kanë asnjë vlerë. Mendoj se për të rritur efektivitetin e tyre duhet të merren disa masa.

Së pari, unë gjykoj se koha e diskutimeve në total duhet të jetë më e kufizuar.

Së dyti, ministrat dhe qeveria duhet t'i dëgjojnë me kujdes ato që thonë deputetët.

Së treti, gjykoj që ministrat, patjetër, të mbajnë shënim çfarë vërejtjesh kanë deputetët dhe mundësisht të bëjnë një debat, ndoshta edhe informal me njëri-tjetrin për të diskutuar nëse zgjidhen ose jo këto probleme dhe nëse janë ose jo të vërteta.

Së katërti, gjykoj se, sipas Rregullores së Kuvendit, seanca për pyetje-përgjigje, që është planifikuar për të mërkurën, e cila nuk po zhvillohet, mund të koordinohet me këtë seancë, me qëllim që të rritet efektiviteti i kontrollit të parlamentit ndaj ekzekutivit.

Së fundi, kam një sugjerim dhe një vërejtje konkrete për ju, zoti Kryetar. Sipas nenit 90, i kam drejtuar një pyetje Kryeministrit lidhur me ngjarjet e Bularatit, me shpalljen *non grata* të personave dhe me situatën që ekziston ndërmjet të dyja vendeve. Detyra juaj është t'ia përcillni Kryeministrit jo të më përgjigjeni mua në mënyrë negative. Madje, sipas nenit 91 të Rregullores, duhej të kishit informuar edhe Kuvendin.

Unë uroj që vizita e sotme e Kryeministrit në Greqi të shënojë një sukses në marrëdhëniet ndërmjet të dyja vendeve, si dhe problemet ndërmjet dy vendeve tona të zgjidhen për mbarëvajtjen e të dy popujve dhe të ardhmes sonë integruese.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Fjalën e ka kërkuar zonja Hajdari. Ju lutem, për procedurë!

Rudina Hajdari – Zoti Kryetar,

Para pak ditësh ju kam dërguar një shkresë, me anë të së cilës ju kam kërkuar që të siguronit ambientet e Kuvendit të Shqipërisë dhe ambientet e Kryesisë së Kuvendit.

Nuk mundet të ndodhë sot, në vitin 2019, që deputetët të kërcënohen. Është e papranueshme që një femër të kërcënohet! Kam pasur raste në zyrën time, kur persona kanë

ardhur në zyrë dhe më kanë kërcënuar. Kjo nuk mund të ndodhë më! Ka ikur ajo kohë!

Ju lutem, zoti Kryetar, merrni masa, përpara se të kemi ndonjë viktimë këtu në parlament.

Ju kërkoj edhe një herë, që, siç janë marrë masat këtu në sallën e seancave plenare, të merren edhe në Kryesinë e Kuvendit. Asnjë deputet nuk duhet të hyjë në Kuvend pa u kontrolluar mirë! Asnjë deputet nuk duhet të marrë përforcime me njerëz të tjerë dhe të shantazhojë deputetët e tjerë! Duhet të jemi seriozë!

Ju lutem, zoti Kryetar, më duhet një përgjigje nga ju për sa i përket shkresës që ju kam dërguar, si dhe këto masa të merren sa më shpejt të jetë e mundur.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Së pari, për sa u përket katër çështjeve që u ngritën nga zoti Lita, dua t'ju them se kam ndjekur një konferencë tuajën për shtyp, por edhe deklaratën e sotme, ku bëni fajtor Kuvendin apo Kryetarin e Kuvendit për mosmarrëveshjet që keni ju si grup parlamentar.

Për herë të dytë, ju sqaroj tri gjëra:

Së pari, është e drejtë ekskluzive e deputetit dhe e grupeve parlamentare se në cilin grup merr pjesë deputeti. Me këtë çështje nuk merret as Kryetari i Kuvendit dhe as seanca e Kuvendit. Nuk keni pse i thoni institucionalisht, në ambientet e Kuvendit, ato gjëra që keni thënë në konferencën për shtyp. Jua thashë herën e kaluar, por po jua them përsëri: zgjidhni problemet tuaja si të doni ju dhe sipas rregullores që keni ju.

Së dyti, është e drejtë ekskluzive e deputetit të largohet dhe të afrohet në një grup parlamentar, si dhe është e drejtë ekskluzive e grupeve parlamentare të përjashtojnë anëtarë të grupeve parlamentare. Me këtë çështje nuk merret as Kryetari i Kuvendit dhe as seanca e Kuvendit.

Së treti, është e drejtë ekskluzive e grupeve parlamentare të vendosin kush do të jetë në drejtimin e tyre. Me këtë çështje nuk merret as Kryetari i Kuvendit dhe as seanca e Kuvendit.

Prandaj, problemet që keni brenda vetes, uluni, me luajalitet, zgjidhni dhe konkludoni sipas principeve dhe rregullave demokratike të Rregullores së Kuvendit dhe të rregullores së

grupit tuaj, të cilën ju kërkoja herën e kaluar ta depozitoni në Kuvend.

Zoti Murrizi, për sa i përket kohës dhe seancës së sotme, që është e dyta e këtij lloji që po zhvillohet, kjo është Rregullorja e Kuvendit, që e kemi miratuar bashkërisht. Është vendosur të bëhet një seancë ku koha do të jetë e barabartë midis opozitës dhe pozitës. Nuk i ndalohej e drejta opozitës të flasë, përkundrazi, ka rëndësi që të vendoset në kohë të barabartë si minoranca, edhe maxhoranca. Kështu që do të vazhdohet të zbatohet Rregullorja e Kuvendit.

Zoti Karamelo, kjo është seanca e dytë e këtij lloji. Nëse ju e quani formale dhe pa vlerë që deputetët të flasin për problemet që kanë zgjedhësit e tyre, atëherë unë po ju them që pa vlerë dhe formale janë mandatet tona, jo hallet e tyre. Në qoftë se ne si ligjvënës, të zgjedhur dhe të deleguar si zëdhënës të problemeve të tyre, nuk kemi kuptuar këtë gjë, nuk kemi kuptuar A-në e asaj pse jemi këtu; në qoftë se nuk e kemi bërë siç duhet deri më sot, kjo nuk do të thotë që të mos fillojmë ta bëjmë tani. Më mirë vonë se kurrë!

Për sa i përket çështjes së dytë që ngritet, absolutisht keni të drejtë. Ministria për Marrëdhëniet me Parlamentin duhet të jetë prezente në çdo kohë, në çdo moment, në çdo diskutim. Duhet të mbajë shënim gjithçka dhe duhet të adresojë çdo problematikë që ngre secili deputet, i maxhorancës apo i opozitës.

Për sa i përket kërkesës suaj që unë duhet të sjell Kryeministrin në seancë, dua t'ju them që nuk i sjell unë në seancë as Kryeministrin, as ministrat dhe as deputetët. Nëse ju keni ndonjë pyetje për Kryeministrin, depozitoheni kërkesën sipas Rregullores dhe mos bëni *show* në sallën e parlamentit jashtë rregullave. Depozitoheni kërkesën dhe, sipas Rregullores, Kryeministri do të vijë.

Zonja Hajdari, unë e kam marrë shkresën tuaj dhe e kam adresuar. Edhe një herë, u kam kërkuar punonjësve të shërbimit që, brenda sallës së parlamentit dhe godinës së Kryesisë së Kuvendit, të bëjnë detyrën e tyre sipas ligjeve dhe udhëzimeve përkatëse për të gjitha shqetësimet që ju ngritët.

Nga ana tjetër, në mënyrë të posaçme, kërkesën e tuaj ia kam përcjellë (besoj se duhet të ketë shkuar sot, meqenëse e shtuna ishte ditë pushimi) Ministrisë së Brendshme, që, sipas

statusit të deputetit dhe kërkesës, të merren masa për shqetësimet që keni ngritur në shkresën që më keni dërguar, që i trajtuat edhe këtu në seancën plenare.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Jo, mbaroi koha për procedurë.

Fjalën e ka deputetja Ermonela Felaj. Të përgatitet deputeti Nimet Musaj.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Kryetar!

Është një rast i mirë që Rregullorja e Kuvendit krijoi një hapësirë të tillë komunikimi për problemet e qytetarëve që ne përfaqësojmë drejtpërdrejt, sepse është një hapësirë e vërtetë dhe efektive.

Kujtoj, sidomos për kolegët që kanë ardhur më pas, që edhe Rregullorja para se të bëheshin ndryshimet, e përmbante një kohë të ngjashme. Në orën e parë të çdo seance plenare bëheshin diskutimet e lira. Këtë hapësirë kohore, Partia Demokratike, kur ishte në maxhorancë, e kaloi në fund të seancës, duke e humbur edhe rëndësinë, pasi u bë komplet e padëgjueshme.

Këtë e tutje ne do të mbajmë seanca të posaçme një herë në muaj vetëm për problemet e qytetarëve tanë. Besoj se të gjithë duhet ta çmojmë këtë si një mundësi të shtuar komunikimi, si dhe të tregohemi këmbëngulës për mënyrën si kërkojmë ta përdorim këtë kohë. Pra, ta përdorim jo thjesht për të ngritur problemet, por edhe për të kërkuar dhe për të dëgjuar zgjidhje. Besoj se duhet detyrimisht të vendosim standardin që, nga një seancë në tjetrën, të kemi edhe qëndrimin e institucioneve qendrore, që përfaqësohen nga ministrat, për një ose disa nga problemet që bëhen prezente në seancën paraardhëse.

Kështu asgjë nuk do të binte në vesh të shurdhët, si dhe do të nxitet vëmendja dhe presioni pozitiv në drejtim të përmbushjes së atyre detyrimeve që kemi ndaj zgjedhësve tanë.

Është e natyrshme që gjithçka të kërkojë kohë dhe buxhet për t'u zgjidhur, por besoj që aty, ku është interesi më i madh publik, duhet të jetë edhe investimi më i madh njerëzor për t'i zgjidhur problemet.

Po përfitoj nga rasti të parashtrij disa nga problemet që shqetësojnë sot Bashkinë e Kuçovës, duke mos nënvlerësuar në asnjë moment se, si në çdo bashki tjetër, edhe kjo bashki ka njohur dorën e ndryshimit në 6 vjet.

Vetëm në 6 vjetët e fundit nga qeverisja qendrore janë investuar mbi 10 milionë euro për infrastrukturën rrugore, ujin e pijshëm, energjinë, mbrojtjen lumore, shkollat dhe qendrat shëndetësore, pa llogaritur këtu edhe investimin që ne presim të zhvillojë NATO-ja në bazën ajrore të Kuçovës. Sidoqoftë, unë e ftoj Ministrinë e Mbrojtjes ta nxisë edhe më shumë fillimin e këtij investimi, mundësisht brenda vitit që vjen.

Ndërkohë, kërkoj vëmendjen e kolegëve të tjerë ministra, sipas përgjegjësive të tyre në këto drejtime:

Kuçova sot ka një drejtor të kadastrës, e cila nuk po punon ende sipas të gjitha kompetencave që i njeh ligji i ri "Për kadastrën". Aplikimet e qytetarëve të Kuçovës për legalizime ende nuk janë transferuar nga zyra e ALUIZNI-t në Berat në kadastrën e Kuçovës, duke bërë kështu që aplikimet të mbeten prej një kohe shumë të gjatë në sirtare apo në ndonjë rast edhe të selektohen për t'u përmbyllur si praktika, duke krijuar kështu premisa të qarta korrupsioni.

Zgjidhja e këtij problemi tani do t'i hapte rrugë edhe zgjidhjes së qëndrueshme të legalizimit dhe organizimit në disa zona informale ku ka ndërtime, kryesisht banesa, në të njëjtin territor ku ndodhen edhe pusët e naftës. Natyrisht që aty nuk duhej të ishte ndërtuar, por ky është një realitet që ka ndodhur prej më shumë se 30 vjetësh. Tani ne vetëm mund ta sistemojmë dhe, njëkohësisht, ta ndalojmë.

Kuçova ka qenë e njohur në të gjithë Shqipërinë për arsimin e mesëm profesional ose Teknikumin e Naftës, që sot, në fakt, ekziston vetëm si gjimnaz. Mendoj se nuk ka asnjë arsye të vlefshme për të mos e rikthyer këtë shkollë, sepse kjo kërkon vetëm dëshirë dhe vullnet. Shkollat profesionale të ngritura në Berat dhe Fier mund të na japin shumëçka, por nuk mund të na japin naftëtarë, sepse naftëtarë dhe minatorë ka pasur dhe do të ketë gjithmonë aty ku janë këto pasuri. Pra, vetëm këta njerëz kanë dëshirë të punojnë në këto punë, sepse rriten dhe jetojnë pranë këtyre pasurive.

Prandaj, të mos i mëshojmë një justifikimi të përciptë, që ka rënë numri i nxënësve, sepse me këtë logjikë i bie që përpara 75 vjetëve në Shqipëri të mos ishte hapur asnjë shkollë, sepse nuk kishte asnjë nxënë.

Nëse dikush do të shikonte çfarë moshe mesatare kanë sot ata që punojnë në naftë, cila moshë punësohet më shumë në këtë sektor, cilat janë nevojat reale të këtij sektori dhe cilat janë kërkesat për punësim në të, do të kuptonte që ne nuk mund ta garantojmë të ardhmen e këtij sektori nëse nuk ua japim mundësinë më të rinjve. Ndryshe, këta të fundit, do të kishin një arsye më shumë për t'u larguar nga qytetet e kategorive të dyta.

Kemi ende njësi administrative në territor që, edhe pse u janë bashkuar qendrave të reja administrative, shërbimet vazhdojnë t'i kenë të lidhura me qendrat e vjetra. Për shembull, në rastin e bashkisë për të cilën unë jam duke folur, njësia administrative Lumas vazhdon t'i ketë të lidhura shërbimet me Beratin.

Katër vjet pas zbatimit të reformës, mendoj se e kemi të nevojshme të njohim impaktet e vërteta të asaj reforme në territor dhe të kuptojmë në cilat gjëra kemi ngecur dhe si mund t'i zgjidhim ato për më tej.

Unë po e mbyll këtu fjalën time, natyrisht si një set të parë problemesh, duke uruar që të gjithë se bashku, deputetë dhe ministra, të angazhohemi për zgjidhjen e tyre për hir të besimit që zgjedhësit kanë investuar te ne.

Faleminderit!

(Drejtimitin e seancës e merr zonja Hysi.)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Felaj!

Fjalën e ka deputeti Nimet Musaj. Të përgatitet deputeti Taulant Balla.

Nimet Musaj - Faleminderit, zonja nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe këtë herë, njëllonj si në muajin e kaluar, në qendër të fjalës sime do të jenë problematikat që lidhen me përditshmërinë e jetës së qytetarëve të Patosit, por jo vetëm ato. Para së gjithash, gjej rastin që në fillim të fjalës sime, pa hyrë në problematikat e marra nga takimet me qytetarët e Patosit, duke vlerësuar së tepërmi këtë praktikë të re parlamentare, të nënvizoj se duhet një tjetër lloj trajtimi për çështjet që ngrihen këtu. Nga sa vura re në seancën e parë të këtij lloji, askush nuk mbajti shënim për problematikat që u ngritën në atë seancë. Për më tepër, sot askush nuk jep përgjigje për to.

Për shembull, një muaj, pasi propozova që blerja e librave *online* të përjashtohet nga taksimi

20%, nuk di nëse ky propozim është marrë parasysh ose ka alternativa të tjera. Studentët dhe pedagogët kanë nisur vitin e ri akademik dhe për librat e papërkthyer do të duhet të paguajnë shumë shtrenjtë. Nuk e di nëse ka ndonjë plan për fond të posaçëm për qendrat kulturore multifunkionale, në mënyrë që edhe qyteti i Patosit të fitonte prej tyre, siç propozova edhe muajin e kaluar.

Nuk kam marrë ende asnjë përgjigje për familjet e dëmtuara në Zharrës, të cilat presin dëmshpërblimin, problematikë që, gjithashtu, e ngrita në fjalimin tim të muajit të kaluar. Është një përgjigje që e pres unë, por edhe familjet që jetojnë atje.

Të nderuar kolegë,

Arrij ta kuptoj që ajo ishte seanca e parë e këtij lloji dhe, si e tillë, ka rëndësi historike në njërin krah, por, gjithashtu, ka nevojë për përmirësime të herëpashershme, të cilat është detyra jonë si parlamentarë t'i ndërmarrim.

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot dua të propozoj që çështjet e prekura në fjalimet e kolegëve, mbase edhe përmes ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit, të trajtohen nga ministritë përgjegjëse si kërkesa zyrtare për informacion. Kjo do të thotë se fjalimet e mbajtura në seancën, dedikuar problematikave të elektoratit, duhet të regjistrohen nga ministrat e linjës si kërkesa informacioni dhe brenda muajit të japin informacion me shkrim për deputetin përkatës, të kërkojnë një takim me të ose të kthejnë përgjigje zyrtare në rastin kur deputeti ka dhënë propozime konkrete.

Duke dashur që ky propozim i parë në fjalën time të jetë mbajtur mend, po vazhdoj me problematikën e zonës sime elektorale të vërejtura në takimet e këtij muaji. Tri janë problematikat e shtrura nga qytetarët e Patosit: menaxhimi i zjarreve në stinën e verës; çështja e vaditjes për qëllime bujqësore; ndihmat për ulla të pjellshme të Bashkisë së Patosit.

Së pari, për sa i përket problemit të zjarreve, dua t'ju them se pjesa kodrinore e Patosit, për shkak të bimësisë, vit pas viti shpeshherë gjendet nën tryshinë e zjarreve.

Për hir të së vërtetës, shërbimet policore zjarrfikëse dhe të urgjencave kanë qenë në lartësinë e duhur, por shpeshësia e ngjarjeve të

tilla përbën shqetësim për ata banorë. Dhjetëra familje janë rrezikuar seriozisht. Gjithashtu, serra dhe ambiente të tjera biznesi kanë rënë pre e zjarreve. Zjarret janë shfaqur nga marsi në shtator thuajse çdo vit. Për problemin me zjarret në atë zonë kërkoj vëmendje të shtuar nga ana juaj dhe duhet parë si alarmant për Bashkinë e Patosit.

Në verën e dy vjetëve më parë zjarret shkuan gati 50 metra larg depozitave të mëdha të një kompanie kombëtare të naftës. Merreni me mend panikun e qytetarëve në kohën kur u përhap ky lajm!

Ky panik përsëritet sa herë flakët afrohen pranë këtyre zonave. Duke qenë se Patozi është një zonë industriale me prani të lëndëve djegëse, dhe duke qenë se preket shpesh nga zjarret, propozoj që çdo dimër një grup i posaçëm në rang qarku të ketë një plan masash të mirëkordinuara me plane të posaçme emergjence që të garantojnë siguri dhe shëndet për qytetin dhe qytetarët e kësaj bashkie.

Propozoj që për rastin specifik që ka Bashkia e Patosit, ky repart, dhe kjo është domosdoshmëri, të pajiset jo vetëm me uniforma dhe me aksesore të ndryshme që i vijnë në ndihmë shuarjes së zjarreve, por edhe me një makinë tjetër të një tonazhi më normal për të shuar zjarret që në atë zonë janë me të vërtetë të frikshme.

Së dyti, është problemi i vaditjes. Bashkia e Patosit ka 4000 hektarë tokë bujqësore në dispozicion dhe 50% e saj, gati 2000 hektarë tokë, janë ende të pavaditura. Fatkeqësisht, siç banorët më thonë për të disatën herë, kjo gjendje e rënduar vijon prej 30 vjetësh. Po flasim për krahun juglindor të fushës më pjellore të Ballkanit, zgjatimin juglindor të Myzeqesë. Ku qëndron problemi dhe si zgjidhet ai?

Së pari, edhe pse investimet për vaditjen nga qeveria shqiptare janë rritur, kjo pjesë ka mbetur jashtë vëmendjes.

Së dyti, liqeni i Kurjanit, që shërben si vendburim i zonës, i ka kaluar në pronësi Bashkisë së Roskovecit, në shkellje të ligjit 27/2014 "Për ujitjen dhe kullimin". Zgjidhja mund të vijë prej ndërhyrjes së ministrit të linjës që, në vend që të lërë një konflikt institucional të hapur mes dy bashkive fqinje, që janë duke bërë më të mirën për komunitetet e tyre, ta kalojë në pronësi shtetërore, kështu që

menaxhimin ta bëjë qeveria duke e parë nga një perspektivë më e gjerë dhe duke i zbutur problemet e mosvadtjes për 30 vjet.

Çështja e tretë, që dua të përcjell në këtë foltore, është nevoja që kjo bashki ka për mbështetjen e vazhdueshme për kulturën e ullirit. Afërsisht 200 mijë rrënjë ullinj kultivohen mes dy zonave, Ruzhdijs dhe segmenti Patoz-Zharrës. Ullinjët, veçanërisht vaji i dalë nga Ruzhdijs, kanë tanimë famë ndërkombëtare, të certifikuar nga çmimet e marra në panaire të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Cilësia e lartë e ullirit kalinjtë në atë zonë do mbështetje të pakursyer shtetërore për ta nxitur këtë sipërmarrje vendase në ato zona. Për këtë kërkohet një menaxhim më i mirë dhe i shtuar i AZHBR-së.

Banorët e atjeshëm më thonë se skema e përfitimit perceptohet si e vjetruar, e ngadalte dhe ndihma jo lehtë e prekshme. Mësova prej tyre, gjithashtu, se trajtimi i fenomenit të mizës së ullirit, që u është dhënë për dy vjet, ka ndaluar. Sipas banorëve të zones, që më përcollën vlerësimet më pozitive për këtë projekt, ky trajtim duhet rikthyer menjëherë.

Në fund të fjalës sime, nisur edhe nga propozimet e bëra një muaj më parë, si dhe tri problematikat që paraqita sot, të ngritura nga banorët e Bashkisë së Patosit, do të dëshiroja që të gjashta çështjet të kishin vlefshmërinë e më së paku gjashtë kërkesave për informacion për ministrinë e linjës dhe brenda pak kohësh të sillen gjashtë përgjigje në lidhje me to.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Musaj!

Urdhëroni, zonja Felaj për procedurë!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja kryesuese!

Unë do të kërkoja vëmendjen tuaj dhe të të gjithë kolegëve se është e papranueshme që, ndërsa kolegët diskutojnë, të tjerët shfrytëzojnë si rrugë të shkurtër kalimin përpara foltores. Përveçse është fyese dhe joserioze, nuk respekton as ata për të cilët ne jemi mbledhur sot në këtë seancë.

Do t'ju lutesha dhe besoj se kam mbështetjen e të gjithëve, që kalimi përpara foltores të mos ndodhë më. Ka rrugë të tjera kalimi, Garda është e vendosur pikërisht aty dhe duhet ta zbatojë këtë detyrë, në mënyrë që kjo shfaqje të evitohet.

Ne mund të evitojmë shumëçka këtu, zhurmën e të gjitha, por kalimi përpara foltores është tejet shqetësues.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Felaj!

Keni shumë të drejtë, edhe për domosdoshmërinë e respektimit të folësit në foltore, ashtu edhe për hyrje-daljet e deputetëve.

Fjalën e ka deputeti Taulant Balla.

Taulant Balla - Të nderuar kolegë,

Padyshim që kjo seancë është një risi në punën parlamentare, për shkak të dedikimit të problematikave që deputetët mendojnë se janë çështje me sensibilitet publik, por edhe lokal për rastet që deputetët vlerësojnë të sjellin në seancë zërin e tyre.

Pa dashur të replikoj me zotin Musaj, dua të them se ky mekanizëm parlamentar është për të sjellë problemet e qytetarëve. Ka edhe mekanizma të tjerë sikurse janë seancat e pyetjeve, interpelancat, mocionet me debat, në të cilat qeveria përfshihet me detyrimin me afat të përcaktuar për të sjellë përgjigje.

Ju lutem, mos prisni që propozime konkrete, të cilat janë alternativa në politikë, të merren në konsideratë si pjesë të politikave të qeverisjes!

Po ashtu, është shumë e rëndësishme të kuptojmë se këta mekanizma parlamentarë duhet të fillojnë të përdoren. Edhe seanca e pyetje-përgjigjeve, që ngriti zoti Karamelo është një seancë mund të zhvillohet qoftë të mërkurën, qoftë të enjten apo edhe të hënë. Nuk ka asnjë seancë pyetjesh të refuzuar nga ana e ministrave apo e Kryeministrit.

Në këtë kontekst, unë do të doja sot të ndalesha në një rezolutë shumë të rëndësishme të Parlamentit Europian të miratuar javën e shkuar. Kam pasur mundësinë, edhe si bashkëkryetar i Komitetit Parlamentar të Stabilizim – Asociimit mes Shqipërisë dhe Parlamentit Europian, të isha prezent në sallë të mërkurën dhe të enjten teksa diskutohej dhe miratohej rezoluta. Jam ndier krenar që në sallat dhe korridoret e Parlamentit Europian euro-deputetë të grupit socialist dhe demokrat, por jo vetëm, mbanin në duar flamurin e Shqipërisë dhe atë të Maqedonisë së Veriut, një shprehje proteste kjo e Parlamentit Europian, aty ku mblidhen përfaqësuesit e 28 vendeve të

Bashkimit European, për të mbështetur fillimin e bisedimeve për anëtarësim me Shqipërinë.

Eurodeputetë nga shtete të ndryshme, madje edhe nga ato vende, të cilat në Këshillin European shfaqën skepticizëm dhe bënë të pamundur vendimin unanim të 28 vendeve, holandezë, danezë, francezë, e thanë shumë qartë në rezolutë se vendimi i 18 tetorit ishte një gabim strategjik për Europën, për shkak se besueshmëria politike e Këshillit European, duke iu kundërvënë zgjerimit, është vënë në dyshim; gjithashtu, një gabim strategjik për Ballkanin Perëndimor për shkak se kjo politikë lë hapësirë për ndikime të tjera, interesat e të cilave jo gjithmonë janë në përputhje me vlerat demokratike të familjes europiane, ku ne aspirojmë të bëhemi pjesë.

Do të doja t'u drejtohesha qytetarëve, atyre që na ndjekin. Është hera e parë që në Parlamentin European kemi një shumicë prej më shumë se tre të katërtat, 412 eurodeputetë, të cilët shprehën bindjen se Shqipëria ka dëshmuar vendosmërinë e saj për të përparuar në agjendën e reformave të Bashkimit European dhe ka dhënë rezultate të prekshme dhe të qëndrueshme.

Parlamenti European mirëpriti reformën në drejtësi të kryer nga Shqipëria.

Për këtë reformë në drejtësi, Parlamenti European shprehet: "Duhet t'i konsiderojmë përpjekjet më gjithëpërfshirëse në këtë fushë, gjithashtu në krahasim me atë që të gjitha vendet e tjera të rajonit do të duhet të realizojnë në rrugën e tyre për anëtarësim në Bashkimin European". Pra, reforma në drejtësi, jo vetëm që është një histori suksesi në Shqipëri, por Parlamenti European u sugjeron edhe vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor, sikurse Maqedonia e Veriut, Serbia apo Mali i Zi, të marrin si referencë reformën në drejtësi të kryer nga Shqipëria. Kush ka sy, ta shikojë, kush ka veshë, le ta dëgjojë. Të them të drejtën, nuk po flas për ju, deputetët e rinj të opozitës, që s'jeni më të rinj, se keni disa muaj në Kuvend, por kjo vlen për ata që u rrekën të kapen pas një votimi kundër për të arsyetuar hallin e tyre.

Halli i opozitës rrugore nuk zgjidhet dot, sepse atë hall e krijuan vetë. Ikën vetë nga Kuvendi dhe pa dyshim është koha për të treguar se bojkoti i institucioneve demokratike është një instrument, i cili i këshillohet kujtdo që të mos e përdorë, sepse nuk të çon drejt suksesit. Por,

pavarësisht qartësisë, me të cilën u shprehën deputetët në rezolutë, jam i sigurt që edhe ky dokument i rëndësishëm ka mundur t'i bindë të gjithë skeptikët në vend, përfshirë edhe ata që argumentuan se Shqipërisë nuk iu çelën negociatat për shkak të mospërmbyshjes së detyrave për hapjen e negociatave.

Arsyetimi i mosmarrjes së vendimit ka të bëjë më shumë me çështje të brendshme të Bashkimit European. Nuk do të ishte Bashkimi European, unioni. më i suksesshëm, nëse nuk do të kishte vijuar procesi i zgjerimit. Zgjerimi ka sjellë pa dyshim edhe nevojën për ta reformuar Bashkimin European, sistemin e vendimmarrjes. Nuk është e njëjtë të marrësh vendime me gjashtë anëtarë, sikurse ishte Komuniteti i Çelikut dhe I Qymyrit, dhe sot me 28 vende anëtare, ku vetëm procesi i largimit të një prej vendeve anëtare ka kërkuar dhe kërkon ende kohë.

Jashtë mbështetjes për Shqipërinë në Parlamentin European ishte vetëm grupimi i ekstremit të djathtë në Parlamentin European. Është një moment që Partia Demokratike të shikojë dhe reflektojë mbi qasjen e partive simotra të përfaqësuara në Parlamentin European, Partive Popullore Europiane. Është e paimagjinueshme gjuha që përdor Partia Demokratike në Shqipëri, për fat të keq, edhe Presidenti i Republikës, për fajësinë lidhur me mosvendimin e Këshillit European.

Në mocionin për rezolutën e propozuar nga deputetët e Partive Popullore Europiane, ku spikat zoti McAllister, flitet qartë se Shqipëria i ka përmbyshur të gjitha detyrimet e saj në rrugën për fillimin e bisedimeve. Procesi i fillimit të bisedimeve, marrëveshja për anëtarësim, është një proces i gjatë, nuk është anëtarësim, por përfundon me anëtarësimin në BE.

Unë sot do të doja t'u bëja thirrje deputetëve të opozitës këtu në sallë, sepse është detyra jonë historike, që të vijojmë punën për realizimin e detyrave të shtëpisë, sepse hapeshin apo jo bisedimet më 18 tetor, ne kemi detyra shtëpie, të cilat duhet t'i realizojmë. Unë mendoj se instrumenti i vënë në dispozicion nga Bundestagu përmes disa hapave konkretë është udhërrëfyesi ynë më i mirë. Ne duhet ta përmbyllim Kodin Zgjedhor sipas rekomandimeve të ODIHR-it deri për Krishtlindje, sepse pa dyshim deri në pranverën e

ardhshme, pastaj deri në samitin e Zagrebit edhe ata, që janë kundër vijimit të procesit të zgjerimit, do të kenë ndryshuar mendje, sepse gabimi strategjik i bërë më 18 tetor duhet të riparohet menjëherë.

Dua ta përsëris vendimin e Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore për të bërë ndryshimet e domosdoshme në ligjin “Për financimin e partive politike”. Duhet ta ndryshojmë. Kemi pasur një rast tepër të rëndë në Shqipëri dy vjet më parë. Kryetari i Partisë Demokratike është sot nën akuzë publike për financime të dyshimta. Ne duhet t’i presim rrugën çdolloj financimi të dyshimtë të çdolloj partie politike, përfshirë këtu edhe fushatat zgjedhore.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Balla!

Fjalën e ka deputetja Rudina Hajdari.

Të përgatitet deputetja Senida Mesi.

Rudina Hajdari – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Në radhë të parë, më lejoni t’ju tërheq vëmendjen, sepse kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së nuk e përdori kohën e tij për të folur për zgjedhësit, por foli për diçka, që ishte jashtë temës së ditës së sotme, pot ju nuk ndërhytë gjatë fjalës së tij.

Gjithsesi, më lejoni të them dy fjalë, para se të vazhdoj me fjalën time, në lidhje me zgjedhësit.

Është për të ardhur turp që Kryeministri Rama e anuloi vizitën e tij me Presidentin e Maqedonisë së Veriut. Ai e anuloi këtë takim 30 minuta përpara se ai të zhvillohej. Është një akt i shëmtuar i shtetit tonë që të anulohet një vizitë të tillë, të një niveli kaq të lartë, sidomos duke marrë parasysh se Maqedonia e Veriut është një shtet aleat që ecën përpara me ne drejt rrugës së BE-së. Pra, kemi disa sfida të përbashkëta. Ky anulim i takimit të Kryeministrit Rama ishte një shfaqje e shëmtuar.

Nuk dua të marr kohë nga fjala që kam përgatitur sot, që lidhet me një problem shumë të rëndësishëm, i cili ka të bëjë drejtpërdrejt me banorët e zonës së Laprakës, ku shpesh jam mbledhur me ta për të diskutuar një temë shumë sensitive, që lidhet me personat me aftësi të kufizuara. Dua t’ju kujtoj se janë mbi 130 mijë persona sot me aftësi të kufizuara në Shqipëri, ku 1 në 5 të rinj nga mosha 15-24 vjeç janë me

aftësi të kufizuara dhe kanë shumë problematika që nuk merren parasysh. Personat me aftësi të kufizuara kanë dy herë më shumë gjasa të përballen me varfërinë se çdo shtresë tjetër e shoqërisë. Prevalenca e personave me aftësi të kufizuara është më e lartë në zonat më të thella sesa në qytete, gjë që e bën akoma më të vështirë përballimin e shqetësimeve të tyre në spitale dhe me medikamente. Vetëm 50% e fëmijëve, që kanë vështirësi në lëvizje, e ndjekin shkollën në Shqipëri. Edhe pse Shqipëria është anëtare e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara që prej vitit 2006, e adoptuar në OKB, ne si shtet nuk kemi marrë asnjë hap për të shtuar kujdesin ndaj personave me aftësi të kufizuara. Sipas kësaj Konvente kuadër, shteti shqiptar ka detyrë të marrë masat e duhura, duke përfshirë ato legjislative, dhe të ndryshojë praktikat ekzistuese që i diskriminojnë këta individë. Duhet të marrë përsipër jo vetëm luftimin e diskriminimit në shoqëri, por të nxisë punësimin dhe të krijojë lehtësitë e duhura për ta. Duhet, gjithashtu, t’u sigurojë personave me aftësi të kufizuara akses në asistencë, pajisje ndihmëse që i ndihmojnë ata të lëvizin e të tjera. Pra, në thelb, shteti shqiptar ka detyrë të garantojë të drejta ekonomike, shoqërore dhe kulturore ndaj tyre dhe jo t’i lërë në mëshirë të fatit. Shumë prej tyre sot luftojnë për të drejtat minimale, siç janë: ilaçet dhe aksesueshmëria në institucionet publike apo në rrugë. Në shumicën e rasteve ndodhen të izoluar brenda shtëpive të tyre dhe e kanë të vështirë të bëjnë një jetë sadopak normale, të jenë të pavarur, pa ndihmën e dikujt. Shteti sot krijon artifica nga më të ndryshmet dhe nuk i zbaton detyrimet ligjore ekzistuese, siç është krijimi i listave shtetërore me medikamente, që shpeshherë janë të limituara dhe shumë prej tyre detyrohen t’i blejnë këto ilaçe; kanë mungesë të theksuar të trajtimit mjekësor dhe nuk janë në gjendje që t’i përballojnë këto shpenzime.

Patjetër që ekzistojnë abuzues në këtë skemë, por mendoj se abuzuesi kryesor është qeveria që i sfilat këta persona, të cilët kërkojnë të drejtat e tyre, dhe shmanget nga përgjegjësitë e saj. Sot të paktën në institucionet publike duhej të ishin të punësuar 1 në 25 persona me aftësi të kufizuara, ndërkohë që kjo praktikë është gati inekzistente.

Një tjetër problem është mungesa e qendrave rehabilituese, si dhe mungesa e pavijoneve të posaçme pranë QSUT-së. Nuk ka fare qasje humane ndaj rasteve emergjente apo të rënda, që kërkojnë ndihmë të shpejtë, sepse këta persona nuk kanë mundësi financiare. Sipas Konventës, ndaj grave dhe fëmijëve më aftësi të kufizuara duhet ketë një kujdes të shtuar, sepse ata ekspozohen edhe më shumë ndaj diskriminimit dhe pamundësive financiare.

Pra, sot Shqipëria është jashtë çdo standardi për t'u kujdesur për këta individë. Skemat e qeverisë për të marrë përsipër zbatimin e kësaj Konvente kuadër janë farse dhe nuk kanë asnjë lloj zbatueshmërie.

E ngre këtë problem, sepse mendoj se është një problem serioz që nuk është ngritur në këtë parlament dhe sjell në vëmendje se kjo shtresë duhet të ketë një kujdes të veçantë, sidomos nga socialistët, nëse pretendojnë se janë të tillë. Por sot nuk e di realisht pse socialistët votojnë për Partinë Socialiste, kur kjo parti nuk kujdeset për personat në nevojë, kur ka privatizuar pronën publike dhe e përdor si t'i dojë qejfi për përfitime personale, kur kjo parti ka futur dorën të xhepat e shqiptarëve më shumë se asnjëherë në këta 30 vjet dhe ka pasuruar vetëm një grup të vogël njerëzish, duke ndarë fitimet me ta. Sot nuk kemi asnjë investim të huaj dhe e ardhmja europiane e Shqipërisë po cedon çdo ditë. Sot kjo qeveri nuk pyet më as për socialistët dhe as për të varfrit, por vetëm për pushtetin e saj në shërbim të një personi të vetëm: Edi Ramës. Sot partitë janë kthyer në ndërmarrje në shërbim të kryetarëve dhe qytetarët shqiptarë nuk e gjejnë veten të përfaqësuar nga deputetët e tyre. Janë pikërisht këta kryetarë partish që e kanë minuar shpresën tonë dhe e kanë e ndaluar...

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Hajdari!

Fjalën e ka deputetja Senida Mesi. Të përgatitet deputeti Kostaq Papa.

Senida Mesi – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ashtu si javën e kaluar, Kuvendi, tashmë për herë të dytë, e ndërpreu aktivitetin e tij normal, për shkak të "Javës së gjelbër", që të ndodhemi sa më pranë zonave tona elektorale, gjë që, për hir të së vërtetës, e bëjmë vazhdimisht. Pra, ne i dimë problematikat e tyre,

i adresojmë ato pranë Këshillit të Ministrave, por unë e gjej me vend që sot të flasim përsëri për këto problematika, duke marrë parasysh faktin që jemi në përgatitjen e projektbuxhetit të vitit 2020. Besoj, me mirëkuptimin e të gjitha palëve, sepse buxhetet janë të limituara nga njëra anë, por, nga ana tjetër dëshira dhe nevojat janë pa limit, të përcaktojmë së bashku edhe prioritetet për projektbuxhetin afatmesëm 2020-2021.

Po kaloj në detaje në lidhje me Bashkinë e Shkodrës. Duke marrë në konsideratë zgjedhjet lokale të 30 qershorit dhe nevojën e një reformimi të të gjitha institucioneve të varësisë, të ministrive dhe agjencive të përgjithshme, kemi nevojë imediate për drejtues të institucioneve, të cilët do t'i japin Shkodrës atë që i ka munguar: ndërtimin e mëtejshëm të institucioneve dhe ofrimin e shërbimeve dinjitoze, pa interesa politike dhe personale, por duke pasur parasysh të mirën e përbashkët.

Gjej rastin këtu të falënderoj të gjithë ata bashkëqytetarë, që kanë shprehur interesin për të aplikuar në të gjitha vendet vakante në drejtori dhe u bënë thirrje ministrive të linjës, agjencive të përgjithshme për të vazhduar procesin e selektimit, me qëllim që të kemi më të mirët, më profesionistët, ata menaxherë dhe drejtues që janë provuar se janë dhe dinë të jenë të suksesshëm dhe që kanë integritet të lartë në krye të institucioneve në Bashkinë e Shkodrës.

Dua të kaloj shkurtimisht në disa problematika dhe sugjerime që duhen marrë parasysh edhe në projektbuxhetin e vitit 2020, i cili e di që do të jetë edhe më i detajuar në muajt që do të vijnë.

I kam kërkuar Drejtorisë Rajonale Arsimore, me qendër në Lezhë, gjendjen aktuale të arsimit parauniversitar dhe të të gjithë infrastrukturës shkollore në qarkun e Shkodrës, në veçanti në Bashkinë e Shkodrës. Së bashku me kryetarët e bashkive, me drejtorët e zyrave vendore, nën orientimin dhe monitorimin e Ministrisë së Arsimit, ne duhet të përcaktojmë prioritetet për investime në ato shkolla ku numri i nxënësve është i madh dhe ku, si rezultat i mungesës së infrastrukturës, cenohen cilësia e mësimdhënies, siguria dhe shëndeti.

Në lidhje me shëndetësinë është bërë shumë në Bashkinë e Shkodrës, dhe gjej rastin të falënderoj jo vetëm ministren e Shëndetësisë, por edhe qeverinë për investimet në vitin 2018, për

rikonstruksionin e disa qendrave shëndetësore si në: Bërdicë, Velipojë, Ranxë, Bushat! Por dua të ngre shqetësimin që lidhet me gjendjen e amortizuar të disa qendrave shëndetësore të tjera, që duhet t'i kemi në prioritet vitin që vjen, si në: Grudë e Re, Shtoj i Ri, Dobraq, Hajmel dhe në Shkodër në lagjen "Salo Halili". Edhe infrastruktura spitalore në repartin e fizioterapisë, të pediatriës dhe sallat e operacionit kanë nevojë për ndërhyrje, me qëllim që të jenë në nivel bashkëkohor dhe të ofrojnë shërbime, sepse në spitalin e Shkodrës kemi mjekë të mrekullueshëm, të aftë dhe profesionistë.

Në lidhje me zhvillimin ekonomik përmes kulturës dhe sportit, duhet të sjell në vëmendje të Ministrisë së Kulturës rivitalizimin e kalasë së Rozafës dhe përfundimin e fazës së dytë të rikonstruksionit të teatrit "Migjeni" dhe të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve ndërtimin e kompleksit sportiv disiplinor, duke synuar që nëpërmjet sportit, sepse Shkodra është kampione në volejboll, basketboll, tenis, not, të edukojmë rininë, t'i heqim nga rruga dhe nga baret...

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Mesi!

Fjalën e ka deputeti Kostaq Papa. Të përgatitet ministria Elisa Spiropali.

Kostaq Papa – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Tiranës në Unazë të Re, Astir dhe Shkozë, që keni probleme me planifikimin e vonuar apo me korrupsionin shtetëror dhe atë të pushtetit lokal,

Të nderuar qytetarë të rretheve që keni probleme me bashkitë për privatizimet, për pronësinë, për posedimet,

Të nderuara familje të pastreha dhe në nevojë,

Po ndalem direkt te "patatja" më e nxehtë e politikës së brendshme, e cila për një vit po shndërrohet në një problem, në një gangrenë. Po bëhet një vit që nga 3 nëntori, në mos gaboj. Ka ardhur momenti që ky problem të zgjidhet drejt dhe jo në kurriz të qytetarëve që kanë këtë shqetësim të madh. Është e qartë si drita e diellit se fajtori kryesor është shteti, të cilit i ka munguar dhe vazhdon t'i mungojë planifikimi dhe parashikimi zhvillimor urban i kryeqytetit, por edhe i qyteteve të tjera për një dekadë apo

për 15 vjet, se për 50 vjet as që bëhet fjalë. Shteti ynë dhe pushteti lokal në kryeqytetit i zhytur në skandale tenderësh dhe në korrupsion galopant nuk kanë pasur asnjë ide, asnjë planifikim për shtrirjen urbane të Tiranës në këta njëzet e pesë-tridhjetë vitet e fundit e jo vetëm. Kështu, u gjendëm para kaosit urban, të utopisë urbane të shkaktuar nga lëvizja e brendshme kaotike emigrative e shqiptarëve, kur më shumë se gjysma e popullsisë ndryshoi vendbanimin e dikurshëm të imponuar nga diktatura.

Edhe në dekadën e fundit, kur kurba e lëvizjes së brendshme u stabilizua disi, sepse nuk kishte ç'të zbriste më nëpër qytetet e mëdha dhe në periferitë e tyre, sepse një të tretën e popullsisë shqiptare e mori emigrimi drejt vendeve perëndimore, shteti fjeti gjumë dhe nuk përpiloi plane urbane, por ngeli vetëm në konstatime politike dhe debate fjalësh me krahun tjetër politik. Në fund të fundit, moszgjidhja e problemeve të qytetarëve tregon se të dyja krahët rrinin ujin në hava, vetëm e vetëm që të kishin të fortë partinë për pushtetin qendror e për pushtetin lokal.

Para se t'i hyjmë me themel problemit në Unazën e Re të Tiranës, në mënyrë aksiomative kërkoj që tre banorëve demonstrues të zonës së Astirit, që janë dënuar nga gjykata, t'u hiqen masat, sepse ata kanë protestuar për të drejta legjitime e themelore, siç është e drejta për të pasur banesën familjare, e drejta për pronën, e drejta për strehën, e drejta për të mbajtur familjen.

Në vende të tjera, me rastin e ngjarjeve apo të festave, policia, prokuroria apo gjykata, me veprimet e tyre kryejnë procedura vetëm sa për të ftohur gjakrat dhe për të shmangur përplasje më të rënda; bëjnë shoqërime të disa eksponentëve dhe aktivistëve më brutalë, siç janë jelekverdhet e Francës, bëjnë ballafaqime ligjore, i ndalojnë disa orë, me procedura gjykimesh që kryhen përmes konstatimeve dhe vërejtjeve e pas 24 orësh i lënë të lirë.

Para se t'i hyj me themel, po ju them: mos ushtroni shantazh dhe mos bëni makinacione ndaj qytetarëve në Astir, në Shkozë apo në sektorë të tjerë të Unazës që do të dalin më pas, ku konfigurimi nuk është përcaktuar ende plotësisht. Përplasja me qytetarët duhet të ndërpritet menjëherë. Ju duhet të vini para përgjegjësisë administrative dhe ligjore jo

qytetarët, por ata që e bënë këtë tender korruptiv, që do t'i dhuronte miliona një kompanive fantazmë. Shtetarët, që bënë tenderin dhe falsifikatorët e firmës fituese, duhet të shkojnë në vendin që u takon.

Kush mund të besojë se shteti nuk dinte gjë në lidhje me firmën fantazmë? Kaq filtra kontrollues paska pasur, sa brenda vetëm dhjetë minutave e zbuloi një gazetar i thjeshtë?! Pra, duket qartë se ishte një korrupsion i pastër, për t'iu rrëmbyer shtetit dhe taksapaguesve shqiptarë miliona e miliona lekë për t'i gëzuar dhe për t'i shijuar në drejtim të paditur.

Edhe pse çdo alibi e çdo justifikim ka rënë, qëkurse doli se firma kishte falsifikuar një dokument përtej oqeanit, por nuk ekzistonte gjekundi, ju në vend që të gjeni fajtorët e hajdutët dhe të shpëtoni paratë publike, lejoni që paratë dhe hajdutët e firmave të tenderëve të zhduken, pasi edhe ju keni pjesë të madhe fitimi në këta tenderë. E gjithë kjo për të tërhequr vëmendjen që media të ndryshojë zhurmën për gjetjen e hajdutëve me zhurmën që bëhet nga përplasia e banditëve me policinë dhe qytetarët. Është një përplasia tinëzare, dinake dhe e sofistikuar e policisë me qytetarët, me hallexhinjtë në Astir, në Shkozë e gjetiu. I shtypni qytetarët hallexhinj e të stresuar, si në kohën e Haxhi Qamilit. Keni gjakosur edhe nëna me fëmijë në gj, pleq të pamundur e të sëmurë, a thua se kjo betejë për kryerjen e një rikualifikimi apo riprojektimi urban, me të gjitha elementet e tij, realizohet vetëm përmes rrahjes, sakatosjes, dëmtimit, shpërfytyrimit, gjakosjes dhe gjunjëzimit të qytetarit!

Më të këqijat fare, ato që e shpërfytyrojnë shtetin, duke ia humbur krejtësisht legjitimitetin në lidhje me të drejtën e ndërtimit të veprave të mëdha të karakterit publik, janë veprimet që shteti kryen në errësirë për të kthyer ekuilibrat për të përparuar shembjet, për të gjunjëzuar familjet, shumë prej të cilave kanë një vit që janë nën qiell të hapur. Këto veprime të ulëta e të pista nuk i kanë hije një shteti bashkëkohor apo një administratë reformatore, sikurse pretendoni ju, asnjë pushteti lokal që duhet të jetë në shërbim të qytetarëve.

Ngjarjet në Unazën e Re tregojnë se sa larg është pushteti lokal nga qytetarët. Ngjarjet kanë precipituar keq dhe pozicionet e palëve janë në ekstrem. Stresimi i familjeve dhe nervat e

tendosura në lidhje me hallin që i ka zënë, parametrat e shtetit nga korrupsioni i shtetarëve lokalë e qendrorë, por edhe ardhja e shirave të dimrit, nuk lënë shteg tjetër veç zgjidhjes së problemit. Duhet të zgjidhet problemi. Deri tani nuk është kërkuar zgjidhja e problemit, por zvarritja e tij dhe përplasia me qytetarët për të bërë zhurmë e për të tërhequr vëmendjen nga problemet e tjera. Zgjidhje e problemit do të thotë të bisedosh me qytetarët, do të thotë të shpaloset para tyre planifikimi urban i zonës jo në dimensionet e korrupsionit, por në dimensionet reale të veprës dhe në zvogëlim të dëmit të familjeve të përfshira në kaosin që keni shkaktuar ju. Plani juaj në Astir, por edhe argumentet në lidhje me segmentet e tjera të Unazës së Re, ishte bashkëngjitur paralel me rrugën e infrastrukturës, dhe hapësira që do të përfitonin tenderbërësit, firmat fantazma të korrupsionit dhe fituesit e tenderëve. Sa për familjet, ato do të hidheshin në rrugë si pasojë e interesave korruptive joubane.

T'i jepet zgjidhje problemit. Unë propozoj të krijohet një grup ndërmjetësues deputetësh, banorësh dhe specialistësh. Grupi i deputetëve të përbëhet nga shtatë deputetë, katër deputetë të Tiranës dhe tre të rretheve, sepse kjo formë është përdorur edhe për zgjidhjen e problemeve në rrethe. Grupi i qytetarëve të përbëhet nga pesë deri në shtatë qytetarë: pesë nga Astiri e dy nga Shkoza, ose katër nga Astiri e tre nga Shkoza, si përfaqësues të banorëve. Grupi i specialistëve të përbëhet nga pesë-gjashtë inxhinierë urbanë të sektorit publik e privat. Në mënyrë të përbashkët grupi do të kontaktojë me qytetarët dhe do të shpalosë planin real, të justifikueshëm e të pranueshëm e jo planin korruptiv. Para se t'u paraqitet plani real qytetarëve të Unazës së Re, duhet të ndërpritet çdo marrëzi e shtetit dhe e pushtetit lokal ndaj qytetarëve. Gjatë nëntorit e dhjetorit të bëjnë takime intensive me qytetarët, për shtrimin e zgjidhjes së problemit.

Si deputet i Tiranës, kërkoj të ndalet çdo veprim dhe çdo manipulim ndaj qytetarëve, sepse prej disa muajsh në Astir, por edhe para disa ditësh në Shkozë, janë nxjerrë nën qiell të hapur familje, të moshuar, fëmijë, nëna me fëmijë në gj, nga ju, antihumanë, që Zoti do t'ju ndëshkojë!

Të jeni të sigurtë që, nëse plani do të jetë real dhe jokorruptiv, ai do të gjejë përkrahje dhe

zbatueshmëri, por ju nuk keni të drejtë t'i prishni shtëpitë dhe t'i hidhni në rrugë familjarët, të cilët shtëpinë e kanë ëndërr të jetës dhe strehë për të futur kokën. Ju nuk mund t'i prishni ato pa ofruar ekuivalencën e tyre dhe mbrojtjen e familjeve të dëmtuara.

Ndaloni çdo veprim që ta zgjidhni këtë problem në dobi të qytetarëve, në dobi të qytetit të Tiranës dhe të gjithë shqiptarëve. Nuk e kuptoj pse e zgjasni dhe vazhdoni përplasjet me qytetarët. Nuk e kuptoj: ju doni konfliktin apo zgjidhjen e problemit? Nëse doni zgjidhjen, le të ulemi e të diskutojmë çdo detaj me qytetarët.

Po kështu edhe për teatrin. Tiranës metropol, kryeqytetit tonë të dashur, i duhen shumë teatro, kështu që, fillimisht, bashkia dhe qeveria duhet të ndërtojnë në një parcelë tjetër një teatër të ri bashkëkohor. Po ashtu, të ngelin si teatro edhe ato ambiente që konsiderohen si skena apo si teatro provizore.

Ndërkohë, Teatri Kombëtar, i cili mbart historinë e teatrit, të restaurohet, që të vazhdojë të ekzistojë si teatër, por edhe si muze i teatrit, edhe si muze i kujtesës, pasi aty kanë ndodhur ngjarje të rëndësishme gjatë periudhës së diktaturës, si gjyqet e stisura politike ndaj deputetëve dhe intelektualëve të Tiranës, si dhe plot akte të tjera politike, që stigmatizuan personalitete, individë, patriotë, deputetë, intelektualë, artistë e specialistë, të cilët ndëshkoheshin në dobi të politikës momentale të kastës së diktaturës.

Ka probleme edhe në qytete të tjera. Probleme mes qytetarëve dhe bashkive nëpër rrethe ka plot. Pothuajse në të gjitha bashkitë ka situatë përplasjeje midis banorëve dhe administratës së pushtetit lokal, për privatizimet, objektet apo gjurmët e objekteve. Më shumë se nga varfëria dhe gjendja e familjeve të pastreha, këto probleme kanë ardhur nga kërkesat joligjore dhe korruptive të personave të pushtetit lokal, por edhe qendror, që kanë marrë pjesë në këto procese privatizimi dhe pronësi. Korrupsioni i tyre i hapur në dëm të familjeve të pamundura dhe në gjendje të rëndë social-ekonomike, ka bërë që proceset të ngecin dhe të mos kryhen në mënyrë të plotë ashtu siç qenë destinuar.

(Bie gongu)

Pothuajse çdo bashki apo qytet ka pasur objekte që ngelen...

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Papa!

Fjalën e ka ministrja Elisa Spiropali. Të përgatitet deputeti Ralf Gjoni.

Elisa Spiropali – E nderuara drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

“Një gabim strategjik” e quajti rezoluta e Parlamentit Europian mosmarrjen e vendimit nga Këshilli Europian për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Parlamenti shprehu zhgënjimin e thellë ndaj dështimit për të rënë dakord në samitin e BE-së, dhe jo ashtu siç thonë opozitarët tanë në rrugë: refuzimin e Shqipërisë e të Maqedonisë së Veriut, pra mosmarrjen e vendimit për fillimin e bisedimeve me këto dy vende. Eurodeputetët shprehin keqardhje në lidhje me vendimin e Francës, kryesisht, por edhe atë të Holandës e të Danimarkës, për të bllokuar vendimmarrjen, dhe thonë se Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë bërë jo vetëm përpjekje të konsiderueshme gjatë viteve të fundit, duke i plotësuar kriteret e Bashkimit Europian për të filluar bisedimet, por që të dyja vendet i plotësojnë tërësisht kushtet për negociatë të menjëhershme dhe pa kusht. Sigurisht, vlerësojnë përpjekjet e jashtëzakonshme të Maqedonisë së Veriut dhe marrëveshjen dypalëshe me Greqinë, si dhe mirëpresin e mbështesin reformën e fundit gjyqësore në Shqipëri, e cila në të gjitha raportet ndërkombëtare konsiderohet si reformë radikale, në fakt si reformë pioniere në rajonin e Ballkanit.

Po ashtu, parlamenti shpreh shqetësimin për aktorë të huaj, që mund të angazhohen më tepër në Shqipëri e në Maqedoninë e Veriut, aktorë që në fakt mund të mos kenë asgjë të përbashkët me vlerat dhe interesat e Bashkimit Europian. Një reformë e procesit të zgjerimit, e mbrojtur nga disa vende, nuk duhet ta pengojë Shqipërinë e Maqedoninë e Veriut, të cilat tashmë i plotësojnë kërkesat, për t'u vlerësuar në bazë të meritave të tyre dhe kriterëve objektive, dhe jo të paragjykojnë nga axhendat e brendshme politike të vendeve të Bashkimit Europian, thuhet në tekst.

“Koha për hapjen e negociatave është tani”, theksohet në këtë rezolutë. Ka një keqardhje dhe zemërim të kuptueshëm, në fakt, mbareuropian, edhe mbarëkombëtar, këtu në raport, me këtë mungesë veprimi.

Kancelarja gjermane, Angela Merkel, e cila e udhëhoqi personalisht këtë betejë të vështirë,

siguroi se Gjermania do të vazhdojë ta mbështesë Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut dhe se do të bëhet më e mira për të dyja vendet ballkanike.

Kryeministri i Italisë, Conte, foli për historinë osmane dhe komuniste, si dy përcaktuese fatkeqe të historisë së ndarjes së Ballkanit Perëndimor nga Europa, dhe vendimin e Këshillit European e quajti një gabim historik.

Pra, deri më tani “gabim strategjik” dhe “gabim historik”, shprehur nga aktorë kryesorë të Bashkimit European.

Kancelarja në detyrë e Austrisë, po ashtu shprehu zhgënjimin e thellë në lidhje me mungesën e vendimmarrjes dhe dritëshkurtësinë për këtë akt të gabuar.

Reagim i fortë i Departamentit Amerikan të Shtetit, i cili po ashtu shprehu zhgënjim në lidhje me vendimin e padrejtë, duke provuar kështu se Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të vazhdojnë të jenë aleatët tanë strategjikë për të mbrapsur cilëndo forcë që mendon se tani ka një hapësirë, një vakuum, që mund ta përdorë në rajonin e Ballkanit.

Reagimet vazhdojnë varg. Presidenti i Këshillit European, Tusk, sigurisht që e bëri deri në fund betejën e tij, si dhe vazhdon të inkurajojë Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut në lidhje me hapat në vazhdim, sepse beteja nuk mbaron këtu.

Presidentja e zgjedhur e Komisionit, presidenti aktual i Komisionit, Junker, e konsideruan po ashtu gabim historik mbajtjen pezull të dy vendeve. Komisioneri për Zgjerim, Hahn, shkoi më larg, duke deklaruar se të dyja vendet i mbajtën premtimet e tyre, ndërsa Këshilli dështoi për shkak të problemeve të brendshme. Për të mos folur pastaj edhe për eurodeputetë si Kukan, një eurodeputet i djathtë, njohës i mirë i Shqipërisë dhe i ndërlikimeve në rajon, i cili shprehu dhe theksoi neverinë dhe indinjatën për atë që e quajti sabotim dhe papërgjegjshmëri të Francës dhe Makron në lidhje me procesin e zgjerimit. Dhe lista vazhdon pa fund.

Sigurisht, është inkurajuese, por në fakt edhe prekëse, të shohësh se sa shumë mbështetës ka Shqipëria, e cila sot është më pranë se kurrë kapërcimit të keqkuptimeve historike me Europën.

Në gjithë këtë solidaritet edhe kombëtar, edhe mbareuropean, nuk mund të mos të vijë

keq për ca politikanë të papërgjegjshëm, të cilët kanë bërë çmos për ta minuar këtë proces: kanë dorëzuar mandatet, kanë organizuar protesta të dhunshme, nuk kanë marrë pjesë në zgjedhje, nuk kanë lënë derë eurodeputeti dhe zyrë miku apo partie aleate pa folur për Shqipërinë, duke e nxirë atë. Më kujtohet një eurodeputet, i cili në një prej takimeve tona ka thënë: “Më bëjnë habi këta opozitarët tuaj se vijnë këtu dhe thonë: “djali ynë”, metafora ishte për Shqipërinë, është një trafikant, por ju merreni atë për burrë, pra martohuni, çelini negociatat”.

Ata që janë jashtë, jo ju që jeni brenda, sepse ju keni qëndrim më konstruktiv, përveç kushteve që keni vendosur kohët e fundit, zoti Gjoni.

Pra, është e paimagjinueshme që në të gjitha këto qëndrime, që janë publike, të ketë shqiptarë, të cilët refuzojnë të bashkëpunojnë ose të paktën të vënë interesin e tyre dhe interesin tonë kombëtar mbi interesin e tyre partiak apo elektoral. Në fakt, as interesi i tyre elektoral nuk është, sepse e kanë dëshmuar herë pas here, humbje pas humbjes, tri apo katër herë rresht, që njerëzit nuk e blejnë atë retorikë, përkundrazi e refuzojnë me forcë. Ka ardhur koha të ndryshojë kjo marrëdhënie që kemi me interesin dhe solidaritetin tonë kombëtar. Konkretisht, tani është koha të bëjmë disa prej detyrave të shtëpisë siç është thellimi i reformës në drejtësi, për të cilën kemi rënë dakord të gjithë dhe tani është koha që ata gjykatësit dhe prokurorët, të cilët kanë dalë nga sistemi, por ende vazhdojnë t'i shijojnë privilegjet, të përballen, ashtu siç thotë edhe raporti i Bundestagut, me ligjin. Patjetër që edhe Komisioni i Posaçëm i Reformës Zgjedhore duhet të bëjë detyrën në raport me rekomandimet e OSBE-ODIHR-it. Ne e kemi një opozitë jashtë që reflekton dhe mishëron më së miri atë që thoshte Gjergj Fishta: “Si janë shqiptarët? Si i don armiku”. Të paktën ne të jemi siç na do Shqipëria.

Shumë faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Spiropali!

Fjalën e ka deputeti Ralf Gjoni.

Të përgatitet deputetja Reme Lala.

Ralf Gjoni – A e patë, të nderuar qytetarë, grupin e Partisë Socialiste në parlament? E tha pa asnjë lloj problemi që hallet tuaja, që ne duhet t'i sjellim në këtë parlament një herë në muaj, të

mos presim që të merren në konsideratë si politika qeverisëse të kësaj qeverie. Pra, kjo do të thotë që ne, sipas Rregullores, mund të vijmë këtu të flasim pa fund për hallet e këtij, të atij, të atyre dhe asnjë nga problematikat që ngremë këtu në parlament të mos merret në konsideratë, sepse paska instrumente dhe mekanizma të tjerë në parlament.

Pse e ngre këtë shqetësim? Sepse ky është shqetësimi kryesor i qytetarëve shqiptarë. Qytetarët shqiptarë nuk ndiejnë asnjë nivel përfaqësimi në këtë parlament dhe nuk ndihen afër politikëbërjes dhe vendimmarrjes, sepse asnjë nga kërkesat e tyre dhe nga nevojshmëritë e komuniteteve të shoqërisë shqiptare nuk merret parasysh nga kjo maxhorancë.

Zonja drejtuese e seancës,

Maxhoranca aktuale socialiste, të nderuar qytetarë, po tregohet gjithnjë e më shtypëse, gjithnjë e më dhunuese, gjithnjë e më arrogante jo vetëm ndaj kërkesave tuaja, por edhe ndaj nesh si opozitarë të rinj këtu në parlament. Maxhorancën e kanë, ekzekutivin e kanë, ushtrinë e kanë, policinë e kanë, 61 bashki i kanë, ndërsa ne këtu jemi të cunguar, sepse nuk na janë përmbushur të gjitha vendet dhe vakancat e opozitës në parlament dhe prapë këta sillen si korporatë ndaj nesh këtu në parlament, kur ngremë problematika dhe çështje brenda Rregullores dhe etikës së parlamentit. Këta sillen si SHKA (Shoqëri Klienteliste Aksionerësh).

A e patë se çfarë ndodhi të enjten e kaluar, të nderuar kolegë? Ngritëm disa shqetësime legjitime për Korporatën e Investimeve Shqiptare. U acaruan, u ngritën pupthi, filluan të na shanin dhe të na ofendonin nga ekzekutivi, të na dhunonin të drejtën e fjalës.

Zonja drejtuese e seancës dhe Kryetari i Kuvendit janë kthyer në një vegël të rëndomtë në shërbim të ekzekutivit dhe të maxhorancës, duke i mohuar të drejtën e fjalës opozitës në parlament. U ndezën motorët e mercenarëve medietikë në shërbim të pushtetit dhe të parave të pista të pastruara nga oligarkët; u ndezën gazetarët dhe mediet. Çfarë ndodhi, qytetarë? Asnjë medie kryesore në lajmet e pasdites nuk u mor me korporatën, të gjithë u morën me Majlindën, e cila duhet ngritur si fenomen, sepse Majlinda është një deputete e re. U ngrit këtu dhe foli kundër korporatës, ngatërroi fjalët, pati emocione, nuk tha korporata, por tha “koperata”.

Të gjithë u morën me Majlindën, u investua maxhoranca që të theksohej Majlinda dhe koperata dhe jo korporata. Çfarë nuk u tha këtu dhe çfarë nuk u tha në media? Që Majlinda, pavarësisht se e lexoi gabim fjalimin që kishte përgatitur, votoi kundër korporatës. Nuk u tha në media që maxhoranca dhunuese socialiste po investohet që të influencojë negativisht deputetë të grupit opozitarë për të telekomanduar votën e tyre në shërbim të oligarkëve që i shërbejnë pushtetit të radhës. Kjo nuk u tha në medie.

Përse mediet kryesore oligarkike e bojkotuan seancën e javës së shkruar ku u fol për korporatën? Sepse nuk duan që të dalë në pah kriza e përfaqësimit në parlament. Edhe një bashkënjohësi im, analist, gazetar, ka bërë bujë këtë javë, sepse ka shkruar një “analizë”, ku bën thirrje për shpërndarjen e menjëhershme të parlamentit dhe për zgjedhje të parakohshme që nesër. Ishte gati ai, në emër të cinikëve dhe të njerëzve të zgjuar të Shqipërisë, këta që e shohin çdo gjë me cinizëm, që të bëheshin zgjedhje që nesër, mjafton që të ikin këta palaçot që kanë hyrë tani në parlament. Edhe media pranë qeverisë i dha zë kësaj pseudoanalize, sepse problemi i Shqipërisë qenkemi ne këtu në parlament, nuk qenka korporata.

Në vend që ky analist të merret me krizën e përfaqësimit në parlament dhe me thelbin e problemit që është te sistemi zgjedhor dhe listat e hapura, merret me faktin që problemi është opozita në parlament dhe duhen hequr menjëherë që të bëhen zgjedhjet. Po mirë, more analist i nderuar, në qoftë se bëhen zgjedhjet sot ose nesër me këtë Kod Zgjedhor, me lista të mbyllura, çfarë përfaqësimi do të kesh ti, analist i nderuar në parlament? Të njëjtin përfaqësim, në mos më keq, deputetësh, listash të bajraktarëve që i telekomandojmë me *Whats' Ap*. Ky është parlamenti që ti dëshiron të shohësh në vend të këtij parlamenti që ke sot?

Injorohet edhe fakti tjetër që për herë të parë në 10 vjet po trumbetohet dhe po flitet për sistemin zgjedhor dhe nevojshmërinë e ndryshimit të këtij sistemi si thelbi i së keqes në këtë vend i çdo krize politike. Për herë të parë në 8 muaj angazhim me praninë tonë në parlament kemi arritur të bëjmë kauzë sistemin zgjedhor. Të gjithë po flasin për sistemin dhe për listat, prapë maxhoranca tregohet shtypëse, edhe në Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore,

edhe në parlament dhe nuk do ta diskutojë sistemin. Ata që dolën jashtë, në sintoni të plotë me këtë maxhorancë, thonë...

Vasilika Hysi – Të lutem, teknika llogarisni kohën, sepse nuk punon minutazhi!

Faleminderit!

Ralf Gjoni – Mos kini merak se jam brenda minutazhit, zonja drejtuese e seancës!

Pra, edhe ata që dolën jashtë parlamentit janë në sintoni të plotë me maxhorancën, nuk duan ndryshim sistemi dhe nuk njohin legjitimitetin e deputetëve të parlamentit dhe të Komisionit për Reformën Zgjedhore.

Zoti Balla, ju folët për OSBE-ODIHR-in dhe një nga rekomandimet kyçe të tyre është depolitizimi i administratës zgjedhore, duke filluar që nga KQZ-ja. Dakord! Në komision do të flasim edhe për transparencën e financimit të partive, por, nëse ju doni që ne të votojmë OSBE-ODIHR-in këtu, po jua përsëris edhe një here, nuk ka reformë me dy faza, hajdeni ta bëjmë brenda dhjetorit bashkë me depolitizimin total të tërë administratës zgjedhore. Ne do t'ju sjellim propozimin tonë konkret për këtë pjesë, KQZ-ja, administrata zgjedhore, ata që administrojnë dhe numërojnë votat nuk duhet të kenë më asnjë influencë partiake.

Partitë politike, të nderuar qytetarë, duhet të heqin duart dhe kthetrat e tyre nga sistemi zgjedhor.

Po pra, po, me propozime konkrete, zoti Balla, jo me fjalë boshe siç thoni ju këtu, si dhe të hapen edhe listat. Nëse ju keni vullnet dhe këllqe që të futeni në zgjedhje, që këtë pranverë nëse doni, hajde të hapim listat, të depolitizojmë administratën zgjedhore dhe të futemi në zgjedhje. Ne do të jemi të gatshëm së bashku me grupimet e shoqërisë civile që të përfaqësohemi në ato zgjedhje me emra të pastër dhe jashtë çdo lloj telekomande bajraktarike.

Folët edhe për negociatat.

Zoti Balla, mos ia vini fajin Makronit. Vërtet kulaçi dhe tërbaçi, shkopi dhe karota kanë ekzistuar në politikën dhe filozofinë e BE-së, por karota është zëvendësuar...

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Gjoni!

Kam unë një replikë prej 2 minutash dhe më pas edhe zoti Balla.

Më përmendët dy herë mua dhe Kryetarin e Kuvendit lidhur me mënyrën se si kemi drejtuar seancën.

E para, dua t'ju tërheq vëmendjen për gjuhën joetike që keni përdorur sot dhe për etiketimin që u bëni drejtuesve të seancës.

E dyta, kjo seancë është zhvilluar në bazë të nenit 40/1 të Rregullores së Kuvendit, të cilin e kemi miratuar të gjithë së bashku dhe këtu adresohen shqetësime. Nëse ju jeni të pakënaqur me mënyrën se si trajtohen shqetësimet që ngrënë deputetët, ju vetë personalisht nuk ngritët ndonjë shqetësim konkret, do t'ju sillja në vëmendje që keni të drejtë të ushtroni kontrollin parlamentar në bazë të neneve 89 deri në nenin 101 të Rregullores së Kuvendit, ku keni mundësi t'u drejtoni pyetje ministrave, të merrni përgjigje për pyetjet, të zhvilloni seancë pyetjesh, interpelancë, përgjigje pyetjesh në komision, seancë të përjavshme pyetje-përgjigje e të tjera. Ndaj do t'ju lutesha që, nëse flisni për etikë, ju duhet të jeni të parët që duhet ta respektoni etikën ndaj gjithë deputetëve në mënyrë të veçantë ndaj grave.

Faleminderit!

Fjalën për replikë e ka kërkuar deputeti Balla.

Taulant Balla – Në fakt, mua më vjen mirë të dëgjoj nga goja e deputetëve të rinj të opozitës që propozimet tona mbështeten. Të gjithë e dimë që depolitizimi i të tria niveleve të administrimit të procesit zgjedhor është një sfidë për të cilën duhet të japim një zgjidhje. Prej vitit 2015, kur unë bashkëdrejtoja Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore dhe ju, zoti Gjoni, keni qenë në Kuvend, por në cilësinë e këshilltarit të Kryetarit të Kuvendit, tashmë President i Republikës, e dini fare mirë që ne kemi propozuar depolitizimin edhe të komisioneve vendore, edhe atë të administrimit zgjedhor, KZAZ-të, pse jo edhe të KQZ-së.

Ju vini dhe bërtisni tani pse nuk bëhet kjo? Pa dyshim nuk u bë dot, sepse partia jote dhe Partia Demokratike nuk e mbështetën gjatë procesit që filluam në shtator të vitit 2017. Pa dyshim që do t'i heqim dhe duhen hequr duart e partive politike nga administrimi i procesit zgjedhor, sepse nuk është normale në një demokraci që vetë numëron e vetë voton, sepse kështu vetëvotohesh. Prandaj duhet që populli me përfaqësuesit e tij në Kuvendin e Shqipërisë të ndryshojë Kodin Zgjedhor, të hapim mundësinë e vullnetarëve të depolitizuar që të marrin përsipër procesin e administrimit të

zgjedhjeve dhe nuk është e nevojshme prania e 7 komisionerëve aty, por mjaftojnë 3. Unë do të isha që jo vetëm t'i bëjmë, por nëse do të kishte mundësi të ishin 3...

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Balla!

Ju lutem, nuk lejohet replikë për replikë!

Për procedurë e keni fjalën 3 minuta, ndryshe do t'ju pres fjalën.

Ralf Gjoni - Zonja Hysi, e dua fjalën për procedurë.

Seancën e kaluar kërkoja që të merreshin masa ndaj një anëtari të kabinetit qeveritar për mimikën dhe gjuhën fyese që përdori ndaj personit tim dhe maxhorancës.

Nuk është respektuar Kodi i Etikës, nuk është respektuar Rregullorja dhe mënyra e sjelljes së maxhorancës ndaj kësaj opozite, në gjykimin tim, është gjithnjë më ofenduese dhe shtypëse. Nuk kërkoja asgjë më tepër përveçse veprimin tuaj ose të Kryetarit të Kuvendit për marrjen e masave, siç parashikohet në Rregullore.

Pyetja ime është legjitime dhe qëndron: Pse nuk u mor masë dhe pse nuk u qortua anëtari i kabinetit, zëvendëskryeministri në fjalë, për gjuhën fyese dhe kërcënimin që i bëri një anëtari të opozitës parlamentare? Pse nuk u mor masë dhe pse ju vazhdoni t'u tërhiqni vërejtje deputetëve të opozitës?

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Gjoni!

Do t'ju lutesha ta lexonit me vëmendje përmbajtjen e nenit 49 për procedurën dhe si mund të vihet në lëvizje Komisioni i Etikës në parlament. Rregullorja e përcakton qartë.

Fjalën e ka deputetja Reme Lala.

Reme Lala- E nderuara zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Lidhur me problematikën e Dibrës, për atë që shkon dhe nuk shkon në Dibrë, do të flisja shumë gjatë, por, duke qenë se koha është e limituar, kam zgjedhur të fokusohem në një problematikë, atë të shëndetësisë që po kthehet në një dramë. Do të flas për shërbimin shëndetësor që iu ofrohet 78.900 dibranëve. Është spital rajonal ai i Dibrës, por me shërbimin që ofrohet, me trajtimin e pacientëve, me funksionimin aktual që ka nuk mund ta quajmë as ambulator. Në spitalin e Dibrës mungojnë

mjekët, ilaçet, ushqimi dhe për këto arsye them se është gjendje dramatike.

Në fakt, së pari, do të doja të falënderoja ata mjekë dhe infermierë që punojnë në atë spital. Disa prej tyre kanë dalë në pension, janë vetë me probleme shëndetësore, por po japin një kontribut shumë të madh për t'iu shërbyer dibranëve në ato kushte mizerabël.

Mungojnë shumë mjekë specialistë në Dibrë: mjeku i urgjencës, okulisti ORL-ja, infeksionisti, kirurgu, gjinekologu. Mjekët që i kryejnë aktualisht këto shërbime ose kanë dalë në pension, ose janë të vetëm, si pasojë nuk i mbulojnë dot shërbimet. Me gjithë kërkesat e njëpasnjëshme të stafit të spitalit drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, nuk është marrë asnjë masë konkrete. Në muajin mars të vitit 2019 u dërgua një mjek specializant në Dibrë, por që asnjëherë nuk është prezent. Mjekët e caktuar atje përdorin vazhdimisht raporte mjekësore dhe e shtyjnë shkuarjen e tyre në Dibrë me arsyen që dihet se Dibra është larg. Patronazhimi nga QSUT-ja është vetëm në letër, sepse nuk funksionon fare, asnjë mjek nuk ka vajtur në Dibrë për të mbuluar shërbimet e specializuara që kërkohen.

I nderuar zoti Kryeministër,

I nderuar zoti zëvendëskryeministër, edhe pse nuk jeni të pranishëm në sallë do t'ju lutesha të më dëgjoni me vëmendje, sepse besoj se do të ndërhyni shpejt për të marrë masa për këtë persekutim që iu bëhet të sëmurëve në Dibrë.

I drejtohem zotit zëvendëskryeministër, ju lutem, gjejeni kohën të shkoni personalisht në spitalin rajonal dhe të shikoni me sytë tuaj gjendjen në të cilën ndodhet spitali!

Të nderuar deputetë, ju nuk e dini dhe do të habiteni me faktin se në spitalin e Dibrës një i shtruar ushqehet me 83 lekë të rinj në ditë, një pacient ushqehet me 20 gramë bukë në ditë, 40 gramë mish, 5 vetë hanë një vezë, 2 kilogramë mollë në ditë janë për 150 vetë. 20% e të sëmurëve kanë nevojë për trajtim të veçantë, si, për shembull, trajtimet për diabetikët. Më vjen zor të tregoj këto statistika.

Sa u përket investimeve, ka zero investime nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë për përmirësimin e spitalit. Të vetmet investime janë bërë me fondet e vetë spitalit nga të ardhurat dytësore. Edhe pse janë dërguar projekte të shumta në ministri, asnjë prej tyre nuk është

miratuar. Gjithashtu, ambientet e kuzhinës së spitalit janë tejet të amortizuara, lavanteria është pothuajse jashtë shërbimit, sistemi i oksigjenimit për pavion është totalisht i amortizuar dhe ka nevojë për rikonstrukcion nga fillimi, reanimacioni i kirurgjisë nuk ka as krevate, as ambiente dhe as monitorë për të mbajtur nën kontroll pacientin. Unë faktikisht i kam të evidentuara të gjitha problemet që hasin të sëmurët dhe familjarët e tyre në këtë spital, por nuk mund të rri pa ju thënë se atje nuk punon as ashensori, se të sëmurët mbahen në krahë nga familjarët dhe infermierët. Kur dikush vdes në atë spital, fatkeqësisht të afërmit detyrohen ta marrin kufomën në kurriz.

Ndodhur në këto kushte, dibranët e sëmurë detyrohen të vijnë në Tiranë edhe për operacionin e një apendiciti, ose për të sjellë në jetë një fëmijë. Si për t'ia bërë më të vështirë këtë situatë të mjerë, spitalit të Dibrës nuk i është dhënë asnjë ambulancë e re dhe as e përdorur. Janë vetëm 4 ambulanca në gjendje pune dhe asnjëra prej tyre nuk i ka mjetet e duhura, që llogariten për të sëmurët që transportohen. Nuk e kuptoj pse ky diskriminim për Dibrën. A mund të marr një përgjigje, ju lutem, si është bërë shpërndarja e ambulancave të reja? A është bërë mbi bazën e numrit të banorëve, të largësisë së qyteteve? Cila është arsyeja pse Dibra është ende në kushte të tilla, pa investime, pa mjekë e pa ambulanca? Dibra është persekutuar me vite për shkak të largësisë, por kjo gjë duhet të kishte qenë një arsye më tepër për ta pasur me merak pajisjen e spitalit rajonal me ambulanca të reja.

Të sëmurëve në spital iu mungon ushqimi. Edhe pse me shumë fukarallëk, familjarët ia çojnë një pjatë gjellë nga shtëpia, kur është ftohtë i çojnë edhe një batanije, i lajnë vetë edhe çarçafët. Por më thoni ju si do t'ia bëjnë ata për ilaçe? Pse në spitalin e Dibrës ka mungesë të theksuar ilaçesh? Edhe pse procedurat e prokurimeve nga ana e ministrisë fillojnë në mars, deri tani në tetor ato ende nuk kanë mbaruar. Kjo gjë çon në mangësi të furnizimit me ilaçe në spital, pasi deri sa të vijnë kompanitë të lidhin kontratat dhe të livrojnë mallrat, spitali mbetet pa ilaçe.

Në këto kushte a mund ta quajmë më një spital?

Zoti Kryeministër, dibranët i kanë sytë nga ju dhe unë jam besimplotë që ju do të ndërhyni të rregulloni gjendjen e mjeruar të këtij spitali.

Nuk fola sot për të ngritur zërin dhe të them se e bëra punën time, jo, unë dua zgjidhje për ata njerëz, sepse jam e bindur se një pjesë e madhe e këtyre problemeve zgjidhen po të keni ndjenjën e përgjegjshmërisë, vullnetit dhe të mirësisë pa qenë nevoja për shpenzime të mëdha.

Zonja Ministre, mos na lini ju lutem të mendojmë se Dibra nuk është fare në hartën Ministrisë së Shëndetësisë!

Së fundi, do ta mbyll fjalën time me shprehjen e një politikani të njohur: “Nuk ka mëshirë në një sistem që e bën kujdesin shëndetësor një luks, nuk ka mëshirë në një vend që u kthen shpinën atyre që kanë...”

(Deputetes Lala i ka mbaruar koha e diskutimit.)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Lala!

Fjalën e ka zoti Murrizi.

Myslim Murrizi - Faleminderit!

Duke parë patosin me të cilin Balla i kthehet zotit Gjoni (Ralfi me të drejtë e ngriti në këtë foltore fjalimin e zotit Balla, fjalimin e ministres), më kujtohet një shprehje e urtë popullore myzeqare: “Moj Dudi, moj Dudi, ku me ha mua e ku më kruan ti”.

Unë nuk do të merrem as me suksesin e datës 18 tetor, as me mërzitjen e pjesë së maxhorancës, as me gëzimin e pjesës tjetër. Shqiptarët kanë qenë gjithmonë dëshmitarë se sa herë i jemi qasur buzë Europës, ata që kanë qenë në opozitë kanë gjetur se bënë ose Vangjelin në Fier, ose jastëkun e Griseldës në Kavajë, ose gomat e djegura, ose korin e bilbilfryrësve në këtë sallë për t'iu larguar Europës. E vërteta është si drita e diellit se ata që kanë marrë vendime në emër të qytetarëve shqiptarë në këtë sallë prej 29 vjetësh nuk e kanë dashur Europën. Ata që e duan Europën janë qytetarët shqiptarë.

Kam dalë këtu sot për të folur për një problem shqetësues. Media ditët e fundit ka transmetuar lëvizjen e fermerëve myzeqarë: lushnjarë, fierakë, mallakastriotë, beratas për një hall madhor, për bukën e gojës së tyre.

Bujqësia është i vetmi sektor prodhues që kemi ne si vend, të tjerët janë sektorë rrjepës: kemi fasonët që shfrytëzojnë krahun e lirë të punës dhe çfarë vjen, ikën prapë andej nga vjen, kemi minierat, Banker's-in e famshëm, që çdo

ditë dalin ata që kanë futur duart aty dhe herë e mbrojnë nga televizioni Dixhitalb, e herë nga Man Kukaleshi, dixhitali i kryeministrit, që nuk shkruan vetë, por porositi qytetarin dixhital.

I vetmi sektor prodhues që kemi në vend është bujqësia, e cila është lënë në harresë prej vitesh nga qeveritë e të gjitha forcave politike. Fermerët myzeqarë duhet ta dinë që prodhimi i brendshëm bruto është 14 miliardë euro. Trumbetohet me të madhe se i kemi dhënë 20 milionë euro bujqësisë. A e dini në ç'raport është me GDP-në? Është 0.15%. Hidhuni një sy vendeve të rajonit: Malit të Zi, Maqedonisë, Kosovës, e kanë nga 1 në 2,5 deri në 2,6% të PBB –së, që shkon te fermeri, sepse bujqësia është pa çati dhe, nëse shteti nuk vë dorë tek ajo, nuk mund të mbajë veten e vet me bukë, e jo më të dalë me fitim. Po t'i japin 1%, sa 1/3 e rilindjes urbane, sepse 360 milionë euro janë harxhuar për rilindjen urbane, pra t'iu japim atyre 140 milionë euro, për 350 mijë hektarë tokë të punueshme që ka ky vend, 400 euro për hektarë shkojnë drejtpërsëdrejti te fermeri. Ju edhe 20 milionë euro që bëni reklamë të paparë se po ua jepni, ua keni dhënë vetëm atyre duarve që ju japin nga krahu tjetër bakshishin për paratë që marrin. 35 mijë familje fermere ka rrethi i Lushnjës. Ku është ministri i mjaltit? Të më thotë sa fermerë kanë përfituar financim të drejtpërdrejtë për mundin, djersën dhe sakrificat që bëjnë për 12 muaj në vit për atë tokë që kanë? Zero fermerë. 4 vjetët e para ia ngjitet fajin LSI-së, sepse ministri i Bujqësisë ishte i LSI-së. Po tani kush e ka fajin? Kemi ndërruar dy ministra, kujt ia jepni ato para në emër të fermerëve? Ua jepni grosistëve, atyre që dinë të ndajnë me ju. 35 pika grumbullimi ka Lushnja. 27 i kanë mbyllur dyert, 8 mbledhin me një çmim shumë të ulët. Jeni tallur duke u bërë reklamë që i keni ulur dorëzuesit, pra fermerit TVSH-në 6 %. Grumbulluesi e merr me 6 % dhe do ta shesë me 20%, 14% diferencë duhet ta paguajë ai. Çfarë do të bëjë? Do të ulë çmimin e atij që ia merr? 100 lekë është kilogrami i domates në tregun e Lushnjës, 1 mijë lekë shitet në Tiranë.

Sipas ligjit organik të Ministrisë së Bujqësisë, që në vitin 2003 dy mënyra ka shteti për të rregulluar tregun e bujqësisë: ose me financim të drejtpërdrejtë të fermerit, ose të ndërhyjnë në treg. 10-fish më shumë fiton ai që e shet tek "Avni Rustemi" se ai që dergjet për 12

muaj në arë. Dhe ju nuk ndërhyini. Pse? Sepse nuk e keni mendjen te bujqësia, nuk fitoni aty, se nuk është PPP. E keni lënë në harresë, por janë 300 mijë familje shqiptare që ushqehen vetëm me prodhimet e tokës. Në mënyrën e famshme të ligjit nr.7501 ne kemi ndarë tokën nga 1,3, 1,5 maksimalja hektarë për familje dhe me atë tokë të punueshme sa kemi mbajmë rreth 300 mijë familje. 1 mijë hektarë serra ka Lushnja, 70% të serrave të të gjithë Shqipërisë. A i keni financuar ndonjë zorrë uji, ndonjë metër plastmasi. Absolutisht jo. Pse? Ca janë mbështetur për të hequr dorë nga financimi i serrave, u thatë me qesëndisje që të marrin financim për serrat ato duhet të jenë të larta 2,8 metra, kur ju keni pallate në mes të Tiranës me 2,7 metër të larta. Çfarë halli kishit se nuk do t'ua nxinte të parin tuaj kur të hynte të inspektonte serrat? Ku e keni gjetur këtë kriter?

Ashtu sikurse për fermerët që derdhën qumështin para dy vjetësh ju bëtë një ligj, të cilin ende nuk e keni zbatuar, por me një akt normativ të korrigjimit të buxhetit iu thatë se do t'i jepnit lekë për çdo litër qumështi atyre që prodhojnë, ju them sot ose korrigjoni TVSH-në, ose mos u tallni me atë zero TVSH-je për imputet bujqësore, sepse ata, edhe pse keni një vit pra nga 1 janari deri sot që ju keni hequr TVSH-në për imputet bujqësore, i blejnë imputet bujqësore: farat, fidanët, helmet, plehrat dhe çdo lloj kimikati që përdorin për bujqësinë i blejnë me çmime të njëjta siç i kanë blerë para se të hynte në fuqi ligji, sepse ata që i fusin imputet bujqësore këtu thonë që ne i kemi zhdoganuar me 20% dhe ende nuk i kemi mbaruar rezervat dhe nuk dihet nëse kontrollohen nga ju, se sa kohë këta grosistë do të shesin me të njëjtin çmim deri sa ata vetë të deklarojnë që u kanë mbaruar rezervat.

U kënaqa shumë kur pashë në televizor ministrin e Bujqësisë kur tha arritje e madhe e ministrisë sime është se do të çojmë mjaltë në Kinë, madje nuk tha "eksportojmë", por tha "importojmë". Eksportojmë, zoti Çuçi. Po pse mjalti i sa për qind zë në gjithë totalin e bujqësisë, që na qenka një sukses i madh dhe do të shpëtuaka fermerin nga halli e fukarallëku ku është katandisur bujqësia?!

Ju faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Murrizi!

Fjalën e ka deputetja Vilma Bello. Të përgatitet deputeti Lefter Maliqi.

Vilma Bello – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë që na ndiqni,

Duke shfrytëzuar hapësirën e vyer kohore që na ka mundësuar Rregullorja e re për të sjellë në këtë foltore problematikat e qytetarëve në zonat tona dhe për t'u përballur me to, do të doja të ndalesha te një shqetësim, që ka ardhur mbas javës kushtuar zgjedhësve tanë e zonave tona, ku mundësuar bashkëbisedime, takime të drejtpërdrejta me ta, me grupe interesi apo komunitete të caktuara.

Në fjalën time dua të ndalem dhe të fokusohem te një takim që kemi zhvilluar me një përfaqësi grupi naftëtarësh në qytetin e Vlorës, së bashku me kolegun deputet Ismet Beqiraj. Dua ta sjell sot këtë shqetësim.

Jam e sigurt që si për mua, ashtu edhe për kolegët e mi, është një detyrim dhe respekt të flas për ta, për profesionin e vështirë dhe të rrezikshëm për shëndetin dhe jetën e tyre dhe ta përcjell këtu shqetësimin e tyre, që na nxit ne dhe qeverinë për zgjidhje.

Ligji i miratuar në muajin maj të këtij viti u bën një trajtim suplementar shtesë këtyre tri kategorive të veçanta me profesione të vështira: minatorëve, metalurgëve dhe naftëtarëve.

Projektligji i shumë diskutuar, tanimë një ligj, u konsultua me grupet e interesit, me sindikatat përkatëse të minatorëve dhe industrisë së naftës, me individë ish-minatorë, aktualisht në pension, naftëtarë e të tjerë.

Ndjeshmëria e qeverisë ndaj kërkesave të vazhdueshme të këtyre kategorive mundësoi kalimin e projektligjit me procedurë të përshpejtuar.

Ligji trajton në themel drejtësinë sociale ndaj tri grupeve profesionale, tri komuniteteve, që e kanë kaluar jetën e tyre në profesione tejet të vështira, duke mundësuar shpërblimin e kërkuar ndër vite, miratuar nga ky parlament, kjo maxhorancë dhe kjo qeveri.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm që ligji, sidomos për trajtimin financiar dhe jo vetëm, për miratimin e akteve nënligjore vendos në pozita të drejtpërdrejta detyrimi dhe pune institucionet qeveritare, dy ministritë përkatëse, si dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Përmes ligjit të miratuar, tri profesionet trajtohen në mënyrë të veçantë, në referencë të vështirësisë së tyre dhe vjetërsisë në punë. Të gjithë atyre që janë sot dhe do të jenë nesër në këto profesione, nëpërmjet instrumentit të sigurimit suplementar nga punëdhënësi, patjetër, edhe nga vetë punëmarrësit, u garantohej një pension dinjitoz.

Naftëtarët e Vlorës pohuan se e vlerësojnë ligjin dhe maxhorancën për gatishmërinë e treguar, duke e miratuar këtë ligj me procedurë të përshpejtuar, por kërkojnë një vëmendje të shtuar dhe implementim sa më të shpejtë për sa i përket trajtimit financiar.

Naftëtarët e Vlorës theksuan se neglizhenca e treguar ndaj tyre nga qeveritë e mëparshme ka bërë që dëmi financiar të jetë në progresion rritës.

Po këta naftëtarë, i bashkohen nismës së qeverisë për të pastruar ligjin për naftëtarët nga abuzimet dhe përfitimet e padrejta të atyre që nuk kanë punuar në terrene të vështira, por kërkojnë të mos përjashtohet personeli i inxhinierëve dhe teknikëve në ndërmarrjet e sistemit të naftës dhe instituteve gjeologjike dhe teknike.

Ata kërkojnë edhe zgjidhjen e vakuumit profesional të punësimeve rishtasi, pa kualifikimet përkatëse, që, sipas tyre, shkakton dëme të pariparueshme në industrinë e naftës.

Në këtë pikë, duke e vlerësuar, do të ndalesha edhe në fjalën e deputetes Felaj, që sjell në vëmendje rigjallërimin dhe mirëfunksionimin e shkollës Teknikumi i Naftës për të arsimuarit e rinj që do të punojnë në këtë sektor.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Bello!

Fjalën e ka deputeti Lefter Maliqi. Të përgatitet deputetja Almira Xhembulla.

Lefter Maliqi – Faleminderit!

Sipas listës, nuk e kisha radhën tani për të folur, pa praninë e medieve (më ka ndodhur disa herë kjo), por zërin nuk e ndaloj dot, sepse ka edhe konferenca dhe medie të tjera për të folur.

Të nderuar shqiptarë,

Po fillojmë me shoun e dytë të radhës për të qarë hallet dhe problemet tuaja.

Nga t'ia fillosh? T'ia fillosh nga kartoni i kuq që i dha Brukseli kësaj qeverie, që e kanabizoi vendin dhe e bëri me ngjyrë të gjelbër, që e nxu vendin me krim dhe korrupsion, që ia

hedh fajin Francës, Danimarkës, Holandës e me radhë dhe mori në qafë edhe shtetin fqinj, Maqedoninë?

Si mund të hapeshin negociatat kur edhe Bundestagu gjerman vendosi 9 kushte nga 7 që ishin para një viti?!

Si mund të hapeshin negociatat, kur krimi i organizuar, shpopullimi, azilet politike e ekonomike në të gjithë Europën apo botën kanë zënë vendet e para?!

Si mund të hapeshin negociatat, kur ne jemi pa Gjykatë të Lartë, pa Gjykatë Kushtetuese, kur institucionet janë kapur, kur u bënë zgjedhje moniste, kur varfëria ka pllakosur vendin?!

Nga t'ia fillosh? T'ia fillosh nga qarku i Beratit (se edhe ky qark është njësoj si të gjitha qarqet e Shqipërisë)? Premtime nga më të ndryshmet. Premtuan para disa vitesh ishullin e Beratit. Ish-ministrja e Kulturës, së bashku me Kryeministrin, çfarë nuk thanë! Premtuan shumë rrugë.

Për shkak të reformës famëkeqe elektorale, edhe këtu në Tiranë komunat dhe fshatrat janë pa investime. Bashkia e Tiranës merr dyfishin e tatimeve dhe të ardhurave, sepse ka 50 fshatra rreth qytetit të Tiranës.

Bënë një reformë territoriale ku harruan fshatin, por edhe në qytete ka vjedhje e abuzime galopante.

Kryetarët e bashkive janë kthyer në drejtorë rajonesh. Pse ndodh kjo? Sepse të gjithë tenderët kryhen nga një grup njerëzish. Janë dy veta, që janë jashtë lidhjeve të Kryeministrit, si dhe krahut i djathtë i Kryeministrit, që realizojnë gjithë tenderët në Tiranë, madje edhe tenderët e Ministrisë së Shëndetësisë dhe ministrive të tjera janë fokusuar te Ministria e Rendit. Pra, këta i kanë mbledhur në dorën e 5-6 vetave dhe të një grupi tjetër oligarkësh, firma ndërtimi, që vetëm këto kohët e fundit janë rritur në përmasa të mëdha.

Nga t'ia nisësh?! Qesh...! Kryeministri del nëpër televizione kruan kokën, hap këmbët e duart... Qesh kot! Edhe kur i thonë se ke bërë emërime skandaloze me të dënuar, thotë: "Nuk ka faj as ministrja, as ministrat, as partia, kur vendosin kandidatët për kryetarë bashkish dhe drejtorë", pavarësisht se janë të dënuar brenda dhe jashtë vendit, sepse emërimet i bëjnë këta të tre që po ju them.

Prandaj e kam kërkuar interpelancën me zotin Rama, për t'i ditur këto dhe për t'i thënë në sy shumë gjëra. Ka katër muaj që nuk thotë...

Ç't'i besojnë më shqiptarët? A e patë se çfarë tha para disa ditësh dhe para një viti, që e dhanë mediet tuaja: "Me çizme, pa çizme, me këpucë, pa këpucë, me taka, pa taka...", por me tepsi, pa tepsi, me filxhanë, pa filxhanë, me timon, pa timon, pa mjekër, me mjekër, si Gadafi, nuk mban më ujë pilafi!

Kriza e rëndë ekonomike e politike e ka pllakosur këtë vend. Vendi është në një krizë totale dhe ka nevojë për zgjedhje lokale dhe të përgjithshme.

Çfarë mendoni ju, se janë të qetë këta që shkojnë atje dhe shohin kryetarë bashkish të një partie, të njëjtin këshill bashkiak të një partie dhe të njëjtin kryetar qarku të një partie?! Çfarë po bëjnë këta? Shou! Po pastrojnë disa kanale dhe asgjë tjetër!

Vjedhja, babëzia, korrupsioni dhe krimi kanë marrë përmasa të mëdha.

Këta duan ta varfërojnë popullin, sepse thonë se duke e varfëruar e kemi nënshtruar.

Zgjedhjet e qershorit e treguan shumë mirë... I mbushën disa kuti votimi, por 15% votoi. Unë nuk jam me ata që thonë 85%, por duhet të votonin mbi 25%, nga 47 apo 50% e popullit që voton.

Unë nuk jam as me Bashën, që rri, bën sehir, del atje e bën mitingje dhe ndez dritat...

Ka ardhur koha të ngrihet populli në këmbë, të majtë e të djathtë, artistë, qytetarë të zhgënjyer e të lodhur, studentë... Të mos shkojnë më para Kryeministrit, jo ligje të bëjnë këta, por çfarë të duan...!

Ky vend ka nevojë për shpresë, ka nevojë për çdo gjë.

Edhe punonjësit e uzinës së Poliçanit kanë dy vjet pa marrë pagat, kanë fituar gjyqet, ndërkohë që me të ardhurat e uzinës së Poliçanit ka ndërtuar zyrat Ministria e Mbrojtjes. Ky është një turp dhe një skandal!

Vendi ka nevojë për alarm për t'u ngritur, nuk ka nevojë për fjalë të bukura.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Maliqi!

Fjalën e ka deputetja Almira Xhembulla. Të përgatitet deputeti Ismet Beqiraj.

Almira Xhembulla - E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

“Java e gjelbër” po na jep mundësinë të kemi më shumë kohë produktive në zonat që përfaqësojmë. Është e vështirë të kesh kohë të mjaftueshme për takime cilësore me zgjedhësit apo me përfaqësuesit e institucioneve lokale kur je deputet i një zone të largët.

Unë nuk dua ta nis fjalën time me fjali të tipit: “Jemi zonë e varfër, kemi numrin më të madh të banorëve me ndihmë ekonomike, kemi probleme me infrastrukturën apo kemi akoma shumë sfida me shërbimet”. Jam e bindur që edhe bashkëqytetarët e mi nuk e duan këtë.

Dibranët janë punëtorë. Dibra ka burime natyrore të jashtëzakonshme, ka prodhime bujqësore ndër më cilësoret, ka djem e vajza, që po na bëjnë krenarë me modelet dhe vizionin që kanë për ta bërë Dibren destinacionin turistik të shqiptarëve, por edhe të të huajve.

Në bashkëpunim me bashkitë po përpiqemi maksimalisht t’i ndihmojmë dhe t’i mbështesim këto nisma.

Rruga e Arbrit është ëndrra që po realizohet, por është edhe sfida më e madhe e dibranëve për të qenë të përgatitur para kësaj mundësie të jashtëzakonshme, që po na e jep qeveria shqiptare me një investim kolosal prej 250 milionë dollarësh. Puna ka nisur dhe modelet e para janë ngritur.

Vetëm këtë vit, nëpërmjet fondeve të AZHBR-së, por edhe skemës kombëtare, janë mbështetur një sërë iniciativash, si në agroturizëm, ashtu edhe në bujqësi, blegtori e bletari.

Pikërisht ky sektor, i cili është prioritet i zonës, ende përballet me një numër të madh sfidash dhe pengesash. Edhe pse vitet e fundit ndërhyrjet dhe investimet në ujitje kanë qenë të mëdha, sërish kemi probleme.

Mendoj se është shumë e nevojshme të bëhet projektimi dhe realizimi i ujitjes së fushës së Maqellarës, me më shumë se 1000 hektarë. Maqellara ka nevojë edhe për një treg të prodhimeve bujqësore.

Është i domosdoshëm projektimi dhe financimi i ndërtimit të rrugëve problematike për transportin e prodhimit bujqësor, si: Selishtë-Peshkopi, Lurë-Peshkopi, Rapdisht, Derjan, Bellovë e fshatra të tjera, që kanë nevojë për rrugë për të sjellë prodhimet, por kanë nevojë të

jenë edhe më të aksesueshme për turistët që duan të vizitojnë këto potenciale turistike.

Vlen të përmend se vetëm pardje inspektuam nisjen e një investimi shumë të nevojshëm dhe të duhur për banorët e Kalasë së Dodës, rrugën e Radomirës, një investim nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, për asfaltimin dhe rehabilitimin e saj. Ky është një premtim i mbajtur ndaj kërkesës së viteve me radhë të qytetarëve.

Projektimi dhe ndërtimi i dy tregjeve bujqësore, me një treg kafshësh me standarde të sigurisë ushqimore e sociale, është një tjetër domosdoshmëri.

Një shqetësim tjetër, që na e kanë shprehur fermerët në takimet e këtyre ditëve, është edhe mungesa e laboratorit për analiza në zyrat lokale.

Edhe pse të gjitha këto investime dhe projekte serioze janë mbështetur nga AZHBR-ja dhe Ministria e Bujqësisë, mendoj se është e rëndësishme që në strukturat rajonale të kemi pak më shumë staf dhe mbështetje, me qëllim që rritja e numrit të aplikimeve dhe investimet në ferma dhe biznese të orientohen nga tregu.

Disa projekte të rëndësishme, që mund të mbështeten, janë fusha e grumbullimit të prodhimeve dhe fusha e ndërtimit të frigoriferëve.

Në fushën e përpunimit të frutave ka nevojë për një rritje në 3 mijë tonë dhe në fushën e përpunimit të qumështit nevojitet një kapacitetet i ri për përpunimin.

Mendoj se ka ardhur koha që nëpërmjet hapësirave, që krijojnë edhe skemat e IPARD-it, të mendohet seriozisht për feramat model, të certifikuar si organike.

Në Dibër kemi shumë potenciale, sidomos me mishin, por edhe me bimët mjekësore... (*Bie gongu.*)

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Xhembulla!

Për të gjithë deputetët që kanë pyetje apo shqetësime, që duan t’i adresojnë, nuk është vetëm seanca e sotme. Unë ju përmenda pak më parë një sërë mundësish që jep Rregullorja e Kuvendit për të pasur adresime të shqetësimeve. Ndërkohë, ministrat dhe ministria e Shtetit po mbajnë shënim çdo sugjerim, çdo vërejtje apo problematikë që është ngritur.

Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiraj.

Të përgatitet deputeti Zef Shtjefni dhe më pas deputeti Artur Roshi.

Ismet Beqiraj – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shoh që edhe kolegët e mi para folës po ikin të “zemëruar” për minutazhin që nuk u mjafton për të folur për hallet dhe shqetësimet e elektoratit të tyre. Unë do të filloj direkt me disa shqetësime të kësaj jave, por që i kam pasur dhe më parë për zonën që përfaqësoj, Mallakastrën.

Si shqetësim të parë për mallakastriotët në këtë sallë sjell pasigurinë teknike në rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm nga vendburimi i vetëm në zonë, Poçemi, si dhe perspektivën jo të qartë lidhur me vazhdimësinë e furnizimit nga ky burim për rreth 80% të banorëve, të institucioneve publike, të industrisë së naftës, si dhe të biznesit të Mallakastrës për shkak të ndërprerjes së punës së kompanive private, që menaxhojnë ish-kompaninë ARMO sh.a, se edhe ky aset ujon është pjesë e kësaj kompanie.

Gjithashtu, ju bëj me dije se ka probleme në dy nënstacionet e energjisë elektrike, në Ballh dhe në Poçem, në stacionin e pompave dhe rrjetin përkatës të ujit të pijshëm, edhe pse janë pjesë e aksioneve të privatizuara. Në nenin 6 të kontratës së privatizimit të 80% të aksioneve të kompanisë “ARMO” sh.a lidhur me deklaratimet dhe garancitë e blerësit, pika 6/6 “Ujësllësi” thuhet: “Palët pranojnë dhe bien dakord se shoqëria do të menaxhojë dhe do të administrojë linjën e ujësllësit, duke garantuar se edhe në të ardhmen do të vazhdojë të sigurojë dhe të mbajë në gjendje teknike linjën, me qëllim furnizimin me ujë të Drejtorisë Ujësllës-Kanalizimeve të Bashkisë Mallakastër dhe të 5 njësi administrative”, nga 9 që ka kjo bashki.

Nga kjo foltore i kërkoj ministrisë përgjegjëse të vlerësojë këtë situatë dhe të propozojë vendimmarrje qeveritare dhe, pse jo, edhe parlamentare për zgjidhjen e këtij shqetësimi social dhe delikat, si një detyrim publik dhe kushtetues ndaj qytetarëve, të cilin, para së gjithash, e ka qeveria dhe vetëm ajo.

Kjo situatë riciklohet sa herë që KPTHN-ja (Kombinati i Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh) ndërmon agallarët dhe sa herë që lumi Vjosë shkakton përmbytje. Kjo zonë dhe industria e naftës ripërsërit herë pas herë pasigurinë dhe ndërprerjen e ujit të pijshëm e të

energjisë elektrike, madje edhe tani që po ju përcjell këtë mesazh publik.

Problemi i dytë, por me shumë rëndësi sociale dhe shoqërore për elektoratin dhe mallakastriotët naftëtarë, është se fati i mbi 150 naftëtarëve mallakastriotë, fierakë, patosarakë etj, që punojnë në Kombinatin e Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh, lidhet me vetë ekzistencën dhe vazhdimësinë e aktivitetit të industrisë përpunuese të naftës në vend. Mesazhi që u përcjell naftëtarëve të KPTHN-së në Ballsh është të gjejnë forcë dhe të vetorganizohen me lëvizje sindikaliste të pastër naftëtarësh, jashtë ndikimit dhe interesave të sipërmarrësve, me objektiva konkrete, për të mbrojtur dhe për të përfaqësuar interesat e tyre ligjore, si palë, marrëdhëniet kontraktuale me punëdhënësin dhe institucionet shtetërore.

Të dashur kolegë të mi, naftëtarë të KPTHN-së në Ballsh, e kam thënë dhe e ripërsëris bindjen time të palëkundur, se falimenton pronari apo qiramarrësi i radhës së këtij aseti dhe jo industria e përpunimit të naftës në vend derisa të këtë edhe një pikë naftë në nëntokën shqiptare.

Shqetësimi tjetër që dua të përcjell në këtë seancë është zbatimi i plotë i dy ligjeve, nr. 29/2019 dhe nr. 8/2017, që kanë të bëjnë me statusin e naftëtarëve dhe me trajtimin suplementar financiar të minatorëve, naftëtarëve dhe metalurgëve, ndaj unë mbështes plotësisht edhe propozimet që bëri kolegja ime Bello për këtë çështje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Beqiraj!

Fjalën e ka deputeti Zef Shtjefni.

Zef Shtjefni – E nderuar zonja Nënkrjetare e Kuvendit,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të dashur qytetarë,

Çështjen e sotme nuk do ta shoh politikisht, por në fund do të jap disa shpjegime për ca që nuk e duan opozitën parlamentare.

Sot po flasim për zonat tona që kanë shumë halle dhe probleme për të zgjidhur. Në bashkëbisedimi që kam pasur me banorët e zonës (një pjesë të gjërave i kam thënë në seancën e kaluar), këtë radhë ishte një pyetje e drejtpërdrejtë: pse nuk u hapën negociatat e Shqipërisë me BE-në?

Unë ua kam thënë argumentet qytetarëve, që janë vetëm dy. Këto dy argumente, sipas meje, dua t'i ndaj me ju, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë, me ju të dashur qytetarë, dhe me ju që na ndiqni nëpërmjet kësaj seance.

Negociatat nuk u hapën as për fajin e qeverisë, se nuk ka bërë detyrat e shtëpisë, nuk u hapën as për fajin e opozitës jashtë parlamentit, se nuk i bëri detyrat e saj, nuk u hapën as për fajin e opozitës parlamentare, e cila i bëri detyrat e saj 200%, sepse lepuri fle diku tjetër. Po e filloj argumentin tim me thënien e një meshtari, që është ipeshkv shqiptar dhe që unë e kam për zemër, monsinjor Dom Gjergj Metës, i cili thotë: "Nëse Europa nuk më pranon bashkë me komshiun tim mysliman, atëherë unë nuk e dua pranimin në Europë". Pra, shiheni se sa europianë, sa tolerantë dhe sa bashkëjetues janë shqiptarët, gjë që nuk ndodh as në vendet më të qytetëruara të këtij planeti.

Unë po ju them se, sipas meje, dy janë shkaqet që e kanë penguar hapjen e negociatave me BE-në. E para, është islamofobia, që është e fshehur te disa kryetarë në 2-3 shtete të Europës, që, në fakt, janë pak, por që shfaqet me raste, dhe e dyta është aleanca ruso-serbe e përkrahur nga Franca, që e la Shqipërinë pa hapjen e negociatave. Kjo nuk ishte punë e qeverisë, sepse qeveria i ka bërë detyrat e saj, opozita jashtë parlamentit i ka kryer detyrat e saj, kurse opozita parlamentare i ka tejkaluar detyrat e saj. Kjo aleancë është e hershme dhe do me çdo kusht të ketë një Shqipëri të trazuar, një Kosovë të trazuar dhe një Maqedoni të Veriut të trazuar. Pra nuk duan që faktori shqiptar të jetë i bashkuar dhe me letra europiane. Shqiptarët kanë treguar që nga mesjeta se kanë drejtuar shumë vende të botës dhe kanë shkëlqyer me punët e tyre.

Fitorja e Albin Kurtit në Kosovë e thelloi bashkëpunimin ruso-serb dhe francez që Shqipërisë të mos i hapen negociatat, sepse në programin e tij ishte bashkimi me Shqipërinë. Ata nuk duan që këtu të ketë një Shqipëri të stabilizuar, se po të jetë ashtu do të kemi një Kosovë të stabilizuar dhe një Maqedoni të Veriut të stabilizuar, pasi faktori shqiptar është i rëndësishëm edhe në Maqedoninë e Veriut. Këto gjëra janë të hershme e nuk na lënë rehat, prandaj po ju them se jemi europianë jo vetëm me fjalë, por edhe me vepra, se e kemi mbrojtur Europën nga pushtimi dhe Gjergj Kastrioti, që

është Heroi ynë Kombëtar, e ka mbrojtur Europën dhe krishterimin, prandaj u shpall dhe "Atlet i krishterimit" dhe sot nderohet nga shumë vende të botës.

Europa na ka borxh, se ne kemi luftuar për të, kemi derdhur gjak dhe ajo duhet të na e kthejë borxhin. Shqiptarët kanë drejtuar botën në shumë shtete që nga mesjeta e deri në shekullin IX. Ata kanë drejtuar Selinë e Shenjtë, Vatikanin, me tri papë me origjinë shqiptare e nuk e meritoka Shqipëria hapjen e negociatave?!

Është e pafalshme se si Franca dhe Presidenti Makron bien kaq poshtë! Po Nënë Tereza, e cila u shërbeu më të varfërve, që u nderua nga mbarë bota dhe për këtë ishte shqiptarja e madhe?! Neve na e kanë borxh pranimin pa kushte, se Shqipëria i ka plotësuar të gjitha kushtet, qeveria dhe opozita i kanë plotësuar të gjitha kushtet. Është kjo aleancë ogurzezë, që ju thashë më lart, e cila nuk e do Shqipërinë të jetë e stabilizuar dhe në Europë.

Çfarë të këqijash u kemi bërë Francës dhe Presidentit Makron? Po ju kujtoj një fakt: kur terrorizmi goditi Francën, a ishte Kryeministri i Shqipërisë bashkë me 4 kryetarët e komuniteteve fetare që parakaluan në rrugët e Parisit dhe u nderuan nga shumë vende të botës për këtë gjest të jashtëzakonshëm, madje më vonë u dekorua edhe nga Presidenti i Francës, me sa di unë? Franca dhe Europa na kanë borxh. Bashkëjetesën tonë fetare e ka zili e gjithë bota dhe jo vetëm sot, por 100 vjet më parë padër Gjergj Fishta thoshte: "Vërtet kemi Bajram e Pashkë, por shqiptarinë e kemi bashkë". Meqë jemi këtu, po ju kujtoj një fakt: më 31 dhjetor 1940 mbylli sytë një herë e përgjithmonë, por për të mos u harruar kurrë, padër Gjergj Fishta dhe në varrimin e tij, fjalën e lamtumirës e ka mbajtur hoxhë Hafiz Ali Kraja, një intelektual i madh nga Shkodra. E pra, kësaj i them unë Europë, kësaj i them bashkëjetesë, që i ka rrënjët prej mijëra vjetësh. Kjo është kultura jonë, Europa jonë dhe këto veti e cilësi nuk mund t'i gjesësh në asnjë popull përveçse në Shqipëri. Këtu dalin gazetarë e media dhe çfarë nuk thonë, gati për ta ndezur Shqipërinë flakë, sulmojnë ditë e natë qeverinë, në njërin krah, e opozitën që është jashtë parlamentit, në krahun tjetër, me misionin për ta degraduar edhe opozitën parlamentare.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të dashur qytetarë,

Shqipëria është europiane me fjalë e me prova, i mungon vetëm një copë letër, që do ta marrë shpejt. Armiqtë e saj kuptohet që janë të paktë në numër dhe ne do të vazhdojmë bashkëpunimin tonë për të mirën e Shqipërisë: me reformën në drejtësi, reformën zgjedhore dhe çdo reformë tjetër që kërkohet nga BE-ja.

Kaq ishte problemi i parë në lidhje me zonat tona.

Problem tjetër që kanë zonat tona është komuniteti i pensionistëve, në fshat dhe në qytet, që kërkojnë rritje pensionesh. I bëj thirrje qeverisë, që është në prag të buxhetit të vitit 2020, të rrisë pensionet e invalidëve, të të sëmurëve, pra të përmirësojmë jetën e tyre me sa të kemi mundësi.

Bujqësia mbetet prioritet i madh. Jepni fonde për të, se është e domosdoshme, pasi fuqizojmë fshatin dhe qytetin! Këta të dy shkojnë bashkë.

Problem tjetër në zonën e Nënshkodrës është mungesa e energjisë elektrike në disa fshatra. E kam thënë edhe herën tjetër, por po ju them edhe sot, që të kërkon investime për riparimin e sistemit të energjisë elektrike. Këtë javë ndodhi një ngjarje në fshatin Barbullush të Shkodrës, ku u dogj një shtëpi dhe një grua ka mbetur me 5 fëmijët e saj në rrugë të madhe. I bëj apel qeverisë që nëpërmjet Bashkisë së Vaut të Dejës të marrë masa për zgjidhje. Zonat tona janë të bukura, por duan përkujdesje, që t'i bëjmë më të jetueshme për qytetarët. Ne jemi këtu për të sjellë problemet e tyre.

Të dashur deputetë, ju ftoj të vizitoni zonat tona, të vizitoni kishën, muzeun e Ndre Mjedës, të vizitoni edhe një resort turistik të bukur, që është *Grandenlandi* në atë fshat, se do të kënaqeni me bukuritë e tij. Ne kemi ardhur këtu që të përfaqësojmë zonat tona.

Problem tjetër është gjakmarrja, të cilën e përmenda edhe herën tjetër, dhe po ju them që të merrni në dorë situatën për ta zgjidhur dhe jo thjesht të flisni në parlament. Organet ligjzbatuese të marrin masat për zgjidhje për të gjitha problematikat që shtrojnë deputetët! Ju i keni të gjitha pushtetet për të vepruar dhe nëse mendoni se vetingu vonon disa vite për ta pastruar sistemin e drejtësisë nga kalbëzimi, atëherë ejani këtu, sillni projektligjin e ri, që “kçk”-së t'i pritët rruga! “Kap ça të kapim” nuk

mund të ndodhë më në këtë vend. Gjithçka do të jetë ndryshe.

I bëj apel komisionit hetimor të vazhdojë punën bashkë me organet e reja të drejtësisë e të mos flejë gjumë, që t'i japim vendit një President dinjitoz.

Grupi Parlamentar i Partive të Djathta përshëndet vendimin unanim të Parlamentit Europian për miratimin e rezolutës që Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut i kanë plotësuar të gjitha kushtet, duke e quajtur gabim strategjik që udhëheqësit e BE-së nuk i hapën negociatat me këto dy vende.

Kohët e fundit janë bërë disa ndryshime në Kodin Penal. U bëj thirrje qytetarëve, por edhe disa medieve, disa pseudoanalistëve, që shajnë dhe fyejnë deputetët e opozitës parlamentare, se mjerë ju që një ditë do të mbeten pa bukë, se servilizmi juaj do të marrë fund një ditë dhe se audienca po ju bie çdo ditë e më shumë! Dalëngadalë shqiptarët po i largohen injorancës suaj, se çdo natë keni mbushur ekranet me mllef ndaj deputetëve të opozitës parlamentare, që duan më shumë Shqipërinë se partinë, që flasin në parlament duke përfaqësuar qytetarët me dinjitet dhe që kanë vendosur një standard kudo që shkojnë.

Shqiptarët duan një politikë ku zëri i tyre të dëgjohet këtu në Kuvend dhe ne ia kemi dalë ta sjellim. Po u them atyre, që na quajnë parti të vogla, se kanë gjithë jetën që nuk duan as të jemi gjallë e jo më të na lënë votat. Në çdo palë zgjedhje i kanë vjedhur votat tona dhe janë bërë ministra, deputetë e drejtorë me to. Zgjedhjet e 2021-it do të prodhojnë një klasë politike ku shumë parti, që (nuk i duan nga ne), do të përfaqësohen në Kuvendin e Shqipërisë.

Grupi Parlamentar i Partive të Djathta shpall si aleancë të përjetshme Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe BE-në, si e vetmja aleancë që do t'u rezistojë shekujve. Shqipërinë do ta bëjnë shqiptarët në bashkëpunim të ngushtë me SHBA-në, falë kësaj aleance që asnjëherë nuk e ka lënë në baltë kombin tonë edhe në kohët më të errëta të ekzistencës së tij.

Ju faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Shtjefni!

Fjalën e ka deputeti Artur Roshi.

Të përgatiten deputetja Lindita Nikolla dhe deputeti Ilir Beqaj.

Artur Roshi – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Problemet që kanë qytetarët shqiptarë sot nuk janë shqetësime që vijnë prej rrjedhshmërisë normale të jetës, por janë halle që vijnë nga sistemi politik, të barazvlefshme me ngarkesën e paparashikueshmërisë që sjellin gjërat e mbinatyrshme. Sistemi politik, që pengon votën e lirë, pengon pashmangshmërisht edhe lirinë ekonomike dhe, për rrjedhojë, rrit shkallën e vështirësisë për të jetuar. Taksat, në konceptin e qeverisë, janë jeta e shtetit. Për ju privimet forcojnë shpirtin e një populli dhe kalitin çelikut e pastër të disiplinës shoqërore dhe realiteti nuk është gjë tjetër veçse një iluzion. Filozofia juaj politike është një ideologji që në thelb ka demagogjinë.

Qeveria, në emër të shtetbërjes, ka centralizuar në duart e saj, tërësisht në një shkallë të frikshme, pushtetin ekonomik, që do të thotë pushtetin mbi jetën e njerëzve.

Në konceptin tim nuk duhet të cenojmë dhe të rrezikojmë jetën e qytetarit në emër të shtetit. Taksat e larta që ju aplikoni sot, e bëjnë këtë gjë: trysnojnë mbi jetesën e shqiptarëve.

Qeveria si nocion është një shpikje dhe një model i mendjes së njeriut për t'u marrë me problemet e njerëzve dhe për të zgjidhur kërkesat e tyre.

Cila është qeveria juaj?! Ajo që aplikon taksa të larta 15% për transkriptimet e pasurive të paluajtshme dhe i ngadalëson dukshëm ato; ajo që aplikon taksën 15% për qiratë e çdolloj prone dhe i detyron njerëzit ose të abuzojnë, ose të mos nënshkruajnë kontrata, duke humbur sigurinë midis qiradhënësit dhe qiramarrësit; ajo që aplikon taksën e arsimit të përkohshëm, që tashmë është e përhershme, dy herë për të njëjtin person kur ai ka biznes, edhe për atë që e ka fëmijën në shkollë private, edhe për beqarët; ajo që aplikon taksën më të lartë në rajon për karburantet; ajo që aplikoi rritjen e taksës së pronës dy herë më shumë; ajo që aplikoi rritjen e sigurimeve shoqërore, që është një lloj takse e fshehtë; ajo që aplikoi vendosjen e sigurimeve të ndërtesave, në mënyrë të detyrueshme, pra mendon për sigurinë nesër, pa pasur mundësinë e sigurisë së jetesës sot; ajo që ka rritur ndjeshëm perceptimin e korrupsionit në opinionin ndërkombëtar.

Qytetarët shqiptarë kanë filluar të kenë frikë se janë pre e një pushteti të paparashikueshëm dhe e një ligësie të pashpjegueshme. Ata kanë frikë se vendi i tyre po shembet dhe ekonomia po e humbet kuptimin e saj.

Faleminderit !

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Roshi!

Fjala për deputeten Lindita Nikolla.

Lindita Nikolla – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Java që mbyllëm për të gjithë ishte një javë kontaktesh intensive, besoj edhe me aktivitete për dy tema të rëndësishme të muajit tetor. Edhe në qarkun e Lezhës kanë vijuar aktivitetet për sa i takon sensibilizimit për mamografinë, për diagnostikimin e hershëm të kancerit të gjirit.

Një falënderim të veçantë e kam për Ministrinë e Shëndetësisë dhe për ministren, si dhe për punonjësit e qendrave shëndetësore spitalore në Lezhë, në Mirditë dhe në Kurbin, të cilët ua kanë dedikuar punën e tyre ditëve të “tetorit rozë”, ku u kanë shërbyer nëpërmjet mamografisë së lëvizshme 200 grave dhe vajzave.

Po ashtu, shkollat dhe bibliotekat e qyteteve kanë zhvilluar një sërë aktiviteteve me kryefjalë librin dhe leximin.

Në javën që shkoi kishim inaugurimin e muzeut etnografik të Lezhës. Për herë të parë rreth 400 vlera të identitetit kulturor të Mirditës, të Zadrimës, të malësorëve dhe lezhjanëve, të cilat mbaheshin të fshehura nën pluhurin e magazinave të bashkisë, dolën në dritë dhe u ekspozuan, sipas standardeve bashkëkohore për vizitorët dhe studiuesit në një mjedis si ai i pallatit të kulturës, i cili ishte dhënë për bar e kafene, duke iu kthyer kulturës dhe qytetit.

Inaugurimi i muzeut etnografik ishte një ndër aktivitetet e organizuara nga Bashkia e Lezhës në ditën e lindjes së Gjergj Fishtës. Patjetër për këtë meriton përgëzime kryetari i bashkisë, ish-kolegu ynë, zoti Pjerin Ndreu, por edhe qeveria dhe ministrja e Kulturës, e cila premtoi se do të ndërtohej shtëpia muze e Gjergj Fishtës, një kërkesë e kahershme e banorëve dhe e komunitetit.

Në të gjitha takimet e vijuara me qytetarët e Laçit është përcjellë shqetësimi i mungesës së furnizimit me ujë të pijshëm. “Kurbini furnizon

qytetet e tjera, ndërkohë që vetë nuk ka ujë” - ishte fjalja me të cilën ata transmetuan shqetësim e tyre. Unë besoj se tashmë ky shqetësim është adresuar, sepse qeveria e ka miratuar projektin dhe e ka financuar atë në vlerën e 1 miliard lekëve të ndarë në dy faza me nga 500 milionë lekë secila.

Faza e parë fillon brenda këtij viti dhe parashikon ndërtimin e pusit të ri, rikonstruksionin e pusit ekzistues, stacionin e ri të pompave, linjën e transmetimit të ujit, rikonstruksionin e depoz ekzistuese me kapacitet 4 mijë metra kub, si dhe rrjetin e shpërndarjes për qytetin e Laçit nga depot deri te familjet.

Faza e dytë fillon brenda vitit 2020 dhe në total parashikohet të shtrihen gjithsej 95 kilometra tubacione linjë shpërndarjeje. Ky projekt mundëson që brenda vitit 2021 qyteti i Laçit të furnizohet me ujë të pijshëm 24 orë.

Gjithashtu, një shqetësim i madh i banorëve lidhet edhe me përmbytjet që shkakton përroi. Dalja disa herë nga shtrati e përroit, që përshkon mes për mes qytetin është kthyer në problemin kryesor të banorëve. Një numër i madh i banesave, i bizneseve, i rrugëve, por edhe i ambienteve publike janë përmbytur disa herë si pasojë e reshjeve. Rasti i fundit ishte ai i datës 11 tetor, ku një pjesë e madhe e territorit të qytetit u gjend nën ujë. Ndërhyrja për rehabilitimin dhe sistemin e këtij përroi është jetike për qytetin, në mënyrë që të zgjidhet një herë e mirë ky problem shumëvjeçar. Bashkia e Kurbinit ka përgatitur edhe një projekt, i cili do t'i japë zgjidhje përfundimtare këtij problemi. Vlera e projektit për këtë investim është afërsisht 330 milionë lekë për pjesën urbane, që përshkon qytetin me gjatësi afërsisht 2 kilometra. Projekti parashikon matjet e prurjeve të përroit, si dhe përbalimin dyfish të prurjeve maksimale, duke u dhënë zgjidhje përmbytjeve të shkaktuara. Besoj se kjo problematikë, e cila në të shkuarën ka marrë edhe jetë njerëzish, do të adresohet në buxhetin e ri.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Nikolla!

Fjalën e ka deputeti Ilir Beqaj.

Të përgatitet deputeti Besnik Troplini dhe më pas deputeti Halil Jakimi.

Ilir Beqaj – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuara kolege dhe të nderuar kolegë deputetë,

Sot dua të sjell në vëmendje të qeverisë disa shqetësime të banorëve të Tropojës, të cilat mendoj se duhen adresuar.

Në fillim të vitit të ardhshëm, pra duke filluar nga janari, dokumentacioni arkivor i zyrës së kadastrës së Tropojës do të transferohet në Kukës. Pra, qytetarët e Bajram Currit dhe të Tropojës duhet të shkojnë deri në Kukës për të marrë një dokument kadastral. Agjencia Kombëtare e Kadastrës duhet ta rivlerësojë strategjinë e saj të rajonalizimit për t'u shërbyer qytetarëve në këto zyra në bazë të distancave.

Për nevoja të pajisjes me dokumente me vulë apostile, qytetarët e Tropojës duhet të udhëtojnë deri në Kukës. Duhet të merret në konsideratë që kjo vulë e veçantë të jetë disponibël edhe në Tropojë.

Gjithashtu, pajisja me një NIPT për fermerët është e komplikuar dhe kërkon kohë. Pra, një fermer nga Tropoja, për t'u pajisur me një dokument për bujqësinë, duhet të shkojë në Kukës, së fundi edhe në Lezhë, sepse aty ndodhet zyra rajonale e Veriut.

Një çështje e pazgjidhur vazhdon të mbetet kontrolli periodik i automjeteve dhe dhënia e testimit teorik dhe praktik për personat që duan të pajisen me leje drejtimi të automjeteve. Qytetarët e Tropojës duhet të shkojnë deri në Kukës për të bërë këto veprime.

Transporti interurban për banorët e Tropojës, Kukësit apo Tiranës bëhet nëpërmjet Kosovës. Së fundi, një pjesë e operatorëve nuk i lejojnë ata që ta ushtrojnë këtë aktivitet. Unë kërkoj që të gjithë këta operatorë të trajtohen në mënyrë të barabartë, pasi disa lejohen dhe disa të jetë jo.

Është e rëndësishme që këtyre problemeve t'u jepet një zgjidhje definitive, sepse banorëve të Tropojës do t'u kushtojë shumë kohë dhe lekë, nëse duan të shkojnë në Kukës dhe në Tiranë nëpërmjet Bytyçit dhe Krumës.

Gjithashtu, rrjeti elektrik i shpërndarjes së energjisë elektrike është tejet i amortizuar dhe përmirësimi i tij kërkon kohë dhe para. Në disa nga këto zona jetojnë pak familje dhe gjatë stinës së dimrit ka defekte të herëpashershme, ndërkohë që personeli i mirëmbajtjes është i kufizuar. OSHEE-ja duhet të marrë në konsideratë jo vetëm numrin e kontratave aktive të energjisë

elektrike, por edhe distancat dhe cilësinë e rrjetit në përcaktimin e numrit të fillrojtësve.

Ka mungesë të theksuar të personelit mjekësor, infermierëve, qoftë në spitale, qoftë në qendrat shëndetësore. Aktualisht janë 16 vende të lira për infermierë. Banorëve dhe të sëmurëve nuk u intereson shumë se si punësohen infermierët me apo pa portal, sepse portali është instrument administrimi i qeverisë, ndërsa banorët duan shërbime. Për konsulta të specializuara mjekësore për të sëmurët kronikë me zemër, me tension, me diabet, me sëmundje të veshkave në Tropojë duhet të shkojnë në spitalin rajonal të Kukësit. Kërkohej që, sipas një kalendari të paracaktuar, mjekët e spitalit rajonal të Kukësit të jenë prezentë edhe në spitalin e Tropojës.

Në nëntor të vitit 2018, në procesin e diskutimit dhe miratimit të buxhetit të shtetit për vitin 2019, u diskutua nevoja e vendosjes së urave “Bejli”. Për këtë u përcaktua një fond jo i vogël në programin buxhetor të emergjencave. Në Bashkinë e Tropojës ende nuk ka filluar vendosja e ndonjë ure dhe, me ç’duket, kjo kërkesë nuk do të plotësohet deri në fund të këtij viti. Qeveria duhet ta marrë në konsideratë këtë gjë në buxhetin e vitit 2020, meqenëse është në fazën e përgatitjes së projektbuxhetit.

Gjatë vitit 2019 kërkesat e fermerëve janë plotësuar pjesërisht për sa i përket mbështetjes së drejtpërdrejtë financiare qoftë në bletari, qoftë në të imëta. Është përdorur kriteri: “I shërbehet të parit atij që e dorëzon kërkesën i pari”. Ndërkohë, dorëzimi i kërkesave ka gjithmonë një afat të deklaruar, por nga fermerët konsiderohet si kriter arbitrar, ndaj kërkohej që vitin e ardhshëm të gjendet një mekanizëm lidhur me këtë gjë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Beqaj!

Fjalën e ka deputeti Besnik Troplini.

Besnik Troplini – Kolegë deputetë,

Gjatë këtij muaji kam pasur shumë takime sidomos me fashën më *debole*, me ata më të pambrojturit ekonomikisht, që janë pensionistët. Është për t’u habitur, sepse ata më kërkojnë mua llogari, si deputet i Kuvendit, duke më thënë: “I dashur, pse nuk po na i rrisni pensionet?”. Unë u thashë: “Pensionet nuk i rris unë, i rrit qeveria”. Atëherë, ata më thanë: “Meqenëse ti je deputet, a mund të na e përcjellësh fjalën tonë atje në

parlament?”. “Patjetër”, - u thashë. Unë mora përsipër që kërkesën e tyre ta shpreh këtu. Meqenëse këtu është ministria për Marrëdhëniet me Parlamentin, sepse ministria e Ekonomisë nuk është prezente, unë dua ta pyes, në mënyrë që t’u jap një përgjigje njerëzve: “A keni parashikuar në projektbuxhetin e vitit 2020 ngritjen e pensioneve, apo jo? Në qoftë se po, atëherë sa për qind do të ngrihen? Në qoftë se jo, thuajeni, në mënyrë që të mbledhin mendjen pensionistët, por edhe ne të tjerët! Unë nuk e di si e përballojnë jetën ata pensionistë me këto pensione mizerabël që marrin! Sepse një pensionist do që të paguajë dritat, do që të paguajë ujin, do që të paguajë një pjesë të ilaçeve, që janë pa rimbursim dhe që kushtojnë, do që të bëjë pazar, se do të hajë bukë, por pse jo do që të pijë edhe një kafe, sepse i ka dalë shpirti duke punuar 40 vjet. Problemi është se pensionet janë përtokë. Lart e poshtë janë hapur fjalë se as 50 mijëlekëshin e shpërblimit për Vitin e Ri nuk do ta marrin. Ku po shkojmë kështu?! Çfarë po ndodh këtu?! Pensionet janë për faqe të zezë! Rritini pensionet që të jetojnë njerëzit! Mjaft me PPP-të, TTT-të, LLL-të! A donit t’i votonit? I votuat, sepse me votim të thjeshtë i kishit, madje as nevojën tonë nuk e kishit. Pra, shumë bukur i miratuat, tani taksirat ai që do t’i paguajë. A i miratuat këto? Tani merreni Balldrenin dhe gjithçka tjetër, se nuk jua heq njeri të drejtën, por mos i lini pensionistët për faqe të zezë në mes të katër rrugëve. Si qenka kjo punë kështu?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Taksirat i madh! Çfarë politike qenka kjo?! I dashur Kryeministër, lëreni korporatën e Meksikës! Mos na ngatërmoni me Amerikën Latine apo me Amerikën Qendrore! Nga njëra anë ne duam të futemi në BE dhe, nga ana tjetër, marrim shembull nga Jordania dhe nga Meksika. Pra, këtej jemi europianë dhe këtej...

Unë nuk e di me çfarë shkojnë këta, me tajare a me not, por kjo nuk ka kuptim.

Futeni në mendje: rritini pensionet se nuk do t’ju ndahem! Madje, do t’jua sjell pensionistët te zyra dhe atyre nuk keni çfarë t’u bëni. Atyre nuk ka çfarë t’u bëjë as FNSH-ja, as policia, sepse ata të mbeten në dorë. Si qenka kjo punë kështu?!

Prandaj, zoti Kryeministër (ti nuk je këtu, por fjala të vjen se ka shumë altoparlantë, madje edhe regjistrohët), bashkë me ministrin e

Ekonomisë dhe me kryetarin e Komisionit parlamentar për Ekonominë, duhet të shikoni mundësinë për t'i rritur pensionet. Mjaft, nuk vazhdohet më kështu, sepse puna e pensioneve ka shkuar përtokë. Njerëzit kanë nevojë të jetojnë dhe që të jetojnë, atëherë kërkojnë mirëqenie.

Prandaj, të nderuar pensionistë, unë e shtrova këtu në parlament problemin tuaj, iu drejtova qeverisë dhe në mos sot, javën tjetër ose muajin tjetër qeveria të na japë përgjigje që edhe ne të dimë se si të reagojmë, sepse nuk shkohet më kështu. Filmat me *cartoni animati* kanë mbaruar. Po vjen fundi i legjislaturës dhe problemi është se ende pensionet janë me 100 euro. Ku do të shkojë ai? Si do të jetojë dhe çfarë do të bëjë me 100 euro?

Të nderuar kolegë deputetë, do të jem shumë i gëzuar nëse këtë problem do ta ngremë të gjithë sa jemi këtu, 122 deputetë, sepse ata janë prindërit, vëllezërit dhe miqtë tanë, që sot kanë më shumë nevojë se kurrë...

(I ndërpritet fjala, sepse i mbaroi koha në dispozicion)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Troplini!

Fjalën e ka deputeti Halil Jakimi. Të përgatiten deputetët Tatjana Nurçe, Xhemal Qefalia dhe Adriana Jaku.

Halil Jakimi – Të nderuar kolegë deputetë, Të dashur qytetarë,

Sot kjo sallë dhe kjo seancë do të kishin seriozitetin e duhur nëse Kryeministri do të ishte këtu dhe nëse dhjetë karriget e ministrave nuk do të ishin të braktitura. Rëndësia e këtij parlamenti dhe e kësaj foltoreje marrin kuptimin e duhur kur trajtohen problemet e qytetarëve shqiptarë dhe jo kur ndahen paratë mes oligarkëve dhe kur bëhen afera e pazare të fëlliqura politike.

Sot dua të flas në emër të banorëve të fshatrave Homeshë, Kovashicë, Zogje, Shtushaj, Mazhicë, Gjuras dhe Bllacë, sepse ata kanë si shqetësim mosndërtimin e aksit rrugor Ura Sebinit – Shtushaj, me gjatësi prej 5 kilometrash dhe me vlerë projekti rreth 1,7 miliardë lekë. Ky aks është arterie kryesore që lidh këtë zonë dhe u jep akses banorëve për t'u lidhur me Shupenzën, Bulqizën, Dibërën dhe Tiranën. Pra, ky aks nuk kushton 20 milionë euro dhe nuk kërkon PPP, por është 5 kilometër rrugë dhe kushton 2,7 miliardë lekë. Kjo rrugë është premtuar prej

shumë vitesh është premtuar nga kushdo, por nuk është realizuar. Edhe pushteti vendor e ka pasur të pamundur që ta realizojë dhe i jap të drejtë, prandaj flas në emër të atyre banoreve, pasi u kam kërkuar votën në vitin 2013, por edhe në vitin 2015, të cilët më besuan, me një fitore bindëse, që unë të jem anëtar i këshillit bashkiak në Bulqizë nga viti 2015 deri në ditën kur pranova mandatin e deputetit. Ky shqetësim ka qenë gjithmonë për banorët, por pushteti vendor e ka pasur të pamundur realizimin e kësaj rruge. Pra, pushteti qendror duhet të marrë masat dhe ta vendosë në plan atë projekt, që ka ndikim të drejtpërdrejtë te 4000 banorët. Ky aks ka rëndësi të veçantë edhe për shkollimin e nxënësve, pra në marrjen e dijës, gjë që është shumë e nevojshme për ta. Nëse ky aks realizohet, jam i bindur dhe kjo është një e vërtetë e madhe, që më shumë nxënës do të kenë mundësi të arsimohen në Shupenzë dhe në shkollën Zogje.

Ky aks ka rëndësi edhe për diçka tjetër, sepse atje ndodhet një vend i shenjtë, siç dihet nga gjithë shqiptarët, është Teqja e Bllacës, ku shkojnë me dhjetëra e qindra qytetarë, përveç zonave përreth, nga qytete të ndryshme të Shqipërisë për të bërë adetet. Ne jemi një vend laik, por Shqipëria duhet vlerësuar për harmonizimin e veçantë të besimeve fetare.

A e kuptoni se bëhet fjalë për 5 kilometër rrugë, e cila nis nga Ura e Sebinit dhe përfundon në Shtushën, te “Lama e Sulës”?

Gjatë takimit me banorët, ata me të drejtë u shprehën se ky shqetësim duhet të ngrihet sa jemi në kohë, sepse çdo ditë të rinjtë dhe banorët po ikin për shkak të kësaj rruge. Pastaj qeveria pas x vitesh do të thotë se zona nuk ka banorë, prandaj edhe rruga nuk është realizuar.

Pra, këto fjalë domethënëse më bëjnë të kuptoj se qeveria shqiptare për gjithë këto vite ka ndjekur politikën më të keqe të mundshme për të detyruar qytetarët e këtij vendi të braktisin shtetin e tyre.

Ndihem i emocionuar kur flas për ata njerëz fisnikë, punëtorë, me pak llafe dhe shumë punë, të cilët janë të gënjyer dhe të mashtruar nga politika prej 30 vjetësh. Ata janë pa mbështetje në investime bujqësore e blegtorale, pa mbështetje në investime për shkollë dhe çerdhe, pa transport publik falas për nxënësit nga klasa e pestë deri në të nëntën, të cilët duhet të udhëtojnë nga fshatrat Bllacë, Mazhicë, Shtushaj dhe

Kovashicë për t'u arsimuar në shkollën e Zogjes, pa marrë parasysh që janë të detyruar të nxënë dije në një ambient jashtëzakonisht të amortizuar.

Kjo zonë zhgënjimin më të madh e mori në vitin 2013, kur ish-ministri, më falni, por më duhet t'ia përmend emrin për arsye të postit politik që ka pasur, Shkëlqim Cani, propozoi ndërtimin e rrugës dhe gënjeu keqaz banorët duke mos e realizuar atë.

Prandaj, ju lutem, zonja Ministre, zoti Kryeministër, zoti Zëvendëskryeministër, më kanë thënë se i merr parasysh këto probleme, merreni në konsideratë...

(I ndërpritet fjala, sepse mbaroi koha në dispozicion)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Jakimi!

Ka kërkuar fjalën për procedurë ministria Elisa Spiropali.

Elisa Spiropali – *(Flet pa mikrofon)* ...për prezencën këtu dhe për çështjet që ju ngrini, a do të reflektohen këto në politika apo në përgjigje?

I nderuar deputet, të jeni të sigurt se protokollit dhe regjistrimi merret në dorëzim nga qeveria dhe nga unë personalisht, pra të gjitha çështjet kalojnë te ministrat dhe sektorët përkatës dhe në "Javën e gjelbër" të radhës ministrat do të vijnë këtu dhe do të përgjigjen për çështjet që ju keni ngritur në këtë seancë. Pra, kanali i komunikimit funksionon dhe çështjet tuaja jo vetëm që merren shënim këtu, por reflektohen edhe në përgjigje nga ministrat në seancën e radhës.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Spiropali!

Fjalën e ka deputetja Tatjana Nurçe.

Tatjana Nurçe – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë dhe kolege,

Fjalën time sot do t'ia dedikoj gruas, nënës dhe vajzës shqiptare.

Qenia e gruas është një forcë e pashterur, një vlerë për familjen, komunitetin dhe për shoqërinë. Muaji tetor është muaji ndërkombëtar i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, një kauzë shumë e rëndësishme, e cila na prek të gjithëve. Beteja pa dyshim që është e vështirë, e dhimbshme dhe e lodhshme, por fitorja nuk është e pamundur.

Sipas statistikave, në Shqipëri kanceri i gjirit ka ardhur në rritje, ku çdo vit kemi 650 raste të reja që diagnostikohen me këtë sëmundje. Është e rëndësishme të evidentohet se pasja e një familjari me kancer është një sprovë dhe një kosto për të gjithë familjen. Sot ne kemi mundësi për të mbuluar 100% medikamentin e receptinës, e cila ul shpenzimet e familjarëve tanë.

Parandalimi është një hap larg vendbanimit tonë, sepse që prej vitit 2015, përmes mamografisë së lëvizshme shërbimi ofrohet pranë komuniteteve dhe qendrave të banimit, duke i krijuar mundësinë çdo gruaje të kontrollojë shëndetin e saj.

Si zëri i bashkëqytetarëve të mi, dua të përmend disa nga investimet që janë bërë në qytetin tim, në Lushnjë, për sektorin e shëndetësisë gjatë periudhës 2018 – 2019. Synimi i këtyre investimeve ka qenë për t'i ofruar komunitetit një shërbim sa më cilësor, prandaj po përmend investimet që janë bërë në qendrat shëndetësore Kolonjë e Grabian gjatë vitit 2018 dhe në qendrat shëndetësore Karbunarë Ballagad dhe Krutje gjatë vitit 2019, investime të bëra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Dua të theksoj investimet që janë bërë për poliklinikën qendrore të qytetit të Lushnjës, e cila është rindërtuar dhe pajisur me aparaturë moderne. Në këtë institucion do të përfitojnë shërbim shëndetësor rreth 186 mijë banorë të bashkisë së madhe. Ky investim, me vlerë 900 mijë euro, realizohet nga qeveria zvicerane nëpërmjet projektit zviceran "HAP" në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Gjithashtu, dua të përmend edhe një investim shumë të rëndësishëm, rikonstrukcionin total të spitalit "Ihsan Çabej", ku është bërë vendosja e kabinetit të imazherisë pranë shërbimit ambulator, rritja e funksionit dhe kapaciteteve të laboratorit pranë shërbimit ambulator të rrethit të Lushnjës, si dhe pajisja me mamografi stacionare, për të nxitur sensibilizimin dhe qasjen sa më të afërt të qytetarëve tanë për të bërë këtë shërbim.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Nurçe!

Fjalën e ka deputetit Xhemal Qefaliaj.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë,

Me ndryshimet e Rregullores, është thënë që një javë në muaj duhet të jemi në terren për të konstatuar dhe përcjellë problemet. Të lëvizësh një javë dhe të pretendosh që të shprehësh problemet për katër minuta është e vështirë, aq më tepër që një pjesë e deputetëve nuk e bëjnë këtë, nuk e bën as opozita në rrugë, e cila pret të kthehet dhe të kapë portofole ministrore direkt në tavolinë. Opozita e tanishme parlamentare problemën më të madh ka listën e zgjedhësve sesi do të bëhet sistemi zgjedhor, merak i madh shumë, ndërsa për qytetarët flet shumë pak, sepse hallet dhe problemet e tyre janë shumë më të rëndësishme se karriget e deputetëve që shpresojnë të vijnë në parlament.

Unë do të ndalem në dy – tri momente, duke shpresuar se do të jenë në vëmendje të qeverisë disa nga problemet që ende nuk kanë gjetur zgjidhje.

Javën e parë ngrita një problem për sa u përket dëmeve të tërmetit, por ende nuk po shikoj që të fillojë zbatimi, sepse ka shtëpi që banorët pretendonin t'i ndërtonin vetë, por nuk po fillon puna për ndërtimin e tyre.

Së dyti, maxhoranca ka pasur një politikë, e cila ka qenë e suksesshme, që ka bërë që shumë nga banorët t'u rikthehen edhe një herë zonave të tyre rurale për të banuar dhe për të qenë në truallin e tokën e tyre, por përsëri ende ka vështirësi.

Duke përfutur nga prezenca e ministres, zonjës Balluku, dua t'i them që jo shumë larg Tiranës janë disa fshatra, që ndoshta konsiderohen të thella, si: Fag dhe Murriz, që kanë ende vështirësi në sistemin e energjisë elektrike, prandaj mendoj se duhet marrë në konsideratë.

Gjithashtu, një problem i dytë është me Ministrinë së Arsimit, e cila ka bërë një punë shumë të mirë për t'i bashkuar shkollat edhe në ato vende ku ka pak nxënës, por duhet konsideruar një ndër nismat për të çuar atje mësues të kualifikuar dhe jo mësues që i shmangen përgjegjësisë dhe portaleve për të gjetur një vend pune.

Së treti, është një problem shumë i rëndësishëm, që ka të bëjë me banorët e Tufinës, një zonë jo shumë larg Tiranës. E keni parë, të

nderuar kolegë deputetë, por edhe qytetarë, që ka pasur konfrontim me policinë. Pse? Sepse atje për një parcelë gjykata vazhdon të japë vendime të ndryshme. Njëres palë i jep të drejtë me të drejtë, për t'ua njohur shtëpitë e tyre, të cilat janë ndërtuar 40 e ca vjet më parë dhe përsëri për atë parcele ka vendime gjykate që ia japin ish-pronarit.

Banorë, nëse më dëgjoni, të jeni të bindur që reforma në drejtësi do t'i japë frutet e saj, me qëllim që ju të ndjeheni mirë për pronën tuaj, për të ardhmen e fëmijëve tuaj dhe për atë që keni punuar duke derdhur të gjithë kontributin tuaj.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Qefalia!

Fjalën e ka deputetja Adriana Jaku. Të përgatitet deputeti Enver Roshi dhe më pas deputetja Elona Gjebrea.

Adriana Jaku – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Ndihem e nderuar që po sjell në këtë foltore zërin e qytetarëve të Lezhës, qytetit ku kam lindur, jam rritur dhe kam privilegjin ta përfaqësoj në Kuvendin e Shqipërisë.

Lezha ime përbëhet nga një potencial i jashtëzakonshëm zhvillimi ekonomik dhe jetese të mirë. Këto janë arsytet pse Lezha ka qenë burim për prurje nga bashkitë e tjera, duke bërë të mundur që popullsia e Lezhës të trefishohet në tri dekadat e fundit, por, për fat të keq, investimet publike nuk i janë përgjigjur kësaj rritjeje të madhe demografike.

Sot dua të sjell në vëmendje kërkesën më të shpeshtë që kam hasur gjatë takimeve me qytetarët: ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike.

Para së gjithash, dua të falënderoj qeverinë që në 6 vjetët e fundit ka bërë dhe vazhdon të bëjë investime në këtë sektor, të vetmet që janë bërë në këta 30 vjet pluralizëm. Si rezultat i këtyre investimeve është përmirësuar ndjeshëm furnizimi dhe janë kufizuar ndërprerjet. Kjo është lehtësisht e matshme në zonën e bregdetit, ku dy sezonet e fundit kanë qenë absolutisht më të mirët për sa i përket furnizimit me energji.

Gjithashtu, vlerësoj investimin prej 1,3 milionë eurosh, që po përfundon në rrjetin elektrik të qytetit të Lezhës, efektet e të cilit besoj se do t'i shikojmë shumë shpejt.

Unë e kuptoj që kemi trashëguar një infrastrukturë, në të cilën jo vetëm nuk është investuar, por edhe është ndërhyrë sipas interesave private dhe politike, duke sjellë amortizimin dhe dëmtimin e rrjetit, veçanërisht në zonat rurale. Dimri është afër dhe mjafton një erë apo një stuhi dhe fshatra të tërë do të ngelin pa energji elektrike. Kjo ndodh sidomos në zonat: Shënkoll, Zejmen, Kolsh, Kallmet apo Dajç.

Përveç ndërprerjeve të energjisë, problematikë tjetër në zonë është edhe tensioni shumë i ulët, çka sjell luhajtje të shumta të energjisë, duke shkaktuar djegie të pajisjeve elektroshtëpiake.

Efektet e amortizimit dhe të dëmtimit të rrjetit po i ndiejnë edhe bizneset e zonës. Kostot në rritje të bizneseve nga mungesa e energjisë janë të papërballueshme.

Para disa ditësh takova pronarin e një biznesi të mesëm, i cili më tregoi se në 24 orë, kostoja e përdorimit të gjeneratorit shkon më shumë se 100 mijë lekë të rinj. Nuk duhet të harrojmë në asnjë moment që këto biznese janë motori i ekonomisë në zonë, ku punësohen me dhjetëra e qindra qytetarë.

Nga ana tjetër, dua të theksoj se niveli i pagesave për qytetin e Lezhës është në rritje. Në muajin janar kishte 73% arkëtime, kurse në fund të shtatorit gjendemi me 109% arkëtime.

Niveli i humbjeve në rrjet është zvogëluar. Nga 43%, që ishte në muajin janar të këtij viti, në shtator të po këtij viti është ulur në 22%. Të gjitha këto tregojnë përmirësim, por, nga ana tjetër, rrisin pritshmërinë e qytetarëve për një shërbim më të mirë dhe për më tepër investime, si zgjidhja e vetme e këtyre problemeve.

Gjithashtu, jam në dijeni të investimeve të parashikuara dhe të miratuara për zonën e Lezhës.

Zonja Ministre, e mora fjalën në këtë foltore t'ju kërkoj publikisht, që këto investime të nxiten dhe të kryhen sa më parë.

Unë jam e vetëdijshme që, me gjithë dëshirën e mirë, jo të gjitha investimet realizohen shpejt, aq më tepër kur vakuumi 25-vjeçar i mungesës së investimeve në këtë sektor ka sjellë pasojat e veta të pashmangshme, por është detyra ime t'ju a u përcjell këto shqetësime dhe të kërkoj me ngulm, në emër të qytetarëve të Lezhës, zgjidhjen e tyre.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Jaku!

Fjalën e ka deputeti Koçi Tahiri. Të përgatiten deputetët Elona Gjebrea, Vullnet Sinaj dhe më pas Eljo Hysko.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Ju kërkoj ndjesë, zoti Roshi, sepse nuk ju pashë dhe mendova se keni lëvizur.

Urdhëroni!

Enver Roshi – Faleminderit!

E nderuar zonja nënkryetare,

Të nderuar deputetë,

Sot, si deputet i Kuvendit të Shqipërisë, ndihem krenar që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Këshilli i Europës, në një rezolutë të veçantë, i dhanë mbështetje Shqipërisë, pavarësisht refuzimit të Francës, të Danimarkës dhe të Holandës.

Ne si parlamentarë duhet të bëjmë mirë detyrat e shtëpisë, të cilat ne, si klasë politike shqiptare vlerësojmë se nuk janë bërë siç duhet në këta 30 vjet. Gjatë gjithë këtyre vjetëve, klasat politike të ardhura në krye, nuk kanë qenë të përgjegjshme për detyrat e veta. E them këtë, sepse shikoj politikanë të ndryshëm që ngazëlleshin televizioneve dhe shprehen me nota paksa të gëzueshme për faktin që Shqipërisë nuk iu dha vota për të hyrë në BE, kjo vetëm e vetëm se ata nuk janë në pushtet sot.

Ne si opozitë e re jemi e gatshme të mbështetim çdo ligj, çdo normë, çdo format të caktuar, që kërkon vendi, për të hyrë në Europë. Thirrja e studentëve në vitet '90, për ta parë Shqipërinë si e gjithë Europa, duhet të jetë një ogur i mirë për të gjithë shqiptarët. Europa pranon në gjirin e saj kombet e veta. Kombi shqiptar, duke qenë më i vjetri në Europë, e meriton të jetë pjesë e Europës, po duhet që ne të jemi me sjellje dhe me qëndrime europiane, jo me sjellje dhe me qëndrime orientaliste. Rilindësit thonë se dielli i Shqipërisë lind nga Perëndimi, por ky diell shpeshherë zihet nga re ogurzeza, të cilat janë orientaliste. Nëse duam të hyjmë në Europë, detyra jonë intelektuale dhe e çdo shqiptari është të sillemi si europianë, të degjojmë intelektualët tanë, rilindësit dhe ata që e meritojnë të jenë në krye të vendit tonë, si Kadareja e të tjerë; të mos abuzohet me politikanët apo me politikën, me ata të cilët e kanë nxjerrë Shqipërinë në skenë në çdo tavolinë

europiane apo tryezë të huaj. Kur shkojmë jashtë, ne përfaqësojmë Shqipërinë.

Në këto kushte, ne duhet bërë një reformë dhe një sistem zgjedhor të arrirë për Shqipërinë dhe për shqiptarët e jo për partitë. Vetëm atëherë do të mund të hyjmë në Europë si qytetarë dinjitozë. Ky popull është lodhur shumë gjatë këtyre viteve për arsye të ngadalësisë së reformave, sepse të tjera gjëra kërkon qytetari dhe të tjera bën politika.

Reforma në drejtësi ka vite të tëra që vazhdon. Kur do të bëhet SPAK-u? Kur do të bëhet Gjykata Kushtetuese? Kur do të ngrihen organet e tjera? Duhet orë e orë të tëra. A nuk munden këta të punojnë 24 orë për popullin? A nuk mund të ngrihen më shumë, të gjejnë mekanizma, që këtij popull t'i vijë në ndihmë organet e drejtësisë? Ky popull është i lodhur nga drejtësia, sepse si pasojë e saj i vijë korrupsioni e të tjera me radhë.

Problematika sociale dhe ekonomike është e madhe; ka pabarazi të theksuar midis fshatit dhe qytetit; ka krahina të tëra të harruara, si Gramshi. E kanë harruar fare Gramshin, pavarësisht kontributit të madh që ka dhënë Gramshi për PS-në. Për 30 vjet Gramshi nuk ka asnjë qendër komune me rrugë asfalti.

Dua t'i them ministres së Ekonomisë, që kjo situatë duhet parë me vëmendje për t'u parashikuar në buxhetin e ardhshëm. Nuk mundet që një zonë e tërë të mos përmendet fare. Duhet parë me realizëm të gjitha zonat e Shqipërisë, duhet parë Poroçani, Kukuri, Kodovjati, Skënderbegasi dhe Tunja. Banorët e këtyre zonave malore nuk mund të vijë në qytet, qoftë edhe për arsye shëndetësore, për shkak të largësisë. Duhet 4 orë të shkosh në qendër të komunës dhe 2 orë të shkosh në spital. Fondin e Zhvillimit Rural që ju keni, duhet ta përdorni për qytetarët, sepse ka zhvendosje të fondeve në zona të tjera. Kjo pabarazi duhet rregulluar. Të gjithë jemi shqiptarë, të gjithë duam të jetojmë dhe të gjithë duam lumturi, por kjo lumturi u duhet dhënë qytetarëve siç e meritojnë.

Unë kërkoj vëmendjen e qeverisë, që t'i përkushtohet më shumë buxhetit për vitin e ardhshëm, që njerëzit të gëzojnë atributet e tyre qytetare para politikanëve, të cilët u kërkojnë votën dhe nuk i mbajnë premtimet e dhëna.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Roshi!

Fjalën e ka deputeti Koçi Tahiri.

Koçi Tahiri – Faleminderit, zonja drejtuese!

Të nderuar deputetë,

Gjatë takimeve që kemi bërë, një nga shqetësimet e zonës së Maliqit ka qenë problemi i papunësisë. Kjo zonë, në pamje të parë duket si zona industriale që dikur ka qenë Kombinati i Sheqerit, por, fatkeqësisht, këta 30 vjet, e ka humbur këtë vlerë. Pra, është një zonë gati e vdekur, pa punësim.

Megjithatë, unë sjell në qendër të vëmendjes shqetësimet e banorëve, të cilët kërkojnë edhe një herë me ngulm riaktivizimin e Kombinatit të Sheqerit. Sigurisht, mundësitë janë, por kushtet janë ndryshe nga koha kur e drejtonte shteti. Këtu mund të vijë investitorë të huaj, të cilët, pse jo, të bashkëpunojnë me qeverinë, por ka disa pengesa burokratike, të cilat bëjnë që një pjesë e mirë e popullatës të shkojë jashtë vendit dhe papunësia të rritet çdo ditë e më tepër.

Mendoj se nga bashkëpunimi i investitorëve të huaj me pushtetin lokal, industria e sheqerit mund të vihet në eficiencë. Nga kjo industri dalin produkte të tilla si: niseshteja, alkooli, majaja, pa llogaritur edhe bërësitë, që janë ushqim për blegtorinë.

Megjithatë, po ta shikojmë në aspektin e qarkullimit bujqësor, fusha e Korçës ose e Maliqit ka rreth 9 mijë hektarë tokë. Fatkeqësisht, një pjesë e mirë e kësaj, rreth 4 mijë e ca hektarë, që mbilleshin me panxhar sheqeri, do të mbillet grurë mbi grurë, duke penguar qarkullimin bujqësor dhe duke influencuar në rendimentet bujqësore.

Shqetësimi tjetër është që nga kjo zonë po hidhen në rrugë prodhimet bujqësore dhe blegtorale. Pra, nuk ka treg të planifikuar. Megjithatë, unë mendoj se vetë Ministria e Bujqësisë do të jetë rregullatore dhe do të riaktivizojë magazinat e ngritura dikur.

Duke përfituar nga rasti, mendoj të ngre edhe një problem tjetër, i cili ka të bëjë me partitë politike. Fatkeqësisht, ka një numër të madh partish, mbi 128 parti politike, por jo të gjitha kryejnë aktivitet. Mund të jenë 60-65 parti që marrin pjesë në zgjedhje, ndërsa të tjerat janë thjesht të regjistruara, por, për fat, u shërbejnë dy partive të mëdha duke bërë koalicionet famëkeqe, që njëri grup thotë “kam 40 parti” dhe

grupi tjetër thotë “kam 30 parti”. Mendoj se ka ardhur koha t’i jepet fund kësaj gjëje.

Problemi tjetër janë sindikatat. Zotërinj, të gjithë e kemi dëgjuar, edhe unë vetë kam qenë dikur drejtues sindikate, pra që në atë kohë, manifestimet, grevat dhe protestat i drejtonim ne, por, fatkeqësisht, hyri politika dhe e bëri çorap këtë punë. Fatkeqësisht edhe sot sindikatat nuk luajnë rolin që u takon.

Problem tjetër janë shoqatat. Ka mbi 28 shoqata joqeveritare, të cilat financohen nga fondacioni “Soros”. Nesër ndoshta do të na dalë ndonjë me biografi të keqe, siç thoshin qëmoti, dhe do të na thotë: këtë gjë e ka financuar Soros-i. Pra, nëse ka një hapësirë, t’i dalim kësaj pune përpara.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Tahiri!

Fjalën e ka deputetja Elona Gjebrea.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Si deputete e zgjedhur nga njësia 1 në Tiranë, kam dëshirë të flas për problematikat e krijuara në zonën e Shkozës, e cila është brenda njësisë administrative nr 1.

Për sa i përket Unazës së Madhe është parashikuar një investim i madh, përkatësisht në lotet 2 dhe 3, ku janë disa zona, të cilat preken nga ky investim, pra zona e Shkozës, e Ali Demit dhe e Kodrës së Priftit. Në fakt, objekti ka një gjatësi të përgjithshme, rreth 3 kilometra dhe kalon në zonë urbane dhe rurale.

Ky projekt parashikon prishje objekteve dhe banesash, të cilat prekin shumë familje në këtë zonë. Konkretisht, nga zbatimi i projektit të lotit 3 preken rreth 50 banesa.

Në fakt, ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë të bashkisë me ARRSH-në dhe me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, por, nga ana tjetër, ka problematika, të cilat kërkojnë një përshpejtim të punës, ndoshta ngritjen e një grupi pune, një task-force që të punojë në lidhje me disa problematika që ka kjo zonë. Dua t’i ngre këto shqetësime dhe këto problematika dhe t’u kërkoj të gjitha autoriteteve një bashkëpunim më të mirë. E theksoj, ndoshta të jetë një grup pune, ku deputeti të jetë pjesë e një raportimi periodik të vazhdueshëm së bashku me përgjegjësit kryesorë, të cilët duhet të jenë të përcaktuar dhe

të mos lëvizin nga një njësi në një tjetër. Për shembull, disa banorë disponojnë banesa të ndërtuara para viteve ’90 me leje të ndërtimit të kohës, por nuk kanë dokumente pronësie dhe nuk përfitojnë shpronësim; disa banorë të tjerë i kanë shtëpitë afër me komshinjtë, banesat e të cilëve janë legalizuar dhe banesat e tyre jo. Ka shumë familje që banojnë në një ndërtesë disa katëshe, por për legalizim ka aplikuar vetëm një familje dhe ato nuk janë evidentuar si të pastreha. Shumë banorë që preken dhe ngelin të pastrehë kërkojnë të trajtohen me kredi të buta nga Bashkia e Tiranës nga e cila, ashtu siç e theksova, e kemi pasur mbështetjen. Disa të tjerë interesohen për leje ndërtimi dhe lehtësim procedurash sipas akteve ligjore dhe rregullave në fuqi. Shqetësimi kryesor i banorëve të zonave, ku po ndërtohet unaza, pra lotet 2 dhe 3, është ndërtimi i rrugëve lidhëse dhe kolektorëve, problematikë që po merret në konsideratë nga investitori dhe, pa dyshim, kërkohej një zgjidhje sa më e shpejtë.

Kështu sikurse e theksova, qytetarët dhe banorët e Shkozës kanë shqetësime dhe problematika nga më të ndryshmet. Kujtoj rastin e fundit, për shembull, ku si rezultat i ndërprerjeve të punimeve tek ura e Shkozës, si pasojë e shirave të vazhdueshëm që ndodhen menjëherë pas tërmetit, 3 nga familjet më të prekura u përmytën, dhe kjo për të disatën herë, duke shkaktuar dëme aq të mëdha, sa që këto banesa nuk janë më të banueshme. Këtyre familjeve vërtet u është ofruar një ndihmë e menjëhershme me programe të strehimit social apo edhe ndihma ushqimore, por, pa dyshim, ato kërkojnë shpronësim. Kështu që kërkoj nga të gjitha autoritetet përkatëse t’i sjellin në vëmendje shqetësimet dhe problematikat që ka njësia 1. Pa dyshim, sugjeroj ngritjen e një grupi pune.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Fjalën e ka deputeti Vullnet Sinaj.

Të përgatitet deputeti Eljo Hysko dhe më pas deputeti Fidel Ylli.

Vullnet Sinaj - Data e sotme, 28 tetor, korrespondon me ditën e lindjes së një burri të shquar të Vlorës dhe të Shqipërisë, të Osman Haxhiut, udhëheqësit të Luftës së Vlorës, që ishte kryetar bashkie, prefekt, një njeri i madh i atij qyteti. Me rastin e kësaj dite, në nder të

familjes Haxhiu, të Vlorës dhe të gjithë Shqipërisë uroj: qoftë i shenjtë kujtimi i emrit të këtij burri të madh!

Zakonisht jemi mësuar që në foltore të jemi kritikë për të qenë korrektë me qytetarët apo me banorët e zonave, të cilave u përkasim, por ndonjëherë duhet përgëzuar qeveria për investimet apo për arritjet që ka bërë në zonë.

Dua ta filloj me një falënderim që kam marrë nga zona ime, ajo e Lumit të Vlorës, e Bashkisë Selenicë dhe një pjesë e Himarës, e cila e falënderon qeverinë për rrugën e Lumit të Vlorës, për korrektesën e madhe që ka treguar qeveria, për fjalën e mbajtur, për premtimin e mbajtur. Ngaqë ky investim ka kaluar në këtë parlament, e ndjeva për detyrë që t’jua thosha, të nderuar deputetë, dhe dua t’ju bëj një raport: punimet po shkojnë shumë mirë, ka mbaruar loti i parë dhe është duke u punuar shumë mirë për lotin e dytë, dhe pas dy lotëve të tjera do të quhet një investim i përfunduar.

Dua të kaloj në një moment tjetër, për të bërë ndonjë kritikë për problemet e asaj zone. Ajo është një zonë rurale, e cila ka probleme të shumta, por dua të ndalem vetëm në dy nga këto probleme:

Së pari, subvencionet në bujqësi, të cilat kanë të bëjnë me subvencionet e blegtorëve të asaj zonë. Gjatë muajve prill-maj ngrita një grup pune, i cili doli në zonë dhe shkoi stan më stan, duke i kontaktuar vetë barinjtë dhe vuri re se periudha prill-maj përkonte me periudhën e aplikimeve. Krahës regjistrimit të barinjve, të tufave të zonës dhe të numrit të krerëve të bagëtive, bëmë edhe sensibilizimin e këtyre barinjve për të aplikuar. Si rezultat i sqarimit të mirë të procedurave për të aplikuar, të cilat janë thjeshtuar nga qeveria “Rama”, pra është goditur burokracia për këto procedura, ku nuk kërkohet paraqitja e shumë letrave për aplikim, patëm në zonën tonë, nga 320 tufa që regjistruam me 100-500 krerë bagëti, rreth 256 fermerë nga këta që aplikuan, të cilët fituan në fazën e parë. Por problemi ndodhi në fazën e dytë, pasi ata aplikuan dhe fituan në fazën e parë, ku u shpallën pak fitues.

Dëgjova edhe kolegun tim parafolës zotin Beqaj, që foli për parimin e udhëzimit të përbashkët të dy ministrive, të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ministrisë së Financave “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit

të fondit për programin e bujqësisë dhe të zhvillimit rural”. Pra, në përfundim të fazës së aplikimit, sistemi gjeneron automatikisht listat e aplikuesve sipas parimit: “Kush vjen i pari, renditet i pari”. Për mendimin tim, ky është një parim që nuk duhet të funksionojë, sidomos në aplikimet për blegtori dhe bujqësi, sepse duket sikur i vëmë në garë ata blegtorë, pra kush të zbrësë i pari nga mali dhe, ndoshta, ata, që ishin afër fushës, në bujqësi, pra zona e Lushnjës, përfituan kurse në zonën time pati shumë pak që përfituan.

U ndala te problemi i subvencionit, sepse ka të bëjë me ekonominë e vendit dhe me boshatisjen e zonave nga banorët. Në këtë rast kemi të bëjmë me boshatisje nga blegtorët, që më pas do të na detyrojnë që, me mbylljen e tufave, të importojmë mishin, qumështin, djathin, por nuk duhet ta bëjmë këtë gjë, sepse eksportet duhet të jenë më të mëdha se sa importet. E them këtë, sepse edhe shtete të fuqishme, si: në Amerikë, në Europë dhe në Ballkan...

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Sinaj!

Do t’u lutem të gjithë deputetëve të mos shqetësohen, sepse në Rregulloren e Kuvendit ka mundësi që deputeti t’i adresojë shqetësimet e zonave edhe në seanca të tjera, edhe në çështjet jashtë rendit të ditës në seancat e ditës së enjte, ose të bëjë pyetje-përgjigje. Do t’u lutem deputetëve ta shikojnë me vëmendje Rregulloren dhe dispozitat e reja që kemi shtuar nga ndryshimet që i janë bërë Rregullores në vitin 2019.

Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Eljo Hysko.

Të përgatitet deputeti Fidel Ylli.

Eljo Hysko - E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Së pari, dua të shpreh keqardhjen time që Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut edhe një herë u bënë viktimat të politikave të brendshme të disa shteteve në Bashkimin Europian, pavarësisht faktit që të dyja vendet guxuan dhe realizuan reformat, të cilat u ishin kërkuar. Sado e dhimbshme dhe zhgënjyese të ishte ajo që ndodhi, edhe pse një dorë ndihme, në fakt, do të na duhej, ne duhet të shkojmë përpara, të punojmë më shumë dhe të mos humbasim

besimin se Europa një ditë do të jetë edhe shtëpia jonë.

Europa nuk është një status politik dhe administrativ, por një rrugëtim civilizimi, i cili synon më shumë mirëqenie, mendje të hapura, zhvillim social dhe kulturor dhe mbi të gjitha liri për të vepruar, për të ofruar dhe për t'u shprehur dhe këtë nuk mund të na e dhurojë asnjë vend tjetër, përveçse ne vetes sonë si Shqipëri, si Kosovë dhe si Maqedoni apo vende të tjera në Ballkan.

Së dyti, dua të përgëzoj edhe një herë nismën e parlamentit shqiptar për "Javën e gjelbër", sepse po rezultojnë shumë efektive dhe deputetët kanë mundësi që të adresojnë më shumë çështje.

Unë po ngre disa çështje nga takimet që kemi pasur me qytetarët e Kamzës, por edhe me institucionet lokale atje.

Sot Kamza është e vetmja bashki në Republikën e Shqipërisë pa një plan urbanistik. Për 12 vjet nuk u pa e arsyeshme që edhe për të në Kamëz të kishim një plan, i cili të adresonte zhvillimin urban të qytetit.

Nga takimi që kemi pasur me Agjencinë e Planifikimit të Territorit, ata janë shprehur të gatshëm për këtë dhe kanë ngritur një grup pune, edhe bashkia ka ngritur një grup ekspertësh, por mungon financimi. Me një bashki, e cila është marrë me 21 milionë euro borxh, është pak e vështirë që të kemi këtë mundësi financimi. Prandaj gjëja e parë që dua të kërkoj është një ndihmë, qoftë nga buxheti i shtetit, qoftë nga donatorë që të financohet ky plan urbanistik. Plani do të na jepte një vizion më të qartë se si kjo zonë mund dhe duhet të zhvillohet.

Ne jemi e vetmja bashki sot, që nuk kemi një shesh publik. Është e vetmja bashki e cila sot nuk ka një hapësirë, në të cilën prindërit e rinj, familjarët mund të dalin dhe të ndërveprojnë me njëri-tjetrin në qytet. Është koha që në Kamëz të vijë "Rilindja urbane", ashtu si në 60 bashkitë e tjera të vendit. Edhe kjo bashki me 150 mijë banorë meriton të ketë vëmendjen.

Duke qëndruar te rekreacioni, parku i Paskuqanit duhet të kthehet në mushkërinë e dytë të qarkut të Tiranës. Ashtu si parku i liqenit të Tiranës, edhe në Paskuqan duhet të kemi një shëtitore, duhet të kemi një ambient të gjelbëruar, duhet të kemi pista vrapi dhe duhet të kemi një hapësirë, në të cilën njerëzit mund të

ndiejnë që ka urbanizim, e cila të kthehet në një hapësirë ekonomike jo vetëm për Kamzën si bashki, por për të gjithë pjesën veriore të Tiranës.

Për të vazhduar më tej, neve na duhet ndërlidhja. Sot Kamza lidhet me Tiranën vetëm me dy gjysmë-ura, është gjysmë-ura e Babrrusë dhe gjysmë-ura e Paskuqanit, ndërkohë që Laknasi dhe Valiasi nuk lidhen me asnjë urë. Ajo që na duhet është që të paktën brenda vitit 2020 këto dy ura të bëhen me dy korsi, në mënyrë që qytetarët të kenë mundësi të ndërlidhen më shpejt. Është absurde që duhet të bësh 5 kilometra për të kaluar në krahun tjetër të lumit. Në qoftë se deri dje problem ka qenë bashkia, sot kemi një bashki, e cila është me sy nga qeveria dhe kërkon fonde, pasi projektet është duke i hartuar.

Një gjë tjetër që kërkojmë për këtë zonë i përket Valiasit dhe Laksanit, një problem dhe një shqetësim, që është ngritur në çdo takim që kemi pasur në zonë, që ka të bëjë me linjën e tensionit të ulët. Mbi 10 mijë abonentë atje janë me linjë 6-mijëshe. Mjafton që dikujt t'i derdhet shishja e ujit dhe është problem me dritat. Në fakt, kanë një batutë që e përdorin në zonë dhe doja ta sillja këtu.

Ne kemi nevojë për një ndërhyrje të menjëhershme. Në dijeninë time, është një projekt që po bëhet. Ajo që dua t'i kërkoj ministrisë dhe OSHEE-së është që ta shtyjnë sa më përpara, sepse ka nevojë.

Duke marrë parasysh se koha po mbaron, një tjetër problem, të cilin dua ta ngre, ka të bëjë me kanalet kulluese. Dua t'i kërkoj Ministrisë së Bujqësisë betonizimin e kanalit ekzistues të Valiasit, por edhe krijimin e një kanali të ri, pasi është i pamënaxhueshëm në mënyrë tjetër. Pra, është një rast i cili përsëritet, që shkakton probleme dhe është e vetmja zgjidhje që mund të kemi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Hysko!

Fjalën e ka deputeti Fidel Ylli.

Të përgatitet deputeti Halit Valteri.

Më pas deputeti Jurgis Çyrbja dhe deputeti Andrea Marto.

Fidel Ylli- Të gjithë e dimë që përpara 1 muaji ra një tërmet i fuqishëm, dhe kryesisht ishte në zonën që unë mbuloj, pra në zonën e gjirit të Lalëzit dhe në kepin e Rodonit.

Dua të shpjegoj se në epiqendrën e tij ai ka dëmtuar mbi 20 shtëpi dhe 10-tra shtëpi të tjera kanë pësuar dëme të konsiderueshme. I bëj thirrje Komitetit të Emergjencave që të përshpejtojë punën, sepse dimri po afron. Boll më me verifikime, se të gjitha i kanë mbi tavolinë, por të nisin punën dhe në rast se koha do të jetë e mirë, puna të vazhdohet me dy turne, që qytetarët dhe banorët e kësaj zone Viti i Ri t'i kapë në shtëpitë e tyre.

Zona e Ishmit dhe ajo e gjirit të Lalëzit është një zonë turistike, por, fatkeqësisht para 2 vjetësh Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve filloi të bënte punime nga pjesa e “City Parkut”, në Vorë deri në Durrës, duke arnuar autostradën. Të gjitha makinat e rënda, që ndërtonin hotele dhe resorte në gjirin e Lalëzit, filluan dhe e devijuan atë zonë të mrekullueshme të Ishmit, të Bubqit dhe pjesën e Rinasit. Kjo është e papranueshme dhe Drejtoria e Rrugëve duhet të mbajë përgjegjësi dhe të fillojë shtrimin e tapetit të rrugës, dhe kjo rrugë turistike të jetë vetëm për ato fshatra dhe jo për makinat e rënda.

Për sa i përket zones, aty ndodhet edhe një rezervuar. Unë mund ta pranoj në një zonë ku nuk ka ujë dhe rezervuarët janë tharë, por jo në një zonë si rezervuari i Tarinit në zonën e Shkafanes, që për arsye të mendjelehtësisë së atyre njerëzve, që e kanë në varësi këtë rezervuar, të mos ketë mundësi vadijeje për gjitha ato toka, të cilat janë djerrë për arsye të motit dhe kohës së thatë.

Unë dua të diskutoj edhe një problem shumë të rëndësishëm. Ashtu siç u realizua projekti i “Rilindjes së qyteteve”, që, për mendimin tim, ishte një projekt i mrekullueshëm, ku të gjitha qytetet dolën në pah, qeveria anonçoi edhe projektin e “100 fshatrave”, por ka dy vjet që nuk është bërë asnjë hap për këtë projekt. Në projektin “100 fshatrat”, për fat të mirë, janë përcaktuar edhe dy fshatra të zonës sime, fshati Radë dhe fshati Shetaj, që janë dy fshatra të mrekullueshëm, por, për fat të keq, mirë që qeveria ka dy vjet që nuk ka bërë të mundur realizimin e këtij projekti, por bashkia nuk ka planifikuar në buxhetin e saj investime në këto dy fshatra duke menduar se do t'i bëjë qeveria me shkolla, me ujë, me kopshte, rrugë dhe infrastrukturë.

Për ta mbyllur fjalën time dua të them se zona e Ishmit dhe e gjirit të Lalëzit dita ditës po

ndryshojnë, por a mendoni që aty nuk ka një rrugë elitare?! Aty ka një rrugë të mjeruar, e cila është rrugë fshati dhe nuk është zonë për të zhvilluar turizmin elitare. Prandaj i bëj thirrje qeverisë të hartojë projektin e rrugës nga Rinasi në Bubq deri në kepin e Rodonit, në mënyrë që kjo zonë të marrë zhvillim turistik

Faleminderit!

Vasilika Hysi –Faleminderit, zoti Ylli!

Fjalën e ka deputeti Halit Valteri.

Halit Valteri - Të nderuar kolegë,

E nderuar drejtuese e seancës,

Vetëm pak ditë më parë një lajm i trishtuar mbërriti nga Turqia, ku Renisi 14 vjeçar, i cili e dashuronte shumë jetën dhe sportin, nuk arriti ta mposhtë gjendjen shëndetësore në të cilën kishte rënë pas aksidentit të 17 korrikut dhe zemra e tij e vogël pushoi përgjithmonë së rrahuri. Ju ftoj të gjithëve të mbajmë një minutë heshtje për këtë vogëlul!

I paharruar qoftë kujtimi i tij!

Nuk mjaftuan as thirrjet e të atit për birin e tij, që po tretej në shtratin e spitalit, as lotët e nënës dhe lutjet e të motrës për vëllanë, që Renisi të ndiqej në një spital më të specializuar jashtë vendit. Po e sjell në vëmendjen tuaj këtë rast, pasi Zoti deshi që të isha mbrëmjen e 17 korrikut pranë Renisit, duke i dhënë ndihmën e parë dhe duke e transportuar drejt spitalit, prej të cilit nuk arriti kurrë të dalë. Jam interesuar gjithmonë për gjendjen e tij shëndetësore dhe modestisht kam bërë çfarë kam pasur mundësi, që t'i krijoheshin kushtet optimale të trajtimit apo shërimit, edhe pse Renisin e nxorën nga reanimacioni, pasi mjekët në pamundësi të kushteve që ofronte spitali nuk mund ta mbanin më tepër sesa duhej. Ndoshta për Renisin 4 muaj ishin vonë! Ikja e tij në moshë fare të vogël na la vetëm dëshpërim. Edhe pse djali me buzëqeshjen e dëlirë arriti t'i ngrohë në pak kohë zemrat e shqiptarëve, ai nuk arriti t'i mposhte dot burokracitë shtetërore dhe as të gjente përkrahjen e shtetit, të cilit i la vetëm njollën e turpit dhe të fajit që e braktisi. Mjaftojnë të mos bëhen vetëm 10 kilometra rrugë, nga ato që bën kjo ministria, që të bëni spitale. Ndërtoni spitale dhe jo korsi biçikletash dhe budallalliqe për të zhvatur shqiptarët.

Kur dëgjoj se shqiptarët duan të ikin, sepse nuk kanë fuqi ekonomike për të përballuar mbijetesën në Shqipëri, mendoj se ata sot më

shumë duan të ikin se nuk kanë mundësi të zgjedhin. Ata nuk kanë mundësi të zgjedhin për jetën e tyre për sa kohë jeta e tyre menaxhohet nga ata, të cilët e kanë mendjen të mbushin xhepat e tyre. Në këtë vend nuk të lejojnë të jesh as i lumtur, as i palumtur, sepse shushunjat e pushtetit ta stampojnë buzëqeshjen në fytyrë ende pa dalë nga pragu i shtëpisë.

Shqiptarët duan të ikin, sepse nuk zgjedhin dot as për trajtimet e tyre shëndetësore. Shqiptarët duan të largohen nga ky vend, sepse nuk votojnë, por, edhe kur votojnë, votojnë nga frika se mund t'i heqin nga puna dhe mund të bëjnë pazar me kafshatën e gojës.

Shqiptarët vuajnë nga konkurrenca e pandershme në arsim, në punë, në administratë, ku ka vetëm meritokraci partie dhe ku sheh analfabetë funksionalë me tesera partie tek të japin leksione sesi duhet të jesh i lumtur. Shqiptarët s'kanë alternativë për sa kohë nuk zgjedhin dot si dhe pse do të arsimohen dhe ku do të punojnë pa pasur frikë se erdhi apo nuk erdhi katallani i pushtetit të radhës. Nuk ka rëndësi sa kushte na vendos Europa, 9, 99 apo 999, pasi Shqipëria nuk plotëson kushtin minimal të jetesës, mundësinë për të zgjedhur dhe jo të zgjedhin të tjerët për ty, duke të të mbushur mendjen se ajo që zgjedhën këta palaço në 30 vjet është në dobinë tënde dhe na qenka më e mira për ne. Shqiptarët nuk janë vetëm të varfër, por janë të papërfaqësuar; nuk janë të lirë, por janë të dhunuar; nuk janë vetëm të fyer, por janë edhe të poshtëruar nga kjo klasë politike. Këta që flasin me miliarda, sikur të ishin kokrra orizi, kanë një raport të frikshëm me paranë, nuk kanë asnjë raport me qytetarët dhe nuk e dinë se çfarë janë hallet e qytetarëve e çfarë duan qytetarët çdo ditë. Këta ndoshta nuk e kanë haberin e vlerës reale të miliardit, sepse po ta dinë vlerën e tij është e frikshme sesi i përdorin paratë e shqiptarëve. Por një gjë është e sigurt, në të dyja rastet kjo lajthitje milionash dhe miliardash është në kurriz të popullit, që këta të paskrupull dhe të pazgjedhur përбетohen çdo ditë në emër të tij me premtimin për të bërë drejtësi se do të çojnë njëri-tjetrin përpara drejtësisë për miliardat që i gllabërojnë nga maxhordomët e tyre, të cilët i kanë veshur me kostumin e biznesmenit dhe në kohë të ndryshme herë i quajnë partnerë shumë seriozë dhe herë, kur e kërkon nevoja, i quajnë oligarkë.

Të dashur kolegë,

Është koha që të bashkohemi të gjithë, të bëjmë diçka për këtë vend dhe jo të shikojmë çdo tender dhe çdo koncesion se si t'i fusim në xhepat tanë, jo këta, sepse nuk kanë asgjë në dorë për të futur, por ju duhet të jeni shtylla dhe njerëzit që t'i bëni presion. Paska ikur kjo e koncesioneve, t'i kalojë ndonjë lekë kësaj të Shëndetësisë të bëjë spitale, qendra shëndetësore dhe jo rrugë për oligarkët dhe biznesmenët e pushtetit.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Valteri!

Fjalën e ka deputeti Jurgis Çyrbja.

Jurgis Çyrbja- E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Seanca dedikuar qytetarëve është pikërisht seanca ku ne, përfaqësuesit e popullit, të zgjedhurit e tij, duhet të përcjellim në këtë sallë hallet dhe problematikat e qytetarëve. Unë sot, si i zgjedhuri i tyre, i zgjedhuri i njësisë administrative të Rrashbullit, do të sjell përpara jush dhe të gjithë shqiptarëve problemin e familjes Hyka dhe hallin që ka kapluar këtë familje, e cila është prekur nga një gjendje e rëndë.

Dashamir Hyka mëngjesin e 22 tetorit u nis si çdo ditë për në punë për të siguruar të ardhurat në mënyrë të ndershme për familjen e tij. Gjatë punës ai pësoi një aksident dhe la jetimë 3 fëmijë të vegjël, bashkëshorten dhe prindërit e tij. A e dini ju që Dashamiri ishte i pasiguruar në ndërmarrjen ku punonte dhe nuk kishte asnjë ditë sigurim jete në rast aksidentesh?! A e dini ju se firma nuk kishte marrë asnjë masë për sigurimin teknik dhe mbrojtjen e jetës së punëtorëve?! Ky është një problem që ka vite që ekziston në Shqipërinë tonë, ku punëtorët e krahut paraqiten në punë dhe mbeten viktimë, pasi firma nuk plotëson kushtet teknike.

I jam gjendur pranë familjes së Dashamirit dhe i kam dhënë fjalën se ky rast do të marrë ndëshkimin e merituar, qofshin këta edhe përfaqësues shtetërorë. Askush nuk mund të jetë mbi jetën e qytetarëve. Askush nuk është dhe nuk mund të jetë mbi ligjin. Ligji për sigurimin e jetës dhe kushtet teknike duhet të funksionojë dhe të zbatohet për të gjithë njësoj. Qeveria jonë i ka shpallur luftë punës në të zezë, prandaj u bëj

thirrje të gjitha organeve të drejtësisë të marrin masa për rastin konkret.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Çyrbja!

Fjalën e ka deputeti Andrea Marto. Të përgatitet deputeti Kujtim Gjuzi.

Andrea Marto – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Fillimisht dua të ritheksoj se krijimi i bashkive, ku shumica e banorëve janë minoritarë, ishte një nga sukseset më thelbësore të reformës administrativo-territoriale të miratuar në mandatin e kaluar.

Sot dua të paraqes disa nga problemet, me të cilat përballen banorët e Bashkisë së Finiqit. Një nga problemet më të mëdha që ka kjo bashki dhe administrata e saj është se duke qenë se kjo bashki është krijuar nga pesë komuna dhe e përbërë vetëm nga 60 fshatra, nuk ka një qendër, një godinë, apo ndërtesë, që të mundësojë ofrimin e shërbimeve cilësore për banorët e saj. Duke qenë një bashki me një fushë shumë pjellore, fushën e Vurgut, e cila dikur furnizonte me ushqim një pjesë të mirë të Jugut të Shqipërisë, ka nevojë për realizimin e dy veprave, të cilat ishin, por u shkatërruan, siç është kanali i Thoma Filipeut dhe kanali Mesopotam-Finiq. Këto dy kanale funksionojnë pjesërisht dhe rritin koston e produkteve për fermerët.

Problem është rrjeti rrugor, i cili është në gjendje të mjerueshme dhe rrjeti i shpërndarjes së energjisë eklektike, që është i amortizuar. Unë kërkoj të shikohet mundësia e rritjes së mirëmbajtjes së këtij rrjeti, duke shtuar elektrikistët në këtë zonë.

Një problem e tjetër i madh në këtë zonë është edhe vjedhja e banesave, pasi në këtë zonë ka emigrim të madh dhe shumë shtëpi janë të pabanuara. Në mandatin e kaluar, me iniciativën e qeverisë, u ngrit një stacion policor, por është i pamjaftueshëm për të mbuluar zonën dhe kërkoj që të fuqizohet me personel dhe logjistikë.

Gjithashtu, duhet të theksoj se edhe në këtë bashki, si në të gjitha bashkitë e tjera të vendit tonë, është kryer një kasaphanë me tjetërsimin e pronave, kryesisht pronave të përbashkëta, pyjeve dhe kullotave. Shpeshherë është përmendur dhe janë dhënë edhe ngjyime të ndryshme për këtë problem, për të cilin duhet

bërë një punë e madhe, sepse tjetërsimi i pronave është mundësuar nga një sistem i kalbur drejtësie. Ne shpresojmë dhe urojmë që sistemi i ri i drejtësisë të vendosë në vend padrejtësitë e krijuara prej shumë kohësh.

Ju faleminderit për vëmendjen dhe suksese!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Marto!

Fjalën e ka deputeti Kujtim Gjuzi. Të përgatitet deputeti Fadil Nasufi!

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar deputetë, shkëlqesi ministra dhe ju që na ndiqni, qytetarë të Republikës së Shqipërisë,

Në fakt, sot është një seancë ku ne duhet të shprehim ato që shohim në zonë. Por çfarë mund të shohim në zonë?! Familje që janë në borxhe në dyqanet e ushqimit, të burgosur për 30 mijë lekë të vjetër për dritat, ndërkohë ka të tjerë të burgosur, në tentativa për t'u rrëmbyer bizneset, të cilët i burgosin, i shpallin në kërkim dhe ata që janë më të "guximshmit", marrin arratinë.

Gjashtë vjet "Rilindja" e kimit, e drogës, e prostitucionit e ka vendosur vendin në ankandin e shteteve, si: Kolumbia, Somalia, Senegali e disa të tjera, të cilat bëjnë vetëm korrupsionin dhe vetëm vjedhin. Të gjithë janë të gatshëm të grabisin ku më shumë e ku më pak.

Në zyrat e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë unë, si deputet i këtij vendi dhe i këtij Kuvendi, pres përditë njerëz nga më të ndryshmit, të cilët kanë rënë në greminën e fajteve, por qeveria nuk i sheh; kanë rënë në greminën e bankave, të cilat kanë një marzh fitimi të jashtëzakonshëm. Edhe kur është paguar 95% e kredisë, përsëri rendin pas përmbarimorëve, pas gjykatave. Vijnë njerëz me lot në sy, në mosha të mëdha, në moshën e tretë, dhe na duhet të bëjmë ndonjëherë ndërhyrje nëpërmjet ekspertëve që kemi. Në fakt, çdo deputet e di se këtu nuk ka asnjë ekspert me pagesë, përveç grupeve parlamentare. Edhe nëpërmjet ekspertëve, me zor i ulim tensionet, sepse Kryeministri i ka marrë peng financat nëpërmjet oligarkëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po, darkon me oligarkët, rri me oligarkët; kur vjen këtu, bën sarkazëm, madje i thotë edhe Kryetarit të Kuvendit, zotit Ruçi: "Shiko, t'i bëjmë pak presion këtij ose atij deputeti.". Në celularin tim ka presion për

tërheqjen zvarrë të Kujtim Gjuzit. Numri është: 0692031272, që rezulton të jetë i Kryeministrit. Në fakt, Kryeministri më njeh që në moshë të re se unë nuk jam trembur kurrë nga diktatura, jo më të më trembë mua Kryeministri që, me gjithë pantallonat e lagura ndonjëherë, nuk i bën 80 kilogramë.

Pse e sjell këtë shqetësim? Në rast se ti, Kryeministër, ke sjellë këtu kërcënim, ke kallëzim penal! Ndoshta sot ke fuqi ta komandosh edhe Prokuroren e Përgjithshme të përkohshme, që, në fakt, po i mbush dy vjet, por të përkohshme për dy vjet, nuk ka shans, se të paktën ne ekonomistët në maturimin e atij që thotë i përkohshëm, i përkohshmi do tre muaj, ja gjashtë ose nëntë muaj, por jo dy vjet!

Prandaj, zonja Prokurore e Përgjithshme, vendos prokurorët në punë për kërcënimin që është bërë në seancën e kaluar; pikërisht gjatë seancës më ka ardhur mesazhi këtu.

Unë nuk kam frikë fare, sepse kam jetuar në këtë vend, kam trashëgimtarë në këtë vend, kam nipër në këtë vend, që, me të drejtë zakone, është pak e vështirë të merret Kryeministri me mua. Një herë që është marrë bashkë me mua dhe me një gazetar të njohur, e ka provuar se si ka qenë puna në këshillin bashkiak. Prandaj, nëse Gramoz Ruçi thotë: “Kujtimi nuk erdhi i veshur në mënyrë etike”, unë i them: “Jo, isha me kollare, por isha me kostum amerikan, si kauboj, se ashtu kam qejf të vishem ndonjëherë unë. Çfarë problemi ka këtu?” Ndërsa sot dikush tjetër i ka thënë: “Ka qenë pronar autoshkollë”. Po, po, madje e kam për nder që kam qenë pronar i një prej bizneseve që ka dhënë rreth 11 mijë leje drejtimi. Ia kam paguar taksat shtetit, deri kur Anastas Angjeli më vuri gjobë një 1 milion e 200 mijë lekë, të cilat nuk kisha nga t’i gjeja për t’i paguar, se unë nuk dua të vjedh. E kam thënë shprehjen e famshme: unë gjithmonë mbaj 10 mijë lekë të vjetër në xhep.

(Bie gongu)

Prandaj, po i them Gramoz Ruçit: mos u merr me autoshkollën time, por merru me ato studimet si anëtar i Partisë së Punës, se ajo është licenca që ke këtu, ajo të drejton dhe je këtu në parlament prej 30 vjetësh! Por fajin e ka Berisha që nuk ta veshi mirë atë fustanin e grave!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Gjuzi!

Ju lutem, ju flisni për etikë, por edhe në fjalën tuaj do të duhet të përdorni etikën në parlament, por edhe në emisionet televizive.

Meqenëse e morët fjalën, do t’ju lutesha të ishit i kujdesshëm dhe të respektonit Kodin e Sjelljes.

Lidhur me atë çfarë ju thoni, ka procedura Rregullorja lidhur me trajtimin e ankesave që ju mund të keni për shkeljen e etikës nga drejtuesit e seancës ose nga deputetët të tjerë. Nuk besoj të keni depozituar ndonjë kërkesë në komisionin përkatës, në sekretariatin që merret me etikën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani...

Faleminderit! Jo!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Gjuzi, unë ju solla në vëmendje që, nëse keni ankesa për zbatimin e Rregullores, ka një sekretariat që merret me vlerësimin.

(Ndërhyrje nga salla)

Ju sjell në vëmendje nenin 6, që flet për gjuhën joparlamentare dhe diskriminuese, e cila është ndaluar në parlament dhe në jetën jashtëparlamentare pasi jeni deputet.

Fjalën e ka deputeti Fadil Nasufi. Të përgatitet deputeti Ligorag Karamelo.

Fadil Nasufi – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Kolegë deputetë,

Nuk do t’i parashtroj problemet thjesht i fokusuar nga problematikat që ngrenë zgjedhësit, por edhe në këndvështrimin e së vërtetës me të cilën ne përballemi.

Së pari dua të sjell në vëmendje faktin që, nëse u referohemi punëve të kryera, investimeve publike dhe modeleve transformuese që kanë ndodhur gjatë këtyre 5 vjetëve në shkallë kombëtare, kemi bërë një kapërcim të madh. Kjo nuk ka asnjë qasje me atë që ka ndodhur para vitit 2013. Sot flasim për një filozofi bashkëkohore, prioritete të mirëstudiuara dhe strategjike të investimeve. Në këto vite janë realizuar projekte cilësore me standarde të qëndrueshme dhe me cikël të plotë investimi. Investimet e kryera janë orientuar në zona me resurse të pasura zhvillimi dhe kanë sjellë përfitime të lartë ekonomike dhe publike. Kemi një bilanc të pasur dhe cilësor të shërbimeve, por edhe investime me kthyeshmëri të kostove që matet me zhvillimin e biznesit, me rritjen e qarkullimit të mallrave, me dinamikën dhe

trendin rritës të ekonomisë. Shënohet si risi gjenerimi i kulturës, i qytetërimit, i përmirësimit të peizazhit urbanistik, i pasurimit të qyteteve tona me parqe, me mjedise kulturore sportive. Qytetet janë kthyer tamam në qytete. Pra, ka ndodhur një transformim mbresëlënës.

Së dyti, ne trashëgojmë një prapambetje të madhe zhvillimore nga pikëpamja e infrastrukturës ndër vite dhe po kaq problematike janë edhe problemet e furnizimit me ujë të pijshëm, të kanalizimeve të ujërave të zeza, të furnizimit me energji elektrike e të tjera.

Së treti, mënyra sesi janë zhvilluar qytetet dhe fshatrat tona demonstrojnë më qartë tranzicionin shqiptar. Përprerja e individit për një jetë më të mirë ka rezultuar në një produkt kolektiv problematik. Kjo do të thotë se buxhetet vjetore të shtetit e kanë të pamundur të realizojnë edhe për shumë kohë të gjithë deformimet urbanistike që kanë ndodhur dhe të gjitha plagët e tranzicionit që janë krijuar nga keqmenaxhimi i qeverive të mëparshme.

Megjithatë, ne nuk duhet të vazhdojmë më me justifikime, as me fajësime politike, apo me fabulën: “E kishte ky, e ka ai, e ka kush e ka” dhe ta lëmë fatin jetim në kurriz të njerëzve, por duhet të përballemi me situatat që kemi tani në vitin 2019. Nuk duhet të kemi një diferencë kaq të madhe kohe midis premtimit dhe realizimit, midis objektivit dhe finalizimit. Edhe pse ka arsye për mosplotësimin e investimeve, nuk duhet të ketë tejkalim mase nga pritshmëria e duruar e njerëzve, sepse në shumë raste abuzohet me besueshmërinë e tyre. Durimi i gjatë kalon në zhgënjim dhe në lodhje pa fund.

Sot po sjell në vëmendje emergjencën për të investuar në linjat e tensionit të mesëm dhe furnizimin me energji elektrike të 15 fshatrave të njesisë Velabisht dhe 14 fshatrave të njesisë Sinjë, që së bashku kanë 18 mijë banorë, të cilëve u ndërpritet energjia elektrike pasi linjat janë tejet të amortizuara dhe janë ndërtuar që në vitin 1969.

E njëjta situatë është edhe për fshatin Lapardha, për Orizajn, për Moravën, në njësinë Otlak. Ka fshatra me 2-3 mijë banorë si Velabishti, Starova, Veterniku, Remanica, Duhanasi, Droboniku, Morava, Lapardhaja, Otlaku, Orizaj, që e kanë më shumë se emergjencë furnizimin me ujë të pijshëm. Këtë

shqetësim e kanë ngritur edhe herë të tjera. Janë 834 kilometra rrugë lokale që e kanë humbur funksionin “rrugë” në të gjithë Bashkinë e Beratit, ashtu siç kanë ngritur shqetësimin se nuk pret më investimi për rrugën kombëtare Poshnjë - Roskovec apo për rrugën Tërpan – Drobonik- Përmet.

Kam edhe një shqetësim të fundit, janë dy kontrata të lidhura për rrugën “Muzakë Topia” në Berat dhe për parkun industrial, rikualifikim urban në Kuçovë, të cilat kanë probleme të shpronësimit.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Nasufi!

Fjalën e ka Ligoraq Karamelo. Të përgatiten deputetja Edlira Bode dhe deputeti Vasil Sterjovski.

Ligoraq Karamelo – E nderuara zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Sot mbushet 1 vit nga vrasja e shtetasit shqiptar me kombësi greke Kostandin Kacifas në Bularat të Dropullit. Është një shqetësim i ligjshëm për të gjithë pjesëtarët e minoritetit etnik grek, sepse ende nuk është zbardhur ngjarja, nuk është zbuluar e vërteta dhe nuk ka një version zyrtar për këtë vrasje. E them këtë jo për të acaruar, por me qëllim për të kontribuar në përmirësimin e situatës që ekziston sot në minoritet, por edhe në marrëdhëniet ndërshtetërore dhe për të sheshuar plagën e thellë që është krijuar nga kjo ngjarje. Është një e drejtë njerëzore dhe fillimi themelor i ekzistencës së shtetit të së drejtës që familja, të afërm, komuniteti dhe të gjithë të njihen me përgjigjen e pyetjeve: përse u vra Kostandin Kacifas në rrethana të dyshimta dhe ende të pasqaruara? Përse nuk ka një hetim përfundimtar për këtë ngjarje?

E keqja më e madhe është se nga të dyja anët e kufirit ai trajtohet me epitete ekstreme. Në Shqipëri quhet “ekstremist grek”, ndërsa në Greqi quhet “hero grek”. Emërtimi i parë, duke e quajtur ekstremist grek, për minoritetin është diskriminues, përçarës dhe ofendues, sepse një diferencim i tillë është kundër parimeve të një shoqërie demokratike.

Nga ana tjetër, dua të them se kjo ngjarje mund të ishte parandaluar me një kujdes më të madh, aq më tepër që në Shqipëri demokracia është ende e brishtë, institucionet e shtetit të së drejtës janë tepër delikate dhe mbi të gjitha

marrëdhëniet mes dy vendeve tona janë aq delikate, sa një ngjarje e tillë i agravon së tepërmi.

Minoriteti kërkon marrëdhënie të shkëlqyera Shqipëri – Greqi dhe jo në nivelin që fatkeqësisht janë sot. Ky incident që ndodhi tregoi që një ngjarje e tillë kalon shpesh dhe agravon në urrejtje nga njëra palë tek tjetra.

Ne e pamë se çfarë ndodhi në varrimin e të ndjerit, si nga histeria në Greqi, ashtu edhe ngjarjet në Shqipëri, pati mijëra komente në rrjetet sociale, banderola në stadione apo tubime të paligjshme që plotësojnë këtë urrejtje reciproke.

Të dyja palët u kujdesën më shumë që të përcjellin në opinion mesazhin që ngjarja ishte e zbardhur pa u sqaruar më parë.

Tjetër, a ndihmon shpallja “*non grata*” e 54 personave shtetas grekë, euro deputetë, politikanë dhe përfaqësues, në një kohë që marrëdhëniet mes dy vendeve janë të brishta dhe Shqipëria kërkon të integrohet? Kjo besoj se është kundër përpjekjeve integruese. Por çfarë duhet të bëjë konkretisht qeveria për të përmirësuar situatën?

Së pari, marrëdhëniet shqiptaro – greke përmirësohen duke u nisur nga baza, nga traktati i miqësisë që ekziston.

Së dyti, duhet me patjetër të mbështetet në përpjekjet që bënë dy ish- ministrat, Bushati dhe Kocias, për të rregulluar këto marrëdhënie.

Së treti, duhet një investim serioz dhe një ndryshim katërcipërisht i politikave qeveritare ndaj minoritetit, sepse nuk mund të vazhdohet me politika përçarëse, nënvlerësuese dhe neglizhuese. Qeveria duhet të bëjë investime konkrete, t’i mbështesë financiarisht, sepse fshatrat e minoritetit janë të boshatisur dhe pa infrastrukturë, të mos lejohet tjetërsimi i pronave, të lejohet vetëdeklarimi i popullsisë, të motivohen pjesëtarët e minoritetit që të përfshihen në menaxhimin e të mirave materiale dhe shërbimeve publike, që ata të mos ndihen të distancuar nga identiteti kombëtar shqiptar.

I theksova këto shqetësime jo për t’u ankuar, por për të vënë në dijeni qeverinë, Këshillin e Ministrave, Kryeministrin, politikën në përgjithësi dhe opinionin, aspak me keqdashje, por për të ndihmuar dhe dëshmuar se zgjidhja e tyre është jo vetëm në të mirë të minoritetit, por edhe të gjithë vendit dhe procesit

integrues të tij, sepse asgjë e keqe nuk i ka ardhur, nuk i vjen dhe nuk do t’i vijë vendit tonë nga minoriteti etnik grek në Shqipëri.

Personalisht, karriera ime politike ka qenë dhe është në shërbim të kësaj kauze. Kontributet e mia modeste i dhashë edhe në qëndrimin pozitiv ndaj hapjes së negociatave.

Besoj se integrimi në BE na shërben të gjithëve, pozitës dhe opozitës, u shërben gjithë minoriteteve. Ne nuk duhet të dekurajohemi nga ajo çka ndodhi së fundi dhe as të zëvendësojmë integrimin me izolimin duke iu rikthyer nacionalizmit si mënyrë për të ruajtur pushtetin dhe për të fituar vota në zgjedhje apo duke kthyer dhe drejtuar shikimin diku gjetkë.

Rruga jonë e vetme është drejt Europës.

(I ndërpritet fjala se ka mbaruar koha në dispozicion.)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Karamelo!

Fjalën e ka deputetja Edlira Bode.

Edlira Bode - E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Gjatë seancës së 30 shtatorit, që ishte seanca e parë pas javës së blertë në zbatim të rregullores së re të Kuvendit, duke qenë se ishte e freskët ngjarja e tërmetit të datës 21 shtator, me të drejtë, kolegët deputetë, përfaqësues të zonave të prekura, kryesisht Durrës, Tiranë, Elbasan morën fjalën këtu dhe raportuan mbi problematikat, shqetësimet apo edhe masat e marra për përballimin e situatës.

Siç të gjithë e dimë, një tërmet i mëparshëm, i datës 1 qershor, preku qarkun e Korçës dhe solli dëme të konsiderueshme, fatmirësisht, vetëm materiale, kryesisht në 3 fshatra të bashkive Korçë, Ersekë e Devoll. Vidohova është një fshat me rreth 500 banorë, 150 shtëpi, në juglindje të vendit tonë, kufitar me shtetin grek, në bashkinë e Devollit. Ky është një nga 3 fshatrat e dëmtuar më së shumti nga tërmeti i 1 qershorit, fshat me terren të thyer malor, i ndarë në tri lagje, me vështirësi komunikimi me njëra-tjetrën për shkak të terrenit, por edhe me fshatin më të afërt të madh, qendër njësie, për shkak të 4-5 kilometrave rrugë shumë të keqe e të pamirëmbajtur deri në atë kohë.

Tërmeti ishte padyshim një ngjarje dramatike për banorët e zonës. Frika dhe paniku që shkaktoi goditja fillestare me intensitet të lartë, u shoqërua me ankth e pasiguri pasi toka vazhdoi të lëkundej për ditë me radhë nga një numër shumë i madh goditjesh të tjera më të vogla.

Jam këtu për të dëshmuar që menjëherë pas rënies së tërmetit, strukturat e Emergjencave Civile të prefekturës Korçë, bashkisë Devoll, si dhe forca të ushtrisë të koordinuara nga prefekti i Qarkut, u gjendën në Vidohovë, për të menaxhuar situatën e krijuar. Banorët e shtëpive në rrezik shembjeje u strehuan në çadra të emergjencave civile, iu siguria ushqimi në një mensë të ngritur nga bashkia e Devollit e të furnizuar me ushqime nga institucione joqeveritare si Myftinia e Korçës apo Kryqi i Kuq. Pati prani të shtuar të përfaqësuesve nga institucionet qendrore dhe vendore, kryesisht arsimore dhe shëndetësore, me psikologe të dërguar nga Zyra Arsimore Vendore dhe një çadër që shërbeu si qendër shëndetësore e përkohshme shtesë, në atë lagje që e kishte më larg ambulancën e fshatit.

Një nga autoambulancat e Sspitalit të Bilishtit, e pajisur dhe me personel shëndetësor, mjek dhe infermier, gjatë dy javëve të para pas tërmetit, shkoi çdo ditë në Vidohovë e qëndroi aty në gatishmëri, duke shërbyer, në fakt, në jo pak raste, ku të sëmurët patën nevojë të transportohen në spital.

Zëvendësministri i Mbrojtjes dhe drejtori i Përgjithshëm i Emergjencave Civile vizituan Vidohovën disa ditë pas tërmetit, morën kontakt me banorët dhe konstatuan personalisht situatën dhe masat e marra. U bë konstatimi paraprak dhe më pas vlerësimi real i dëmeve nga komisioni me specialistë, i ngritur sipas ligjit.

Tërmeti i 1 qershorit në gjithë territorin e Bashkisë Devoll bëri totalisht të pabanueshme 11 shtëpi, dëmtoi rëndë 29 dhe shkaktoi dëmtime më të lehta në 95 të tjera. Në kohën e duhur, bashkia Devoll bëri ndërhyrje të rëndësishme për riparimin e urës dhe rehabilitimin e rrugës që lidh Vidohovën me qendrën e njësisë Miras.

Katër sipërmarrje private, duke treguar solidaritet të admirueshëm, morën përsipër ndërtimin e shtëpive të reja, kanë filluar punën e një pjesë janë tashmë drejt përfundimit.

(I ndërpritet fjala se ka mbaruar koha në dispozicion)

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Bode!

Fjalën e ka deputeti Vasil Sterjovski. Të përgatitet deputeti Florenc Spaho, e më pas deputetja Edlira Hyseni.

Vasil Sterjovski – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Si deputet i qarkut të Korçës, po përcjell shqetësimin e banorëve të rrethit të Korçës, veçanërisht të njësisë administrative Pojan dhe të Bashkisë Pustec, në lidhje me urën e dëmtuar të Zëmbllakut.

Nga fundi i muajit nëntor të vitit 2017, si pasojë e prurjeve të shumta të lumit të Devollit, ura e Zëmbllakut, në rrethin e Korçës, u dëmtua në pjesën kryesore të saj. Kjo urë ndodhet në rrugën nacionale Korçë-Goricë dhe lidh dhjetë mijë banorë të njësisë administrative Pojan, bashkisë Pustec dhe doganën e Goricës me Maqedoninë.

Në shkurt të vitit 2018 u gjet si zgjidhje: ngjitur me urën e dëmtuar u ndërtua një urë provizore nga ushtria e Kosovës, në bashkëpunim me atë shqiptare, me një kapacitet mbajtës prej jo më shumë se 40 ton. Ndonëse kanë kaluar pothuajse dy vjet, nuk janë marrë masa për rikonstruksionin e urës së Zëmbllakut, ndërkohë që ura provizore paraqet rrezik për makinat, sidomos natën. Si pasojë, janë shkaktuar edhe disa aksidente.

Autoriteti rrugor shqiptar duhet të marrë masa në lidhje me rikonstruksionin e kësaj ure, e cila veç banorëve të fshatrave të njësisë administrative Pojan dhe bashkisë së Pustecit, do t'i shërbejë gjithashtu edhe shumë banorëve të bashkive të Korçës e të Devollit.

Të nderuar deputetë, ditën e shtunë, më 26 tetor 2019, Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski bëri një vizitë zyrtare në Tiranë, me ftesë të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, zotit Ilir Meta.

Si deputet në parlamentin shqiptar dhe si përfaqësues i komunitetit maqedonas në Shqipëri, pata një takim me presidentin Stevo Pendarovski, me të cilin shkëmbyem mendime në lidhje me situatën aktuale në të dyja vendet, gjendjen aktuale dhe të drejtat e komunitetit

maqedonas në Shqipëri, si dhe mundësitë për përmirësimin e pozitës së këtij komuniteti.

Presidenti Stevo Pendarovski kishte planifikuar të takohej edhe me Kryeministrin Edi Rama, por siç u njoftova nga delegacioni maqedonas, gjysmë ore para takimit, zyra e Kryeministrit Edi Rama anuloi takimin, me këtë shpjegim: “Kryeministri ka një takim të rëndësishëm.” Takimi u shty pas konferencës së përbashkët për shtyp, të dy presidentëve: Meta dhe Pendarovski.

Kryeministri duhet ta informojë publikun se përse e shtyu takimin me Presidentin Stevo Pendarovski gjysmë ore para mbajtjes së tij. Duke pasur parasysh se takime të tilla planifikohen javë përpara, mbetet përshtypja se sjellja e Kryeministrit është joserioze, e madje nuk është në frymën e fqinjësisë së mirë, sidomos duke pasur parasysh faktin se Republika e Shqipërisë dhe Republika e Maqedonisë së Veriut po ecin së bashku drejt rrugës europiane dhe kanë ndarë të njëjtën masë nga samiti i fundit i Këshillit Europian: shtyrjen e datës për fillimin e negociatave me Bashkimin Europian.

Nuk është sekret fakti se Maqedonia e Veriut s’mori një datë për fillimin e negociatave për shkak të vendit tonë: Shqipërisë. Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë kriter për integrimin europian, dhe Republika e Shqipërisë duhet të promovojë këtë politikë me të gjithë fqinjët tanë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Sterjovski!

Fjala është për ju, deputetja Edlira Hyseni!

Edlira Hyseni – E nderuar drejtuese e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Në këtë seancë të veçantë, parashikuar nga ndryshimet e fundit të Rregullores së Kuvendit, deputetët mund të përcjellin shqetësimet, nevojat apo kërkesat e banorëve të qyteteve prej nga ne vijmë si përfaqësues në këtë parlament.

Në fakt, e di se ka ende një debat dhe një gjykim publik në lidhje me legjitimitetin e deputetëve të rinj të kësaj opozite parlamentare, si dhe të drejtën e tyre për të përfaqësuar qytetet prej nga ata vijnë. Unë mendoj se janë vështirësi të vogla brenda interesave të mëdha, por personalisht nuk ndiej asnjë kompleks në lidhje

me këtë gjë. Unë jetoj në Durrës çdo ditë. E kam ndjekur vit pas viti zhvillimin apo shkatërrimin e qytetit tim. Kam parë rrugët, që ia kanë shtruar tri herë brenda një kohe të shkurtër. Kam parë sheshrrrotullimet që ndërtohen në darkë dhe shkatërrohen në mëngjes. Unë e di se sa pemë ishin kur bënim plazh në Golem dhe sa mirë ishim dhe sesa e pamundur është të gjesh një hije sot në Durrës; sa rëndohej trafiku në kohë të ndryshme dhe sa problem është bërë ai sot në Durrës dhe sa e pamundur është bërë të gjesh një parkim.

Të jesh durrsak do të thotë të kesh rrëshqitur të paktën një herë në sheshin prej betoni përpara bashkisë në vesën më të parë ose të kesh sharë nëpër dhembë sa herë ke kaluar në zhegun përvëlues të verës. Nuk ka durrsak të mos e ketë bërë të paktën këtë një herë në këto vite. Unë mendoj se durrsak të bën dashuria për të dhe nuk besoj se ka deputetë të tjerë prezentë apo nga ata që kanë qenë më parë që ta kenë dashur këtë qytet më shumë sesa unë. Unë ndihem me të drejta të plota për të folur dhe për t’i përfaqësuar ata për ato çështje që i gjykoj se janë të rëndësishme, pavarësisht se ato janë shumë, prandaj sot do t’ju përmend vetëm disa prej tyre, pasi muajt e ardhshëm do të vijoj me problematikat e tjera.

Një nga problemet më të mëdha që ka qyteti i Durrësit dhe besoj se i bashkohet edhe shumë qyteteve të tjera shqiptare, është përmbytja. Jemi në prag dimri dhe nuk ka durrsak që të mos e ndjekë me preokupim motin, sidomos shiun. Në qytetin tonë gjithë këta vjet, sidomos dimër pas dimri, kemi pasur përmbytje të rrugëve anembanë qytetit, të fushave dhe të mbjellave kudo që ato ndodhen. Durrësi ka nevojë për një investim serioz, për fonde qeveritare të posaçme, për zgjidhjen me themel të problematikave që lidhen me dy kanalet kryesore të ujërave të bardha dhe të zeza. Ato kanë nevojë për pastrim, sistemin, mbulim, ristrukturim dhe riorganizim. Së bashku me pastrimin e kanaleve ujitëse dhe vaditëse, të cilat sot aktualisht ndodhen në 50% të funksionimit të tyre, me mirëfunksionimin e hidrovorit apo të rezervuarëve kudo që ndodhen durrsakët shpresojnë të zgjidhet përfundimisht problemi i përmbytjeve, i cili ka sjellë dëme të konsiderueshme materiale për çdo familje dhe biznes në qytet.

Çështja e dytë që dua të ngre lidhet me biznesin e Durrësit. Ekonomia durrsake mbështetet mbi të gjitha në sektorin e shërbimeve, i cili është i përqendruar kryesisht tek turizmi; transporti i mallrave dhe i pasagjerëve brenda dhe jashtë vendit; masoneria; shërbimet e tjera ndihmëse të transportit dhe jo vetëm *call center*-at e të tjera. Të gjitha bizneset që janë pjesë e këtij sektori të gjerë shërbimesh kanë problematika të njëjta këta 2 vjetët e fundit. Ato mund t'i përmbledh në tri pika kryesore.

Së pari, biznesi në Durrës, por siç besoj edhe në mbarë Shqipërinë, përballet me problemin e madh të këtyre 2 vjetëve të zhvlerësimit të euros dhe të humbjeve të konsiderueshme nga kursi i këmbimit. Janë biznese që punojnë me tregun e huaj europian, kryesisht italian, por edhe me fqinjët e tjerë, ndaj të ardhurat e tyre të deklaruara në euro përkthehen në shumë më pak lekë sesa më parë, ndërkohë që shpenzimet janë gjithmonë në lekë si për pagat, qiratë, taksa, tatime e të tjera.

Pra, jemi në vështirësi të mëdha, pasi bizneset kanë arritur të vënë në diskutim ecurinë dhe vijimësinë e tyre, sepse kostot nuk arrijnë të mbulohen me të ardhurat më të pakta të realizuara dhe ata ende nuk e dinë se çfarë do të bëhet dhe se si do të shkojë ky problem dhe nëse do të ketë ndonjë trend që do ta përmirësojë atë.

Një çështje tjetër për biznesin e Durrësit, ndoshta mund të jetë edhe në qytete të tjera të Shqipërisë, është shqetësimi në rritje, i cili lidhet me mungesën e tregut të lirë dhe garantimin e konkurrencës së ndershme. Jemi në kushtet e një ekonomie, e cila besoj se nuk është aq rozë sa ç'e paraqesin statistikat zyrtare, për të cilat duhet të jemi pak skeptikë në saktësinë apo vërtetësinë e tyre, kështu që lufta mes llojit bëhet më e ashpër dhe forca e lekut më e madhe. Duket sikur në Durrës bizneset, që kanë një jetë që e kanë ngritur aktivitetin e tyre, sot rrezikohen të mbyllën, por nëse duan të ecin përpara apo të mbijetojnë, ose duhet të jenë të pushtetshëm, ose të fortë, ndryshe konkurrenca e lirë e tregut bëhet e pamundur për t'u dhënë atyre frymë.

Problemi i tretë lidhet me një realitet tashmë të provuar dhe me një perceptim rreziku dhe ankthi që biznesi durrsak ndien aktualisht, raportet që ai ka me organet tatimore dhe institucionet e tjera kontrolluese lokale apo qendrore. Jemi pas një furtune që kaluam gjatë

sezonit veror, ku në fushatën e famshme antiformalitet biznesi ndjeu dorën rëndë të ndëshkimeve tatimore. Në fakt, me sa duket edhe këta muajt e fundit të vitit, biznesi i vogël, i mesëm dhe i madh do të përballen sërish me fushata kontrolli në terren, por duhet të keni parasysh që, së pari, a jeni të sigurt që ky sulm i egër ndaj biznesit e ndihmon klimën e biznesit në Shqipëri?

Së dyti, a e dini se bizneset mendojnë që ky është një sulm ndaj tyre për realizim plani buxhetor ose individual? Kjo i revoltonte ata shumë.

Një nga çështjet e tjera, që ngrenë qytetarët durrsakë, lidhet me portin e Durrësit. Jemi qyteti me portin më të madh në vend, por jemi qyteti që përfiton pak ose aspak të ardhura nga ky port. Durrsakët pyesin: pse qyteti i tyre nuk ka ndriçimin dhe rrezatimin e vendeve simotra? Sa të ardhura nga ky port përfiton qyteti i Durrësit? A është sot ai sikurse dje, i mirëmenaxhuar dhe fitimprurës për shqiptarët? Drejtoret shkojnë e vijnë (kemi lëvizje përsëri kohët e fundit, madje nuk e di nëse është emëruar drejtori i ri), a mund të zgjidhen profesionistë dhe qytetarë të ndershëm durrsakë që do të mendonin dhe punonin me dashuri për qytetin dhe me dëshirën për t'i dhënë zhvillim këtij porti?

Një çështje tjetër që kërkon vëmendje janë kantieret e hapura për ristrukturimin e disa godinave arsimore, shkolla, kopshte dhe çerdhe. Është një investim i shumëpritur në vite, në fakt, nga durrsakët. Për këtë çështje shpresohet një bashkëpunim optimal dhe eficient midis bashkisë dhe qeverisë në mënyrë që kantieret e ndërtimit të mbyllën sa më shpejt, punimet të realizohen sa më shpejt dhe fëmijët të rikthehen në situatë normale.

Së fundi, Durrësi ka nevojë për rikonstruktiv të të gjitha godinave arsimore, në qytet dhe periferi. Janë të paktën 3 shkolla që kanë nevojë dhe urgjencë për ndërhyrje të shpejtë. Për këtë duhen fonde nga qeveria.

Ka shumë probleme që mund të ngremë këtu, ne i shprehim, qeveria t'i marrë parasysh dhe të zgjidhen.

Faleminderit!

Vasilika Hysi- Faleminderit, zonja Hysi!

Fjalën e ka deputeti Florenc Spaho.

Të përgatitet deputeti Bujar Çela dhe më pas deputetja Antoneta Dhima.

Florenc Spaho – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të flas në këtë foltore si deputet i Elbasanit, më ngarkon përgjegjësinë e përfaqësimit të një qyteti që i ka dhënë Shqipërisë shumë gjatë gjithë historisë. Shumë gjëra edhe mund t'i ketë marrë, por të gjithë jemi dëshmitarë të harresës herë të qëllimshme dhe herë jo nga të gjitha qeveritë postkomuniste deri në vitin 2013, kur Edi Rama e bëri Elbasanin qytetin nga ku nisi rilindja urbane. Nga ai moment qyteti filloi të jetojë ndryshimin e madh në investime, që të marra bashkë shkojnë në shifrat mbi 10 milionë euro.

Më lejoni të përmend disa prej tyre: impianti i përpunimit të mbetjeve, që shpëtoi përgjithmonë qytetin nga burimi më i madh i ndotjes; stadiumi që e bëri Elbasanin të jetojë për net të tëra me brohoritjet e dhjetëra mijëra shqiptarëve nga mbarë kombi dhe bizneset e huaja të përfitojnë ndjeshëm prej vizitorëve; rikonstruksioni i të gjitha rrugëve kryesore që përmirësoi përditshmërinë e mijëra banorëve; investimi i madh që është duke u kryer në përroin e Zaranikës, që po shpëton nga përmytja lagje të tëra. Mund të përmend, gjithashtu, edhe investimet e mëdha në spitalin rajonal të Elbasanit, siç është ndërtimi i urgjencës së patologjisë.

Gjej rastin të falënderoj personalisht ministren e Shëndetësisë për vëmendjen e shtuar që i ka dhënë Elbasanit.

Ka shumë për të falënderuar, por edhe shumë për të bërë. Ndërkohë që qyteti i Elbasanit është futur në rrugën e pakthyeshme të ndryshimit, zonat rurale janë ato që kanë më shumë nevojë për vëmendje dhe investime. Banorët e Shushicës dhe të Gjinarit, që tashmë janë në listën e 100 fshatrave, kanë nevojë të prekin me dorë dhe të shohin me sy të mirat që do të vijnë nga ky proces ambicioz i qeverisë.

Ajo që do të doja të theksoja është se Funari është një tjetër zonë që duhet të ketë më shumë vëmendje. I gjendur në mes Elbasanit dhe Tiranës, qëndron si një xhevahir i pazbuluar me një potencial të jashtëzakonshëm turistik. Bashkia ka disa vite që ka filluar ta nxjerrë në pah me aktivitete promovuese të natyrës, të kulturës dhe kulinarisë, por që qeveria do të duhet patjetër ta mbështesë me projekte

madhore, të cilat do të lejonin banorët e zonës të merrnin më të mirën nga ajo që Zoti i ka dhuruar. Po kështu ndërhyrja në rrugën dytësore Kuqan-Buqës-Jagodinë, Muriqan-Thanë do të shpëtojë investimet në bujqësi të shumë fermerëve të zonës më pjellore të Elbasanit, por edhe të zonave përreth, sepse ata që kanë më tepër nevojë për vëmendje janë zonat malore.

Puna ime e përditshme më bën të takoj shumë njerëz dhe të shkel në shumë vende. Ka shumë fshatra ku ne nuk kemi zgjidhur problemet jetike, si uji pijshëm ose energjia elektrike. Besoj se të gjithë biem dakord që këto probleme duhen zgjidhur para çdo politike tjetër që synon rimëkëmbjen e fshatit.

Azhornimi i tokave është një tjetër problem që do të duhet ta shohim me vëmendje të veçantë. Bashkia e vetme nuk ia del, por me një mbështetje të ministrisë së linjës jam i sigurt se do të zgjidhet një prej problematikave më të rëndësishme të fshatrave të Elbasanit. Qeverisja është një sfidë, mirëqeverisja nuk është asgjë tjetër vetëm si një detyrim që ne kemi përballë komuniteteve tona. Duhet të mos nënvlerësojmë asgjë, të merremi me shqetësimin më të vogël të banorit të fshatit më të thellë, ashtu siç merremi me banorin që jeton në qendër të qytetit.

Vasilika Hysi- Faleminderit, zoti Spaho!

Fjalën e ka deputeti Bujar Çela.

Bujar Çela – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të gjithë ju që folët për zona të ndryshme sollët problematika të ndryshme, por që ngjajnë me njëra -tjetrën. Unë shpreh besimin e patundur se qeveria do të na mirëkuptojë për ndonjë fjalë që sjellim nga baza për ndonjë punë të pabërë, por e them se ne së bashku jemi një ekip, që duam të transmetojmë zërin e atyre që na votojnë dhe na duan. Gjej rastin t'i falënderoj të gjithë qytetarët. Problemet janë nga më të ndryshmet, por, në mënyrë telegrafike, për të mos humbur kohë, unë do t'i përmend shumë shkurt.

Gjej rastin të përmend të parin një problem, të cilin kolegu parafolës e tha të fundit, problemin e certifikatave të pronësisë, i cili është bërë legjendë, por, pa bashkëpunimin e pushtet vendor dhe ASHK-së, tashmë të riformuar, zgjidhja do të vonojë.

Së dyti, kemi problemin e legalizimit. Ne kemi shumë vite që po punojmë për këtë

problem, kemi arritje, puna është bërë, por te qytetarët ekziston ende frika se ky problem nuk do të zgjidhet.

Dua të sjell një shqetësim lidhur me zyrat e ASHK-së në rrethe. Taksa e ndikimit në infrastrukturë duhet të paguhet, pasi të merret certifikata e pronësisë, jo kur të bëhet legalizimi, sepse shumë qytetarë punojnë dhe jetojnë jashtë shtetit dhe nuk përgjigjen. Kjo gjë frenon procesin e legalizimeve dhe marrjen përfundimtare të certifikatës së pronësisë.

Një problem tjetër, të cilin e kemi diskutuar edhe në grupin tonë parlamentar, ka të bëjë me shpronësimet. Vërtet fermerëve ua vodhi tokën ai, i cili vodhi të gjithë Shqipërinë, por që nga viti 2007, kur u është marrë toka bujqësore qytetarëve të zonës për të ndërtuar rrugën Lushnjë-Berat, për të cilën e falënderojmë qeverinë, sepse edhe qytetarët ndihen të vlerësuar, ata ende nuk janë kompensuar, megjithëse toka u është shpronësuar.

Një fenomen tjetër, që haset në bisedat me qytetarët, por edhe me mësuesit e rinj, është punësimi në shkollat private të mësuesve që kanë dalë në pension, me gjithë respektin që kam për këto shkolla. Në pension janë edhe ish-mësuesit e mi, të cilët i respektoj pa masë, por nëse këta mësues vazhdojnë ende të punojnë në shkolla private, të cilat nuk punësojnë brezin e ri, atëherë unë mendoj se kemi të bëjmë me evazion fiskal. Pse duke e mbajtur diplomën të varur në mur do të punësohet si mësues brezi i ri?! Më e keqja është se ka nga ata mësues, të cilët punojnë edhe në shkolla shtetërore, edhe në shkolla private, por ku mbetet puna pa bërë?!

Një problem tjetër ka të bëjë me rimbursimin, të cilin e kemi miratuar në Kuvend, pra të 10-lekëshit që duhet të marrin të gjithë fermerët për një litër qumësht. Këtu ka një gjë që nuk shkon, sepse disa e marrin dhe disa të tjerëve u vonohet. Ndaj, do t'i lutesha qeverisë që të jetë korrekte me premtimet e dhëna për ata fermerë.

Të gjithë merremi me politikë, madje edhe qytetarët tanë. Çështjet e Kodit Zgjedhor le t'i zgjidhin ekspertët, por për sa i përket numërimit të votave mund t'u them qytetarëve se, përveç kënaqësisë që ata kanë kur votojnë, duhet të bëjnë edhe numërimin në qendrat e votimit, kështu, ne nuk kemi pse t'i themi bravo njërit apo faleminderit tjetrit.

Faleminderit !

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Çela!

Fjalën e ka deputetja Antoneta Dhima.

Të përgatitet deputeti Korab Lita.

Antoneta Dhima – E nderuar zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Dua ta nis fjalën time me një falënderim për ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministren e Financave dhe Ekonomisë, të cilat kanë vënë në rrugën e zgjidhjes dy nga problemet, të cilat unë i trajtova në seancën mëparshme, por edhe përgjigjet zyrtare që më kanë kthyer!

Edhe gjatë javës së kaluar jam takuar dhe kam komunikuar me zgjedhësit e zonës që unë përfaqësoj, të cilët më kanë përcjellë disa shqetësime, që duhen orientuar dhe planifikuar për t'u zgjidhur në të ardhmen nga ana e institucioneve përgjegjëse.

Një nga problemet dhe shqetësimet e përcjella nga banorët e zonës është pastrimi i kolektorit Roskovec – Hoxharë, i cili kullon një sipërfaqe prej 16 mijë e 500 hektarësh tokë. Në gjithë gjatësinë e tij ky kolektor përshkon territorin e tri bashkive: Bashkisë së Patosit, Bashkisë së Roskovecit dhe Bashkisë së Fierit.

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1108, datë 30.12.2015, 61 bashkitë e vendit janë përgjegjëse për administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të cilat janë transferuar në pronësi të tyre, duke përfshirë edhe sigurinë e digave të rezervuarëve, që përdoren për ujitje.

Nga viti 2016 e në vazhdim, me ekskavatorët e vënë në dispozicion nga qeveria shqiptare (për këtë gjej rastin ta falënderoj), nga ana e bashkive është pastruar një sipërfaqe e konsiderueshme e kanaleve kulluese dhe vaditëse.

Konkretisht, nga Bashkia e Patosit janë pastruar rreth 28,8 kilometra kanale kulluese të dyta dhe 59,6 kilometra kanale kulluese të treta, të cilat kullojnë në një sipërfaqe prej 2 mijë e 330 hektarësh tokë.

Puna e bërë nga ana e bashkive të Patosit, Roskovecit dhe Fierit për pastrimin e kanaleve kulluese të dyta dhe të treta nuk i jep zgjidhje përfundimtare problemit të kullimit dhe

eliminimit të përmytjeve në këto territore, pasi këto kanale kullojnë në kolektorin kryesor Roskovec – Hoxharë.

Në kushtet kur Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është duke hartuar buxhetin për vitin 2020, për të bërë të mundur eliminimin e përmytjeve në këto zona, kërkojmë të planifikohet pastrimi i këtij kolektori, i cili ka një gjatësi prej 36 kilometrash dhe një volum të konsiderueshëm pune.

Së dyti, një problem dhe një shqetësim tjetër, që është bërë prezent në mënyrë të vazhdueshme nga qytetarët, është situata e furnizimit me energji elektrike për 9300 abonentë në territorin e Bashkisë së Patosit.

Nga ana e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Fier dhe në Patos në mënyrë të vazhdueshme janë bërë ndërhyrje në rrjetin e furnizimit me energji elektrike, por këto ndërhyrje nuk i japin zgjidhje përfundimtare problemit, pasi rrjeti i shpërndarjes është tejte i amortizuar.

Abonentët familjarë janë korrektë me pagesën e konsumit të energjisë elektrike. Nëse do t'u referohemi të dhënave zyrtare, pagesa e tyre është 97 deri në 98%, ndërsa për bizneset 90 deri në 95%.

Për përmirësimin e situatës së furnizimit me energji elektrike në këtë zonë, si dhe për uljen e humbjeve në rrjet kërkojmë nga ana e Ministrisë së Infrastruktursë dhe Energjisë, si dhe nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ndërtimin e një nënstacioni të ri 110/20 kilovoltë dhe të rrjetit shpërndarës 20 kilovoltë në të gjithë territorin e Bashkisë së Patosit.

Së treti, një problem dhe një shqetësim tjetër i banorëve është dhe rikonstruksioni i qendrës shëndetësore Zharrë, e cila ofron shërbim shëndetësor për një numër të konsiderueshëm banorësh.

Rikonstruksioni dhe mobilimi i kësaj qendre është një domosdoshmëri edhe për faktin se zona, ku ndodhet kjo qendër, është e ndotur dhe banorët e kësaj zone duhet të kenë kujdes më të madh shëndetësor.

(Bie gongu.)

Në vijim të investimeve që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka bërë deri tani për rikonstruksionin e...

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Dhima!

Zoti Korba Lita nuk është i pranishëm.

Kalojmë te diskutanti tjetër. Fjalën e ka deputeti Ardit Konomi.

Të përgatitet deputetja Elda Hoti. Deputetja e fundit në listë është Klodiana Spahiu.

Ardit Konomi – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Dua të them dy fjalë për një problematikë, e cila nuk është zgjidhur përfundimisht dhe duket se në shumë raste zgjidhja e saj anashkalohet me vetëdije nga autoritetet përgjegjëse për shkak të vështirësive dhe për shkak të kompleksitetit që përmban. Bëhet fjalë për një fenomen që shoqëron rregullisht stinën e dimrit në zonën që përfaqësoj, qarkun e Korçës, por, në përgjithësi edhe një pjesë e mirë të territorit të Republikës së Shqipërisë, që ndan të njëjtën fizionomi gjeoklimatike me Korçën. Dimër për ta do të thotë telashe, andralla të mëdha, probleme ekonomike, probleme sociale, vështirësi në pothuajse çdo aspekt të jetës, probleme të mprehta mjedisore, të cilat fillojnë me prerjen e pyjeve për t'u shndërruar në dru zjarri, por nuk përfundojnë këtu, sepse drutë e zjarrit shndërrohen në tym dhe emetime, të cilat në shumë raste janë të rrezikshme për shëndetin e banorëve; do të thotë ulje e ndjeshme e konsumit, vështirësi në ekonomi qoftë në formën e saj tregtare, qoftë në formën e saj prodhuese, sidomos në vitet e fundit kjo është pjesa që afektohet më tepër nga vështirësitë e stinës, të cilat jo thjesht e ngadalësojnë aktivitetin, por në shumë raste, në varësi të specifikave, edhe e stopojnë.

Të gjitha këto kanë si emërues të përbashkët togfjalëshin: “nevojë për energji për ngrohje”. Kjo nevojë sot në masën mbi 60%, të paktën sipas llogaritjeve tona të fundit, përballohet pikërisht nga drutë e zjarrit, të cilat, nga ana tjetër, 100% e kanë origjinën në pyjet tona. E përkthyer në shifra është 1,5 deri 2 milionë metra kub në vit. Kjo është një peshë shumë e rëndë për pyjet tona, për ekosistemet tona pyjore, për kapacitetet tyre aktuale, duke marrë në konsideratë rritjen e tyre natyrore vjetore dhe ciklin e zakonshëm të mbjelljeve.

Gjatë viteve të fundit janë marrë një sërë masash në këtë drejtim. Më seriozet janë filluar pas vitit 2013. Në vitin 2014 është bërë ndalimi i eksportit skandaloz dhe shfarosës së lëndës

drusore jashtë kufijve të Shqipërisë. Më pas vazhdoi një proces i cili, bashkë me reformën administrative, synoi të vendoste në qendër të gravitetit të procesit të administrimit të pyjeve dhe të prodhimit të lëndës drusore për qytetarët bashkitë e reja të sapokrijuara. Gjithashtu, masat e tjera anësore ishin shumë sinjifikative. Po përmend heqjen e taksës doganore të importit të druve zjarrit dhe një sërë masash të tjera shoqëruese në këtë drejtim. Megjithatë, problematika vazhdon të mbetet. Ndërkohë që të gjithë ekspertët, pak a shumë, bien dakord që ka zgjidhje afatgjata, të cilat bazohen te gazi, tek avulli, tek uji i nxehtë që mund të përftohen prej impianteve industriale, që kryejnë procese të tilla, emergjenca mbetet te ky moment.

Nuk më premtan koha që t'i shkoj deri në fund diskutimit, kështu që në fund vlen të them se ne, së bashku me një grup ekspertësh, një ekip shumë i mirë për mjedisin dhe për legjislacionin e pyjeve kemi përgatitur një platformë të re, e cila synon bashkërendimin e një përqasjeje të re në mënyrën e administrimit të pyjeve, si dhe disa nisma për ndryshime dhe amendime ligjore, të cilat besoj se sot do t'i dorëzoj te shërbimet e Kuvendit për t'i diskutuar më pas në komisione.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Konomi!

Fjalën e ka deputetja Elda Hoti.

Elda Hoti - E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Po e nis fjalën time sot në këtë seancë me ndjeshmërinë e nënës, të gruas shqiptare që ka vënë si kryefjalë të jetës së saj familjen.

Një nënë dikur i tha djaloshtit të saj të vogël se Perëndia i bën njerëzit të mirë, por ai u përgjigj: “Unë e di për Perëndinë, por ndihmojnë shumë edhe nënat në rritjen, edukimin dhe mirëqenien e fëmijëve”. Si nënë e dy fëmijëve jam e përgjegjshme që me dashurinë, me të cilën kujdesem për fëmijët e mi, të kujdesem edhe për Shqipërinë time. Kush më mirë se një nënë mund ta dijë se çfarë hallesh dhe vështirësish kanë sot familjet shqiptare?! Kush vuan më shumë se zemra e një nëne kur shikon fëmijët e saj të largohen, se ndihen të pasigurt ta ndërtojnë të ardhmen në vendin e tyre?! Kë djeg malli më shumë se nënën që të përqafojë, të puthë dhe të

përkëdhelë fëmijën e saj, gjënë më të shtrenjtë në jetë?!

Para se të gjykoni nëse të rinjtë janë apo nuk janë të aftë për të qenë pjesë e politikës; para se të merreni me gabimet e njëri-tjetrit, që nuk kanë të bëjnë fare me përditshmërinë e njerëzve, merruni me rininë që po e zbraz çdo ditë Shqipërinë. Unë dhe bashkëmoshatarët e mi nuk e përjetuam eksodin e '90-ës, sepse nuk kishim lindur ende, por sot, pas 30 vjetësh, rinia shqiptare po përjeton serish të njëjtën dramë. Po cili problem po i largon këta të rinj?! Papunësia është një ndër problemet kryesore me të cilat përballen të rinjtë. Të jesh i ri i papunë, do të thotë të të fiket besimi te vetja; të jesh i ri i papune, do të thotë që familjes i shtrëngohet jeta; të jesh i ri i papunë, do të thotë se çdo përpjekje që bën nuk ka asnjë vlerë, në qoftë se nuk ke referenca politike; të jesh i ri i papunë, do të thotë që të gjitha sakrificat ekonomike të prindërve për shkollimin tënd, për t'u diplomuar, veniten dhe nuk të përfaqësojnë më.

Po çfarë po bëjmë ne për këta të rinj që të mos largohen?! Me çfarë të jetojnë këtu, kur me rrogat qesharake 200 mijë lekë të vjetër nuk mundën të mbajnë dot veten dhe, aq më pak, të mendojnë të krijojnë familje? Edhe i madhi Pablo Neruda thotë: “Dalëngadalë vdes ai që nuk udhëton, që nuk lexon, që nuk dëgjon muzikë dhe që nuk zbulon hijeshinë te vetja e tij”. Po me çfarë mundësish ekonomike mund të udhëtojë një i ri shqiptar?! Çfarë librash mund të lexojë ai, kur nuk kemi biblioteka në qytetet tona?! Të mos flasim për teatër dhe art të mirëfilltë, kur ju edhe piedestalin më të lartë, atë që sot quhet Teatër Kombëtar, dëshironi ta zhdukni. Po si guxoni?! Ua keni humbur melodinë e jetës këtyre të rinjve dhe i keni mbytur me strese. Kur dëgjojnë kaq shumë vetëvrasje, mendoni se ata kanë dëshirë të dëgjojnë dhe të bëjnë muzikë?! U keni shkatërruar të gjitha ëndrrat për të ndërtuar të ardhmen në vendin e tyre, po i ndani për së gjalli me familjarët dhe po na ndani për së gjalli si shqiptarë. Kjo është një politikë e poshtër juaja për të na larguar nga vendi ynë. Ju po largoni trurin, energjinë, të tashmen dhe të ardhmen e vendit. Asnjë shtet nuk mund të avancojë me moshën e tretë kur recetat e ilaçeve kushtojnë më shumë sesa pensionet që marrin. Si mund të avancojë një shtet kur një të riu i duhet tesera e partisë për një vend pune?!

I bëra një pyetje elektoratit tim: “Cili është problemi më i madh juaji që t’ia nisim nga puna?” dhe përgjigjja e tyre ishte befasuese: “Ne nuk e njohim fjalën “problem”, sepse tani jemi në luftë për mbijetesë”. Nga t’ia fillojmë?! Nga mungesa e ujit të pijshëm?! Kudo ku ka ujë, ka jetë dhe kudo ku ka jetë, duhet të ketë ujë. I drejtohem kryetarit të Bashkisë së Mirditës: merrni masa për rehabilitimin e sistemit ujitës, rezervuarit Malaj 2, dhe të ketë ujë për të gjithë banorët e Kodër Rrëshenit, mos lejoni të bëhen abuzime të turpshme duke u favorizuar vetëm disa familje, që kanë taserën e partisë suaj.

Me cilat probleme të tjera të zonës sime të vazhdoj, me papunësinë, më mungesën e infrastrukturës, me mungesën e energjisë elektrike, me mungesën e investimeve, me mungesën e hapësirave publike, këndeve sportive, me mungesën e bibliotekave apo me gratë që nuk kanë mundësi punësimi?! Janë zaptuar kafenetë nga burrat, të cilët nuk kanë ku të punojnë që të mbajnë familjet e tyre. Si t’i ndihmojmë këta njerëz që të kenë kushte minimale për të jetuar?!

Unë nuk di nga t’ia filloj me problemet e shumta dhe hallet e mëdha që kanë banorët e zonës sime, por di t’ju them se duhet të marrim masa urgjente, të bëjmë diçka për këta njerëz para se të jetë vonë dhe të kemi ikur të gjithë dhe para se Shqipëria të kthehet në një vend të huaj nga vetë ne shqiptarët.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Hoti!

Fjalën e ka deputetja Klodiana Spahiu.

Klodiana Spahiu- Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Në fakt, është një respekt shumë i madh për të gjithë ne deputetët që të organizohet një seancë e veçantë vetëm për problemet e qytetarëve.

I dëgjova me shumë respekt të gjithë kolegët deputetë të qarkut të Durrësit dhe nuk dua të përsëris disa nga problematikat që u përmenden këtu, por gjatë gjithë javës jemi fokusuar në një nga eventet më të rëndësishme dhe jemi përkushtuar të gjithë në tetorin rozë.

Jo pa qëllim dua që fjalën time t’ua kushtoj të gjitha atyre grave dhe nënave që janë përballur me këtë betejë kaq të vështirë. Ne kemi ndarë eksperiencën me to dhe me të gjithë ekipin e

mjekëve, infermierëve, radiologëve dhe kirurgëve të spitalit të Durrësit.

Pa dyshim që ka shumë problematika, ka problematika në legalizime dhe në disa kanale, që duhen mbyllur, por unë mendoj se, nëse ne fokusohemi në një gjë të rëndësishme për të parë se ku kemi qenë, ku jemi, çfarë është bërë ndërkohë dhe çfarë kemi ne për detyrë të bëjmë në të ardhmen, do të ishte më frytdhënëse. Nuk dua të bëj replikë me deputetët parafolës, por dua të them se është mirë që ne të jemi konkretë në dy-tri probleme, ministrat të kenë mundësi të mbajnë shënime dhe të mos merremi me çështje të përgjithshme, si, për shembull, jeta në Shqipëri është shumë e vështirë dhe nuk rregullohet kurrë, sepse, pa dyshim, asnjë nga ministrat nuk do të jetë i vëmendshëm.

Gjithsesi, dua të kaloj te një informacion i shkurtër se çfarë mundëm ne të realizonim brenda javës. Ne patëm takime shumë frytdhënëse me nënat dhe me gratë, që ishin përballur me këtë betejë dhe me nëna dhe gra të tjera, të cilat kishin shumë nevojë të informoheshin.

Është e vërtetë që Ministria e Shëndetësisë ka pasur aktivitete të pafundme gjatë këtij muaji, që ne e konsiderojmë muaji rozë dhe shpresojmë që të jetë i tillë edhe në vazhdim, por, mbi të gjitha, ka pasur një solidaritet shumë të madh për të treguar edhe një herë që kjo është një betejë që nuk fitohet e vetme. Asnjë që e vuan këtë sëmundje nuk mund ta fitojë i vetëm betejën, por, pa dyshim, ka nevojë për ngrohtësinë familjare dhe, mbi të gjitha, për përkujdesjen dhe masat që Ministria e Shëndetësisë ka marrë për zgjidhjen e kësaj problematike.

Po fokusohem te qyteti i Durrësit, sepse prej 5 vjetësh, që nga viti 2014, në Durrës funksionon pavijoni i kimioterapisë, ku gjejnë mbështetje dhe shërim të gjithë pacientët që vuajnë, por, kryesisht, ne e kemi filluar me kancerin e gjirit dhe më pas duke shtuar gamën edhe me sëmundje të tjera malinje.

Dua t’ju jap një statistikë shumë të thjeshtë. Në qoftë se në vitin 2015 ne kishim vetëm 233 ambulatorë, sot në vitin 2019, deri tani, në regjistrë janë 2100 ambulatorë të realizuar vetëm në këtë pavijon. Ka një numër shumë të madh rastesh të trajtuara me kimioterapi dhe prej 1 viti funksionon në mënyrë të shkëlqyer njësi e stenologjisë. Nuk dua të them se këta janë hap

gjigantë, por janë hapa shumë të rëndësishëm dhe tregojnë edhe një herë se sa e rëndësishme është për ne mirëqenia e gruas dhe e nënës. Pa dyshim që kemi plot gjëra të tjera për të bërë, për të rregulluar jetën e një gruaje, e një nëne dhe të një familjeje shqiptare, por mbi të gjitha shëndeti besoj se është dhe mbetet çështja bazë, sepse kush ka një shëndet të mirë, ka mundësi më të mira për punësim.

Faleminderit!

Vasilika Hysi - Faleminderit, zonja Spahiu!

Këtu mbyllen edhe diskutimet e sotme.

Besoj se të gjithë biem dakord që ndryshimi që kemi bërë në Rregullore për adresimin e shqetësimeve të zgjedhësve, që na kanë votuar dhe na kanë besuar, ka rëndësinë e vet. Besoj se të gjithë ministrat i kanë mbajtur shënim çështjet e ngritura nga deputetët, të cilat do të jenë të reflektuara në procesverbalin që do të miratohet në seancën tjetër plenare dhe do të keni mundësi t'i lexoni.

Të nderuar kolegë ministra, do të vlerësoja shumë adresimin e çështjeve të ngritura dhe një përgjigje për të gjitha shqetësimet që ngritën deputetët e shumicës dhe të pakicës.

Këtu mbyllet diskutimi për këtë çështje.

Projektvendimi për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Komisionin ndërkombëtar për Eksplorimin Shkencor të detit të Mesdheut" kalon për seancën tjetër.

Seanca e radhës do të njoftohet nga mediet.

Faleminderit për vëmendjen dhe për diskutimet!

Faleminderit medias që ka mbuluar një pjesë të mirë të seancave plenare!

Faleminderit!

(Seanca u mbyll në orën 15:00)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**

